

BIBLIOTEKA
SHTETIT

12
M91



A black and white portrait of Aleksander Moisiu, a man with dark hair and a serious expression, looking slightly to the right. He is wearing a dark suit jacket over a light-colored shirt.

Alexander Moisiu

VANGJEL MOISIU

Aleksander
Moisiu

92
M91

VANGJEL MOISIU

ALEKSANDËR MOISIU

(botim i dytë)



22.9.60

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

RP
TOP/1


Botohet me rastin e 100 vjetorit të lindjes

«Megjithëse zhvillimi i kulturës në vendin tonë ishte penguar shumë nga regjimet feudoborgjeze, nga gjiri i popullit tonë kanë dalë njerëz të shquar të artit e të kulturës, poëtë, filozofë, historianë, inxhinierë e aktorë të mëdhenj, që shumë herë kanë qenë autoritete edhe në vendet e tjera të botës».

ENVER HOXHA



ALEKSANDŖ MOISIU



Fotografia e shtëpisë në Kavajë ku ka banuar familja e
A. Moisiut

FËMIJNIA DHE FILLI_{MET} E VËSHTIRA

Aleksandri rrjedh nga familja e Moisive të qytetit të Kavajës. Sot degëzimet e familjes së Moisive janë shpërndarë në Durrës, Tiranë, Fier, po në mesin e shekullit tjetër kaluar, gjyshi i Aleksandrit, Konstandin Moisiu, së bashku me dy djemtë, Moisiun dhe Anastasin, banonte në Kavajë.

I ati i Aleksandrit, Moisi Moisiu, punonte në Durrës, ku përpinqej të pëmiresonte gjendjen ekonomike të familjes duke u marrë me tregtinë e lëkurëve dhe të gëzofeve, të cilat i eksportonte jashtë. Aso kohe Durrësi ishte qëndra më e madhe tregtarë e vendit dhe si port detar zhvillonte tregti me qytetet e ndryshme të Italisë, Greqisë, Serbisë, Turqisë etj. Ky qytet i lashtë bregdetar, me një histori mijëvjeçare dhe tradita ekonomike e kulturore të lashta, shërbente si një nyjë lidhjeje midis Ballkanit dhe Evropës Perëndimore. Porti i tij rrihej nga anije tregtarë të vendeve të ndryshme të Lindjes dhe të Perëndimit.

Moisi Moisiu, rreth vitit 1862, shkon për arsyesh ekonomike nga Durrësi në Trieste, ku vendoset si komisioner tregtar. Këtu ai u njoh me Amalia de Radën me të cilën u martua. Amalia de Rada, lindur më 7 dhjetor 1841, ishte me origjinë arbëreshe, nga trungu i De Radajve, të cilët ishin pasardhësit e shqiptarëve të shpërulgur në Itali pas vdekjes së Skënderbeut. Familja e Amalisë ishte shpërulgur prej kohësh nga Italia e Jugut. I ati, Antonio de Rada, rronte në Firence, ku kishte lënë emër si mjek i zoti. Kjo dëshmohet edhe prej vetë Aleksandër Moisiut i cili sipas kujtimeve të bashkëkohësve ka thënë:

«Babai im është thjesht shqiptar dhe nëna ime është shqiptare nga arbëreshët».

Xhuzepe de Rada, nipi i Jeronim de Radës, pohoi ndërmjet të tjerash, kur vizitoi Shqipërinë më 1962, se Antonio de Rada kishte origjinë arbëreshe.

Nga martesa e Moisi Moisiut me Amali de Radën lindën tetë fëmijë: (Konstandini, Dantja, Aleksandri, Sofia, Irena, Fania, Elvira dhe Mellania). ,

Aleksandri ishte më i vogli. Kur lindi ai, vëllai i madh, Konstandini, ishte 15-vjeç, ndërsa i dyti, Dantja, 13 vjeç. Pas tyre vinte Irena, e vetmja ndër të pesë motrat që shfaqtë dashuri dhe talent për artet. (Ajo premtonë të bëhej një pianiste e shquar, po fatkeqësisht vdiq në moshë mjaffë të re, 19 vjeçë). Pas Irenës vinin me radhë katër motrat e tjera: Sofia, Elvira, Fania dhe së fundi Mellania, që ishte një vit më e madhe se Aleksandri.

Në fillim të martesës së tyre, prindërit e Aleksandrit jetuan në Shqipëri, ku lindën fëmijët e parë. Por Amalia, duke iu ankuar të shoqit për vetminë, mungesën e mundësive për arsimin e fëmijëve, për rrezikun e malarjes etj., i bënte presion të vazhdueshëm bashkëshortit të saj që të shkonin për të jetuar në Trieste. Pas lutjeve të pareshtura të së shoqes, Moisi Moisiu u bind dhe familja u shpërndau në Trieste, që në atë kohë ndodhej nën pushtimin e austriakëve.

Aleksandri lindi në Trieste, më 2 prill 1879. Deri më sot për vitin e lindjes së tij jepet gabimisht viti 1880. Sipas certifikatës së pagëzimit dhe të lindjes së Aleksandër Moisiut lëshuar nga Komuniteti Greko-Oriental i Triestës që disponojmë, del se Aleksandri ka lindur më 2 prill 1879. Kjo vërtetohet edhe nga pllaka e mermertë e vendosur në varrin e tij në Lugano.

Aleksandri kishte sy të mëdhenj e të zinj, flokët kacurrela. Ishte fëmijë i urtë dhe i dashur, i gatshëm për të kuptuar dhe për të ndihmuar të tjerët, për të kërkuar ndjesë për gabimet e veta dhe për të qenë mirënjoħes

ndaj të mirave të të tjerëve. Këto karakteristika ai i trashëgoi nga i ati dhe i ruajti gjatë gjithë jetës si cilësi të mira.

Që në fillim familja e Moisiut u ndesh në Trieste me vështirësi të shumta. Kushtet e jetesës ishin të rënda. Kjo e detyroi të atin e Moisiut që të kthehej përsëri në Durrës me shpresë se në atdhe mund t'i siguronte familjes një jetesë pak a shumë të kënaqshme. Ai bisedoi disa herë për këtë problem me të shoqen dhe gjithmonë ndeshi në kundërshtimin e vendosur të saj.

Më në fund ranë në ujdi që Amalia të qëndronte në Trieste me dy vajzat e mëdha kurse ai vetë, me 6 fëmijët e tjerë, të rikthehej në Shqipëri. Duke pranuar këtë zgjidhje Moisiu shpresonte se e shoqja do t'i vente pas. Në fillim ai u nis me dy fëmijët më të mëdhenj, pak më vonë, në maj të vitit 1884, u nisen edhe fëmijët e tjerë. Aleksandrin e kishte pushtuar gëzimi i papërmbajtur se po udhëtonte për herë të parë me një anije të madhe me vela të gjera e të kuqe. I ati i kishte treguar shumë gjëra për atdheun, prandaj ai priste me padurim ta shihte.

Anija «Trabakoli» mori udhën për në det të hapur, ndërsa fëmijët me shami të bardha në duar përshëndesnin nënën e tyre dhe farefisin që kishin dalë në molo për t'i përcjellë.

Në Durrës familja e Moisiut u vendos në një shtëpi jo shumë larg detit, pranë mureve të kështjellës shekulllore. Këtu e kaloi fëmijninë Aleksandri. Rreth shtëpisë kishte një kopsht plot pemë, ku fëmijët mund të lodronin dhe të bënin ç'të donin. Për fëmijët filloj një jetë tjetër, krejt e re. Mbesa e Moisiut, Maria Kolea, ishte mjaft e dashur me fëmijët, u tregonte përralla të bukurë dhe i shëtiste buzë detit. Aleksandri, që në këtë kohë sapo kishte mbushur pesë vjeç, u ambientua menjëherë me shtëpinë, shokët dhe Durrësin. Kur u bë 6 vjeç, u rregjistrua në shkollën fillore. Në vitet e para mësoi gjuhën shqipe dhe greqishten e re. Pesë vjetët e fëmijërisë, që kaloi në Durrës, në gjirin e njerëzve të ba-

bait dhe me shokët e shkollës, i lanë Aleksandrit mbresa të forta të cilat nuk i harroi gjatë gjithë jetës.

Pas 30-vjetësh ai rikujton me dashuri këtë periu-dhë. Në artikullin «Një èndërr nga fëmijnia», botuar në gazetën «Noje Fraj Prese», Aleksandri shkruan:

«Unë fillova të shkoja në shkollë në Durrës (ky është Durakumi i vjetër i romakëve në Shqipëri, në detin Adriatik). Atje mësova të këndoja e të shkruaja gjuhën shqipe dhe greqishten e re. Në Durrës shkolla nuk ndryshonte nga shkollat e vendeve perëndimore e veriore, vetëm se mësuesi mbante mbi kokë një festë të kuqe në vend të kapeles, po ashtu edhe nxënësit, shumica e të cilëve vinin këmbëzbathur. Vetëm një pakicë kishin këpucë dhe kapele. Edhe unë. Dukej se kapelja tërhiqte kapelen, sepse ne, të pesë çunat me kapele zumë miqësi, kopjonim njëri nga tjetri, ndihmonim njëri-tjetrin duke i thënë në vesh, mungonim sa ishte e mundur së bashku nga shkolla, miqësoshehim e rrëshrim me njëri-tjetrin, shkurt, ne bëmë qka miqësia sillte me vete.

Po Durrësi ishte i vogël, mjetet e komunikacionit kanon shumë ngadalë, me përjashtim të disa kuajve arabe, të cilët ishin në shërbim të një pakice njerëzish «merendësi», ndryshe kishte vetëm qerre me buaj.

Dhoma ime i kishte dritaret nga deti, unë i shikoj shpesh anijet kur vinin e largoheshin. Ato vinin nga Triestja e udhëtonin për në Korfuz. Triesten unë e njihja, atje kisha lindur, kisha udhëtar me karrocë e me tramvaj. Atje unë pashë në stacionin jugor një mostrum (lokomotivë) duke ardhur me shumë zhurmë e tym... Jo, Triestja nuk më tërhiqte...»¹⁾

Simbas kujtimeve të farefisit, të gjyshes dhe nga vettë shënimet e tij, Aleksandri ka qenë një fëmijë i shkathët, i gjallë, i pëlqenin lodrat, ishte i guximshëm dhe èndërrimtar. I pëlqente të imitonë të tjerët. Kishte një natyrë gazmore dhe me numrat e «skenat» që bënte tèr-

1) Gazeta «Neue Freie Presse», 1 nëntor 1928.

hiqte vëmendjen e të tjerëve, gjë që e kënaqte së tepërmë. Të afërmit e Moisive tregojnë se si hidhej në det dhe duke qëndruar për një kohë të gjatë nën ujë, shkaktonte te të tjerët shqetësimë se mos ishte mbytur; kur dilte përsëri, gajasej së qeshuri, duke duruar qortimet e të mëdhenjve. Një herë, në një piknik familjar, më tregonë gjyshja, Aleksandri, papritur nxori nga xhepi një shishe të vogël, piu lëngun që kishte brenda dhe u rrëzua përtokë si i vdekur. Njerëzit iu afroan të trondit dhe të shqetësuar se mos kishte pësuar gjë, ai u ngrit edhe vrapi duke qeshur...

Sa e sa herë gjatë udhëtimeve në këmbë, buzë detit nga Kavaja në Durrës, pati provuar zërin e tij fëmijnor; sa e sa herë qëndronte përballë «Malit të Robit» dhe dëgjonte oshëtimën e zërit të tij që përplasej në shkëmb dhe kthehej përsëri duke humbur në thellësinë e horizonteve të detit.

Ai ndiente kënaqësi të madhe tek shikonte ngjyrat e bukura të detit, kur dëgjonte fëshfërimën e gjethive dhe cicërimat e zogjeve në pranverë. Shijonte ëmbëlsinë e natyrës në të gjitha stinët dhe mbi çdo gjë i pëlqente të eote mbi rërën e lagur të bregdetit, duke ndier nën këmbët e zbathura ujin e freskët të valëve të detit.

Natyra shqiptare me bukuritë e saj të rralla, me njërez trima, krenarë e të paepur, kaltërsia romantike e Adriatikut, klima e ngrohtë dhe e këndshme bregdetare, erërat dhe ngjyrat e detit, hijeshiq e kodrinave të gjelbëruara,jeta gazmore në rrëthim e shokëve, dashuria përtë e njerëzve që e rrëthonin, kontrastet e jetës shqiptare të atëherëshme lanë në temperamentin dhe karakterin e ndjeshëm të Aleksandrit gjurma të pashlyeshme. Ai i ruajti në ndërgjegjen e tij këto ndjenja dhe përshtypje gjatë gjithë jetës së tij si njeri dhe artist.

Kështu kaluan vitet e para. Megjithatë fëmijët e ndienin mungesën e nënës. I ati i Aleksandrit mundohej vazhdimi shqiptar t'ia mbushte mendjen së shoqes që të vinte në Durrës. Por ajo s'pranoi të largohej nga të afërmit e saj. Atëherë Moisi Moisiu vendosi të kthejë pranë së

ëmës dy djemtë e rritur, duke mbajtur pranë vetes Aleksandrin dhe dy motrat binjake.

Po më 1889, me kërkesën e vazhdueshme të gruas, i ati i Aleksandrit së bashku me tre fëmijët kthehet përsëri në Trieste. Këtu Aleksandri hyri në shkollën fillore «Akuedoto». Përparimi i tij në mësimë ishte mjaft i ngadalshëm, e kishte vështirë t'u shtrohej rregullave dhe të bënte detyrat e shkollës. Ai i nënshtrohej çdo paratë përgatitjes së mësimeve nën kontrollin e rreptë të motrës së madhe, Irenës, ndërsa mbrëmjeve shëtiste. Në shtëpi mërzitej shumë, si më i vogli dërgohej për të kryer porosi të ndryshme. E bënин fajtor për çdo gjë që ndodhë. Shpesh merrete vullnetarisht mbi vete fajet e vëllezërve dhe të motrave të tij për çrrregullimet që ngjisnin në shtëpi dhe pranonte dënimin, pa e ditur se për çfarë po dënohej. Megjithëse ishte një fëmijë guximtar, këto ndëshkime e dëshpëronin, i ngacmonin nervat, e bënин të papërqëndruar, një natyrë të shqetësuar dhe të druajtur. E vetmja që e kuptione dhe tregonte kujdes për të ishte tetë Zhaneta, e cila në çdo rast e përkrahte dhe përpinqej ta kënaqte.

Kujtimet nga Shqipëria rronin të gjalla në shpirtin e tij. Sipas kujtimeve të motrave, Aleksandri këndonte shpesh këngë shqipe, të cilat i kishte mësuar me shokët e fëmijnisë. Kur mbushi 17 vjeç, mbas diskutimeve që u bënë në familje, u vendos që Aleksandri të vazhdonte shkollën e mesme reale në Graz dhe të mësonte gjuhën gjermane. Dhe kështu u bë, ndonëse djaloshi nuk donte të largohej nga familja dhe nga shkolla e Triestes.

Aleksandri i hipën trenit për në Graz, me një kostum të vetëm, pa para dhe i pasigurt për të ardhmen sepse gjendja e familjes së tij ishte bërë e vështirë (i ati ishte sëmurë rëndë). Në gjimnaz e ndien akoma më shumë skamjen dhe mungesat. Meqenëse familja nuk i dërgonte rregullisht të holla, Aleksandri u përpooq t'i shtrohej punës, të kapërcente vështirësitë dhe të siguronte mjetet e jetesës. Megjithëse larg, ai mendjen e kishte gjithmonë te familja. Ja si e shpreh dashurinë

për të atin në një letër të asaj kohe që dërgon nga Grazi:

«I dashur prind.

Po afrohet festa e Vtit të Ri dhe, me këtë rast, nuk mund që mos të tē kujtoj, o atë i dashur, dhe tē tē shpreh dashurinë time ndaj teje me sjelljet e mia të mira si në shtëpi dhe në shkollë. Të uroj shumë e shumë vjet lumturi në gjirin e tē gjithë tē dashurve të tu, dhe urojmë që ne tē gëzojmë lumturinë pér tē pasur pér shumë vjet një baba.

Këto urime tē dërgon djali yt i vogël që tē ka në zémër.

Aleksandri».¹⁾

Më 1899 Aleksandri erdhi edhe një herë në Durrës me rastin e martesës së motrës së tij, Mellanisë. Kjo ishte një vizitë prej dy javësh dhe hera e fundit që do ta shikonte atdheun e tij tē dashur, tē cilin ai nuk e harroi kurrë. Duke përfituar nga rasti, përveç Durrësit ai pa Tiranën, Kavajën dhe u çmall me farefisin e shokët e tij tē fëmijërisë. Mbrëmjeve shëtiste me shokët dhe miqtë në bregdetin e «Curiave». Dëgjon-te këngën e detit, thithë me etje ajrin e freskët me një ndjenjë tē tillë sikur i rikthejë fëmijnia.

Për lidhjet e Moisiut me Shqipérinë dhe shqiptarët, pér dashurinë ndaj atdheut, pér ndjenjën e kombësisë së tij shqiptare, pér tē cilën ai ishte krenar dhe tē cilën nuk e mohoi asnjëherë si në kohë tē vështira ashtu edhe në çastet e triumfeve tē tij tē panumërtë, si atëherë kur shumëkush e quante «artist pa atdhe», ashtu edhe atëherë kur shumë vende përpinqeshin ta bënin artist tē kombit tē tyre, flasin shumë fakte e ngjarje prekëse, në tē cilat do tē ndalemi në një kapitull tē vëçantë.

1) A. Moisiu. Letrat. Theatersammlung. Vjenë.

* * *

Pak kohë pas largimit të tij nga Shqipëria, Aleksandri vendoset në Vjenë së bashku me nënën e tij dhe motrat. Ai sapo kishte mbushur 20 vjeç. Megjithëse i varfër, në kushte ekonomike të vështira, i pushtuar nga pasionet dhe ëndrrat djaloshare e me talentin e mrekullueshmë si të vetmen pasuri, kalon plot besim e guxim portat e qytetit në kërkim të së ardhmes dhe vendit të tij në jetë. Vjena, kryeqyteti i Perandorisë Austro-hungareze, për pozitën dhe traditat e saj ishte një nga kryeqytetet më të rëndësishmë të Evropës, që dallohej për jetën e pasur kulturore dhe artistike. Si qendër e rëndësishme e jetës artistike në Evropë, Vjena e Shtrausit dhe e Moxartit, e Leharit dhe e Shubertit, jetonte epokën e «ballove dhe të shkëlqimit të Hofburgut¹». Në Vjenë ndodheshin Burgteatri, më i madhi institucion teatral i botës gjermane, konservatorë dhe shtëpi të shquara të muzikës.

Aleksandër Moisiu ëndërronte të studionte për këngë. Ai shpresonte të kishte sukses në këtë fushë, pasi e ndiente se kishte zë të mirë. Pas shumë përpjekjesh dhe me ndihmën e disa kushërinjve dhe miqve të nënës së tij, u bë e mundur të regjistrohej në konservatorin e Vjenës. Puna në konservator nuk qe e lehtë, pasi Aleksandrit i duhej të punonte për të nxjerrë jo vetëm mjete për të mbajtur vjetveten dhe të përballonte studimet, por edhe për t'i ardhur në ndihmë familjes, e cila ishte ngushtë ekonomikisht.

Po dëshira e tij për t'u bërë këngëtar u zbe, sukset e tij ishin të pakta. Për disa arsyen të panjohura, Moisiu nuk u lejua të vazhdojë më tej konservatorin e Vjenës. Kur nëna e tij u paraqit në drejtori, asaj i thanë:

«Djali juaj, zonjë, çdo gjë mund të bëhet, po jo artist!».

1) Qendër kryesore kulturore-artistike në Vjenë.

Duke u larguar nga konservatori për në shtëpi, nëna zemërthyer mendonte: «Q'udhë do të marrë djali më i vogël, dhe më i dashuri në familje?...»

Këto ishin dështimet dhe hidhërimet e para. Jo një herë «komisionet provuese» kanë dhënë shembuj pa aftësie për të zbuluar dhe vlerësuar talentet në vitet e rinisë së tyre. Kështu ka ndodhur me Xhuzepe Verdin dhe Franc Listin, të cilët për arsyen fare të parëndësishme nuk u pranuan në konservatorin e Milanos.

Në vigjiljen e shekullit të ri, Aleksandri endet përséri në kërkim të punës, pa pasur as idenë më të vogël se ç'do të bëhej. Aspak nuk mendonte për teatrin, përskenën. Një ditë, duke shëtitur në Rosen Park, kaloi në portën që të nxirrte pranë Burgteatrit. Aty vuri re lajmërimet që kërkonin figurantë. Iu dukt punë e këndshme, aq më tepër e lehtë, sepse nuk do të fliste asnjë fjalë. Trokiti në portat e Burgteatrit dhe u pranua si figurant. Në artikullin «Debuti im në Burgteatër», të cilin Moisiu e shkroi shumë më vonë, jepen me një vërtetësi dhe kolorit të bukur e prekës fillimet e vështira të kësaj periudhe. «Unë kam bërë një takim, — shkruan A. Moisiu, — që ka qenë vendimtar për jetën time, po kur ndodhi ky takim, nuk e di. Nuk kam aftësi për të mbajtur mend datat dhe mësuesi i historisë më ka lënë dy herë në klasë, pasi nuk ma falte këtë të metë. Kur jetoja në Vjenë, isha i ri dhe i varfër. Për të fituar bukën u jepja mësimë private për gjuhën italishtë disa nxënësve të paktë që pranonin metodën time. Në atë kohë e ardhmja ime ishte shumë e errët. Nevoja për të jetuar, zorrët që më gërryrenin më detyruan që të punoj si figurant në Burgteatër, duke marrë çdo mbrëmje një shpërblim fare të vogël. Që të them të drejtën, pa u mburrur, nuk isha kompars, po ndihmëskompars ose më mirë të themi statist i thjeshtë. Për punën që bëja merrja 1.35 marka për çdo shfaqje. Si statist, luaja rolin e një plaku grek në pjesën «Mjeshtër Palmyra», atë të një plaku romak në tragjedinë «Jul Qezari» dhe të një kadeti guaskon në veprën «Sirano de Berzhërak».

Por ja, një herë, në komedinë e Molierit «Tartufi», m'u dha gabimisht roli i shërbëtorit të Tartufit, që kishte një emër: ai quhej Lorenc.

Roli nuk ka asnijë fjalë, po Lorencit i flet Tartufi, që e interpretonte Jozef Kainci. Atë unë e kisha parë shumë herë, kurse ai mua asnijëherë.

Tartufi u drejtua në skenë nga ana e majtë, i përcjellë prej shërbëtorit. Para se të hynim në skenë, unë isha afër Kaincit dhe i thashë «mirëmbrëma», por ai nuk ma vuri veshin dhe as më shikoi. Me gishtin tregues të dorës së djathtë hoqi pluhurin nga sipërfaqja e një mobiljeje dhe i tha inspektorit të skenës: «Duhet të kujdeseni që të ketë më shumë pastërti në teatër».

Inspektori i nevrikosur, iu përgjigj: «Zotni Kainc, ju lutem hyni në skenë!». Dhe shtoi, duke u drejtuar nga unë: «Edhe ju».

I gatshëm dhe i shpejtë, Kainci filloi rolin e vet: «Lorenc, o shërbëtori im, më përgatit petkat e pendas!...» Në atë çast Kainci ngre sytë, shikimet tona kryqëzohen, ai thotë edhe tri fjalë dhe i mbahet goja!...

Sufleri, një burrë i moçëm, mjekërosh, i kujton aktorit fjalët e rolit. Mua më mbulojnë djersë të ftohta. Inspektori vrapon si një shpëtimtar dhe, më në fund e ndihmon Kaincin të dalë nga gjendja kritike.

Pengimi që i ndodhi Kaincit pati pasoja, jo për të, po për mua, pasi të nesërmen nisën të më kërkojnë në të gjithë Vjenën. Kur më gjetën, më thanë se zoti këshilltar mbretëror, doktor Shlenteri, kërkonte të fliste me mua! Unë pësova një tronditje të madhe. Iu paraqita Shlenterit, i cili me njerëzi, më tha që t'i recitoja diçka. «Nuk di gjë përmendësh», — i thashë dhe i premtova se do të mësoja diçka. Pas një bisede të shkurtër me kolegët e mi komparsë, vendosa të mësoj diçka nga «Urjel Akosta» dhe nga «Rikardi III».

Këto dy fragmente ia recitova doktor Shlenterit me një gjuhë mjaft të keqe, por ai, si guximtar që ishte, më përgatiti para kolegjiumit drejtues të Burgteatrit.

Të gjithë personalitetet e mëdha si: Sonentali, Le-

vinski, Bermajsteri, Hartmani etj., pas një diskutimi serioz, vunë emrat e tyre në një copë pusullë, ku edhe sot mund të lexohen këto fjalë: «Aleksandër Moisi, lindur... babai... shkolla etj., është i paaftë për t'u bërë aktor».

Po rrugët e fatit janë të mrekullueshme dhe unë ndoshta do t'i isha nënshtuar këtij vendimi, sikur... Jozef Kainci mos t'i kishte dhënë rëndësi atij pengimi të gojës, që i ndodhi, kur më pa dhe sikur të mos më kishte mbrojtur».

Skena e tërhoqi Moisiun plotësisht. Ai digjej nga dëshira për të krijuar, për të interpretuar diçka goftë edhe ndonjë rol episodik. Ai mendonte, jetonte i mbërthyer nga pasioni për t'u futur në të fshehtat e artit dramatik. Qëndronte pranë artistëve të shqar, shihte interpretimet e Kaincit, Basermanit, Hartmanit, Keslerit dhe kolosëve të tjerë të skenës, përpinqej të shikonte, të mësonte çdo gjë dhe të përfitonte sa më tepër.

Jozef Kainc ishte figura më e madhe e artit skenik në atë kohë dhe adhurohej nga artdashësit e skenës. Interpretimet e Kaincit pasqyronin me furi urrejtjen kundër obskurantizmit dhe realitetit fals borgjez. Në karakteret e personazheve që interpretonte, ai zbulonte ide te dhe ndjenjat e njerëzve; nxirrte në pah problemet e mëdha të kohës, duke i qëndruar besnik prirjes së tij realiste. Dhe ai e bënte këtë në një kohë kur dukeshin qartë shenjat e krizës së artit teatral borgjez dhe kur në truallin e skenës po zinte vend rrryma e ekspresionizmit.

Moisiut të ri figura e Kaincit, i impononte admirim e dashuri dhe kurdoherë i qëndronte pranë duke e dëgjuar plot respekt.

Moisiun e «rrëzuan» ne provim me motivacionin «i pa aftë për aktor». Kjo ndodhi ndoshta sepse nuk dinte mirë gjermanishten, se e shqiptonte me theksin e dialektit triestin, ose ndoshta anëtarët e komisionit «nuk zbuluan» ndonjë të dhënë dalluese, ndonjë rreze talenti për teatër.

Kaincit i erdhë shumë keq që ndodhi kështu. Ai u hidhërua shumë nga vendimi i komisionit:

«Moisiu nuk di gjermanisht? S'ka gjë, do ta mësoj

unë! Keni për ta parë, zotërinj, se theksi i tij ekzotik do t'i dhurojë tinguj të ri gjermanishtes. Dhe ajo fytyrë, ata sy, ai vështrim, ajo figurë nuk janë të përshtatshme për të bërë aktorin? Do të shikojnë ata katër kryeneçët e irrinosur...» Turfullonte tërë inat dhe i zemruar Kainci. Dhe pikërisht Kainci, vështrimi i të cilit nuk i rezistoi shikimit të gjallë e plot zgjuarsi të Moisiut, i zemëruar nga vendimi i komisionit, kërkoi me këmbëngulje që Moisiu të pranohej si aktor. Ai hetoi te portreti i Moisiut, te figura e tij, te zëri i tij, te vezullimi i syve të tij shenjat e gjenisë artistike. «E ardhmja do ta tregojë!» Kështu e përfundoi Kainci bisedën me anëtarët e komisionit.

Aktori i madh, Kainci, e ndihmoi dhe e udhëhoqi Moisiun në hapat e para të artit skenik. Tre vjet punë të vazhdueshme, plot pasion dhe pandërprerje, Moisiu studion me këmbëngulje, me egërsi, mundohet, vuan, po gjithnjë dhe hap pas hapi ndien gjëzimet e para të punës. Moisiu nuk e harroi ndihmën bujare të Kaincit, të cilin i quan mirënjojës gjatë gjithë jetës.

Për herë të parë Aleksandri iu paraqit publikut vjenëz në shfaqjen teatrale, që u organizua me qëllim bamireshie në sallën e shoqërisë tregtare të Vjenës, në Johannesgase. Shfaqja u prit keq nga kritika, të cilën e indijuan «çirrjet» e këtij «çunaku» të skenës.

Viti 1902 e gjeti Moisiun në Pragë. I rekomanduar nga Kainci, u angazhua në Teatrin Gjerman të Pragës dhe menjëherë interpretroi një rol në dramën «Përtej fuqive tona» të shkrimtarit norvegjez Bjornson. S'ishte e lehtë të dilje para publikut të këtij qyteti. Praga aso kohë ishte qytet me tradita të lashta kulturore. Duke pasur parasysh këtë Moisiu ishte plotë emocione dhe shqetësimë. Si do ta priste publiku? Po kritika?

Jehona e shfaqjes qe pozitive. Publiku i Pragës shikonte për herë të parë një artist që interpretonte në mënyrën e vet, një aktor me një zë të kumbueshëm dhe të bukur.

Shtypi e ndoqi premierën si gjatë përgatitjes ashtu edhe pas shfaqjes. «Rolin e Elias, — shkruante Hans


Bohm, — e lot në të dy pjesët Aleksandër Moisiu... Ky artist i ri para tre vjetësh nuk e zotëronte gjermanishten dhe gjatë kësaj kohe të shkurtër ka ditur ta përvetësojë aq sa tani është në gjendje t'i kushtohet artit dramatik gjerman».¹⁾

Ndërsa kritiku gjerman Emil Faktor, që e ka ndjekur gjatë gjithë kohës krijimtarinë e Moisiut, ka shkruar këto radhë pér shfaqjen e Pragës. «Ç'fuqi e pashembullt dhe gati e egër qe ajo me të cilën Moisiu, në rolin e tij në dramën «Përtej fuqive tonë» të Bjornsonit, tronditi publikun e Pragës, pér të cilin ishte krejt i panjohur. Atij i takoi të thoshte fjalët e fanatikut Elias, dhe atëherë një zë krejt i huaj, i fuqishëm në sarkazmën e tij dhe çuditërisht i bukur përshkoi me një tmerr gjithë fytyrat e publikut».²⁾

Praga ishte një fillim i mirë pér Moisiun. Natyrisht, ai e kuptonte se ishte në startin e rrugës së tij artistike dhe se duhej shumë punë pér të arritur përsosmërinë e interpretimit skenik sepse pér Moisiun e ri nuk ishte aspak e lehtë të debutonte në teatër, kur përkrah tij shkëlqente plejada e aktorëve të shquar dhe me përvojë, të cilët kishin forcuar opinionet dhe njiheshin pér forcën artistike të interpretimit. Aleksandër Moisiu duhej të vinte tërë forcat mendore e fizike pér t'u ngjitur në lartësitë e artit skenik. Ai duhej të punonte dhe të luftonte në shumë drejtime: duhej të punonte shumë pér të zotëruar gjuhën gjermane, duhej të luftonte pér të afirmuar në vete lojën e tij, personalitetin e tij. Këto përpjekje duhej të bashkoheshin edhe me luftën kundër rrymave dekadtante borgjeze, kundër metodave natyraliste të interpretimit, kundër shijeve artistike të publikut borgjez, që ishin formuar nga shkollat e artit aristokratik borgjez.

1) Hans Böhm «Aller Anfang ist schwer» (Çdo fillim është i vështirë) Berlin 1927, f. 29.

2) Emil Faktor «Der Schauspieler Alexander Moissi» (Aktori Aleksandër Moisi). Berlin 1920.



Interpretimet e para të Moisiut në Pragë ngjallën mjaft interes. Pati shumë debate dhe u shfaqën opinione të ndryshme. Disa e kritikuan se nuk zotëronte mirë gjuhën gjermane, e kritikuan për shqiptimin e dobët, për lojën me temperament disi të tepruar. Po pati shumë të tjerë që i entuziazmoi loja e tij e bukur, mënyra origjinalë e interpretimit dhe zëri i tij melodioz. Kur dilte në skenë artisti i ri duartrokitej e përshëndetë me entuziazëm.

Në një letër që Aleksandri i dërgonte, në atë kohë, familjes së tij nga Praga, ndër të tjera shkruante edhe për pritjen e ngrohtë që i kishte bërë publiku dhe për suksesin e madh që pati në teatrin e Pragës.

Ky sukses i dha Aleksandrit mundësinë t'i besojnë role të tjerë më të rëndësishëm. Në pjesën e Shilerit, «Cubat», Moisiu interpretoi rolin e Franc Morit, në «Klavigon» e Gëtes, rolin e Karlit dhe mandej atë të Mortimerit në «Maria Stjuart» të Shilerit. Në dramën «Sirano de Berzhërak» ai u paraqit me rolin kryesor të vetë Siranos. Kështu u shtuan rolet, u rrit eksperiencia, besimi në vetvete, jehona. Nuk munguan edhe njerëz që e luftuat artistin e ri: intrigantë, publicistë, filistinë, që u munduan ta përqeshin, ta përcmonin, ta fyenin. Moisiu nervozohet, shqetësohet, trishtohet kur ndeshte në një atmosferë ftohtësie. Ata nuk i kuptionin vështirësitë e aktorit në rritje.

Periudha e Pragës (1901-1904) është periudha e parë e Moisiut në rrugën e vështirë të artit të vërtetë skenik. Fillimet plot emocione e vështirësi, plot pasione, ndjenja e dyshime, i vlejtën shumë Moisiut në punën e tij krijuese. Në mendjen e tij po piqej ideja se ai duhej të çante në skenat e mëdha. Ishte koha që të khente vështrimin nga Berlini, që ishte qendra më e madhe e jetës politike, kulturore dhe artistike e Gjermanisë, ku vepronin e krijonin aktorë dhe regjisore, jehona e të cilëve kishtë kalaar kufijtë e vendit.

Duke marrë rrugën për në Berlin, Moisiu, provonte ndjenja të papërcaktuara: ndiente gëzim për sukseset e

para, po kishte shumë emocione që i ngjallnin pasiguri dhe një farë stepje para së ardhmes së panjohur.

Në atë kohë arti skenik gjerman jetonte epokën e krijimeve të njoitura regjisoriale të Maks Rajnhardt dhe të aktorëve në zë si Baserman, Sonental, Kainc, Hartman, Levinski etj., njerëz me horizonte të gjera kulturore dhe me talent të madh.

Në këtë qytet të madh, të panjohur për Moisiun e ri, zhvillonin veprimtarinë e tyre shumë teatro të dëgjuara. Moisiu u paraqit në «Deutsche Volksbuhne» (Skena popullore gjermane), një teatër i ri me tendencë demokratike që përpiquej t'u shërbente masave popullore. Të dhënët artistike të talentit të tij, interpretimi, zëri kumbues, gjestet dhe mimika, lëvizjet e bukura dhe shprehëse, të gjitha këto spikatën që në provat e para. Drejtori i teatrit e angazhoi Moisiun pa asnjë ngurrim.

Premiera e parë «Gjenovefa» e Hebelit, në të cilën Aleksandër Moisiu interpretoi rolin e Golos, u dha në vjeshtën e vitit 1904. Në këtë pjesë të vështirë Moisiu interpretoi në skenë përkrah aktoreve së shquar Elizabet Shnajder. Drama e Hebelit, pjesë mjaft e ndërlikuar me vargje e monologje të gjata, ishte një provë e vështirë për teatrin dhe aktorin e ri. Interpretimi i Moisiut qe plot kolorit dhe muzikalitet. Poezia e Hebelit në gjuhën e Moisiut gjeti një deklamim melodioz e plot ngjyra.

Kritikët e njojur gjermanë, Julius Bab dhe Vili Hande e çmuin shumë lart interpretimin e djaloshit të talentuar. «Në skenë qëndronte një njeri i panjohur dhe luante Golon, — shkruante Julius Bab. — Ndoshta ky Golo është roli më i vështirë ndër të gjithë rolet e tjera, sepse gati gjysma e tekstit të tij përbëhet nga monologje... Këtu nga njëqind aktorë, pesëdhjetë janë dashamirë të zakonshëm të këtij roli që e lozin disi, dhe dyzet e nëntë e lozin këtë rol në mënyrë patetike, sofiste, të ftohtë. Po mendimet në këtë rol nuk duhet të shfaqen si një dritë e qetë. Jo, ato duhet të shpërthejnë si shkëndija nga një flakshpërthim dhe duhet të ndriçojnë vetëm për aq sa u duhet, që, duke rënë poshtë, të ushqejnë një zjarr të ri. Aktori që do të lozë këtë rol, duhet të jetë krejt i

zjarrtë... Përveç kësaj, ky aktor duhet të jetë në gjendje, nga ana teknike, që ta vërë në lëvizje tërë këtë masë monologjesh që vetëm fliten, duhet të krijojë një lojë, një gjest për çdo mendim sa kohë që gjen vlerën ndjenjore të secilës. Unë nuk di ndonjë detyrë tjetër më të vështirë aktoriale se ky Golo në tërë fushën e letërsisë teatrale. Dhe ja, kjo detyrë, ky problem, u zgjidh këtu nga një aktor, i cili, qështë e vërteta, nuk fliste në një mënyrë të qartë, nuk fliste madje, pothuaj as gjermanisht, po që derdhte nga vetja e tij një lumë të pandërprerë pasioni shpërthimtar, nga një aktor që i jepte çdo mendimi një pasuri të pashtershme gjestesh, një dukshmëri trupore; nga një aktor me një instinkt të tillë të fuqishëm e të pagabueshëm për ta mbërthyer, për ta rrëmbyer, për ta ngritur lart spektatorin, aq sa i magjepste të gjithë e s'i lëshonte asnjë çast nga magjia e lojës së tij, me një fuqi të tillë saqë të gjitha dobësitë e veprës s'viheshin më re dhe pasioni shpirtëror i përbindshëm i personazhit, duke fituar një jetë krejt trupore, u ngrit i gjallë përpara nesh dhe na rrëmbeu. Ky aktor quhej Aleksandër Moisi.

... Moisiu, — përfundonte J. Bab, — këtej e tutje është një nga shpresat tona të mëdha».¹⁾

Vlerësimet e kritikut të shquar gjerman J. Bab qenë më pozitivet dhe më inkurajeset. Bab ishte ndër të parët kritikë që zbuloi shkëndijat verbuese të talentit të Moisiut dhe pa me guxim e qartësi horizontet e ndritura të rrugës krijuese të aktorit të ri. Ai nuk u bashkua me korin e atyre që i mohuan Moisiut talentin, duke thënë se «nuk ishte i zoti të bëhet asgjë». Moisiun e kritikuani për gjestet e tepruara, për «efekte», bile ndonjëri i vuri edhe epitetin «majmuni i kërrusur». Po Moisiu ishte ndër ata që më pak se çdo gjë respektonte këtë lloj kritike.

Në Berlin ai u paraqit përsëri me rolin e Franc Morit të një prej kryeveprave të Shilerit, «Cubat». Roli i Franc Morit ishte mjaft i vështirë. Ai mishëronte evolucionin

1) Julius Bab, «Deutsche Schauspielerporträts aus Berlin und Wien» («Portrete të aktorëve gjermanë të Berlinit e Vjenës»), Berlin 1908.

regresiv të natyrës së intrigantit, karakterin e tij dinak, fals dhe shpirtlig. Moisiu e interpretoi Franc Morin përmes imtësish të vogla po shprehëse, duke zbuluar hipokrizinë e heroit në marrëdhëniet edhe me njerëzit më të afërm të tij. Heqja e maskës së «njeriut të mirë», tmerri i demaskimit e bënë Morin të hidhet në tèrbim. Në aktin e vetëvrasjes së Morit, Moisiu shpërthen furishëm si panterë e harlisur që vërsulet drejt dyerve të mbyllura dhe, plot shkumë e tèrbim kërcen e përplasjet në mure, orendi, duke thyer e thirrur me zemërim.

Shfaqja e Franc Morit në interpretimin e Moisiut shkaktoi emocione dhe diskutime të zjarra. Ishte një lojë jo e zakontë për mënyrën, temperamentin dhe forcën e interpretimit. Gjatë pushimeve, në hollet e teatrit, njerëzit diskutonin me pasion:

«Një Mor i çmendur, një përbindësh!».

«Nuk është e vërtetë, kështu duhej të ishte».

«Dukej si një turi majmuni melankolik».

«Është aktor i huaj, akoma nuk e zotëron gjermanishten».

«Çuditalem, si i lejojnë qenët të tillë të hipin në skeñën gjermane?»

«Përkundrazi, mua më duket se është një nga artistët e mëdhenj që kam pasur rastin të admiroj».

«Ka një zë çuditërisht të ëmbël».

«Duket si një violinë e vjetër, e shkurdisur».

«Tingull magjik!»

Këto fraza të përziera me zhurmën shurdhuese të brohoritjeve frenetike dhe fërshëllimave të ashpra dëgjoheshin edhe gjatë shfaqjes. Zhurma ishte aq e rrëmbyer në publik, saqë aktorët fill pas pushimit të parë nuk dinin ç'të bënин. Ata ishin të hutuar, të mpirë, të çoroditur. Hezitonin nëse duhej të vazhdonin më tej shfaqjen. Kishte filluar një betejë fundi i së cilës nuk dihej... Moisiu u tèrhoq në dhomën e tij, i heshtur, i turbulluar, i humbur në emocione. Ai as që mendonte se kjo zhurmë bëhej pér të. Qëndronte i ulur me litarin në sup, që e kishte pështjellë rrëth qafës në pamjen skenike të varjes dhe shikonte se nga pëllëmba e dorës i rrëndhte gjak... Dukej

që ishte gërvishur në zemërimin e tij të çmendur, kur mundohej të ngjitej në muret e ashpra të skenës, ku nuk mungonin gozhdët. Dhe duke vështruar pikat e kuqe të gjakut që i rridhnin nga dora, ai mendonte:

«Do të flasin përherë, ndoshta nuk do të më kuptojnë kurrë... do të mundin vetëm të më admirojnë ose të më urrejnjë».

«Cubat» ishte një betejë. Moisiu e çoi atë deri në fund pa u ndalur përpara zhurmës, bërtitjeve, fërshëlli-mave dhe duartrokitjeve të spektatorëve, të cilët jetuan atë mbrëmje një mënyrë të paparë interpretimi. Duke komentuar premierën, Georg Herman shkroi: «Shfaqja ka qenë e keqe. Po të kishte qenë kështu edhe në Mainc në kohën e Shilerit, sot asnjeri nuk do ta dinte më emrin e kësaj vepre. Veçse kësaj here ka qenë një Franc Mor, për të cilin ka për të folur bota».¹⁾

1) Cituar sipas Hans Böhm «Moissi, der Mensch und der Künstler» (Moisiu, njeri dhe artist), Berlin 1927, f. 21.

NJOHJA ME RAJNHARDIN

Maks Rajnhardi ishte një nga regjisoret më të mëdhenj të artit skenik gjerman. Fama e krijimeve të tij regjisoriale dhe lufta e madhe që bëri kundër stilit të vjetër për afirmimin e interpretimit të natyrshëm dhe realist në skenë, e bënë atë të njihej si regjisori krijues dhe novator.

Emri dhe veprimtaria e Rajnhardtit lidhet me zhvillimin e artit skenik në fund të shekullit XIX dhe në dekadat e para të shekullit XX. Kjo ishte periudhë eksperimentesh të shumta në fushën e stilit dhe të metodave jo vetëm në artin skenik, po në gjithë gjinitë e artit dhe të letërsisë. Kjo ishte epoka kur imperializmi kishte krishtalizuar karakteristikat e tij si fazë më e lartë e kapitalizmit, duke manifestuar tendencat dhe reaksionin e tij në fushat sociale dhe politike, kur luftërat koloniale dhe fashistizimi po dilnin më në pah. Po kjo periudhë ishte, njëkohësisht, edhe fillimi i epokës së revolucioneve proletare dhe luftërave nacionalçirimitare, i epokës së socializmit. Ishte e natyrshme që shkrimitarët dhe artistët nuk mund të qëndronin jashtë ngjarjeve të mëdha të kohës, nuk mund të qëndronin indiferentë ndaj këtyre proceseve social-politike. Duhej mbajtur qëndrim ose t'i përkrahje, ose t'i demaskoje fenomenet dhe proceset e botës kapitaliste, botë e cila u dha fund iluzioneve dhe parullave të lirive borgjeze. Në këto kushte u rritën kërkesat për një zhvillim realist të letërsisë dhe dramës, për një qëndrim kritik ndaj moralit dhe raporteve të kalbura të shoqërisë kapitaliste që shkonte drejt rrënimit.

Dramat e Çehovit, Shout, Ibsenit etj. ishin vepra që

akuzonin dhe tallnin shëmtimet morale të rendit borgjez. Edhe Rajnhardi ishte pér ngritjen e rolit shoqëror të teatrit, pér **interpretimin realist** të dramave.

Duke luftuar kundër kufizimeve të repertorit dhe artit natyralist të asaj kohe, Rajnhardi u ngrit kundër kulturës dekadente borgjeze, kundër «stilit të lartë» konserverator-aristokratik, kundër akademizmit që sundonte në Evropën Perëndimore. Por, megjithëse ishte artist i madh me prirje realiste, Rajnhardi nuk mundi të kapërcente kontradiktat e përgjithshme të teatrit të kohës së tij. Orvatjet e tij pér të zgjidhur problemet e ripërtëritjes së teatrit u kufizuan nga ndikimet e tradicionalizmit dhe stilizimit, nga ndikimet formaliste të mistiko-simbolizmit që pengonin zbërthimin e thellë të pjesës.

Megjithatë, kontributi i Rajnhardtit në artin skenik gjerman dhe botëror është i njojur. Me talentin e tij të fuqishëm ai jo vetëm zbuloi disa ligje të zhvillimit të artit skenik, por edhe formoi një plejadë të tërë aktorësh të shquar gjermanë si: Baserman, Kainc, Sorma, Hartmann, Krauze, Kortner, Timig Herman, Darvas, Timig Helene, Moser, Pinhok, Vintershtajn e shumë të tjera. Në këtë plejadë artistësh të mëdhenj kurora më e bukur e saj mbetet Aleksandër Moisiu.

Thuhet se Rajnhardi e pa Moisiun pér herë të parë në Venedik. Ishte pikërisht koha kur Moisiu, përpara se të shkonte në Berlin, debutoi si tenor në operën «Luçia di Lamermur», duke pasur si partnere këngëtaren e shquar Adelina Pati, Rajnhardtit i tërhoqi vëmendjen zëri i bukur dhe veçanërisht mimika e aktorit, plastika e lëvizjeve të Moisiut. «Keni zë shumë të bukur, — i tha Rajnhardt aktorit të ri duke e përgëzuar. — Po meqë mimikën e keni shumë më të zhvilluar dhe dramacitetin më të theksuar, ju këshilloj të ndiqni teatrin e prozës».

Kjo ndodhi në vitin 1903. Që nga ajo kohë Moisiu ishte nën vëzhgimin e vazhdueshmër të Rajnhardtit.

Periudha e Pragës nuk vazhdoi gjatë. Ky qytet iu duk Moisiut i ngushtë pér mundësitë e mëdha të tij si artist. Ai vendosi të bëjë një udhëtim në Berlin, në kërkim

të «fatit» të ri. Sapo erdhi në Berlin, Moisiu iu paraqit **Rajnhardit**. Aleksandri në moshë krejt të re, me fytyrë të zbetë, trup të hollë, i pafuqishëm, flet përpara regjisorit të njohur me lehtësi dhe mallëngjim të çuditshëm.

Duke kujtuar këto çaste A. Moisiu shkruante: «Takimi im i parë me Maks Rajnhardin qe vendimtar. Unë posa kisha marrë goditjet e merituara në Pragë dhe erdhë në Berlin si një njeri i papjekur, i cili u gjet papritmas para thellësive dhe lartësive të artit dhe që dëshironte shumë, po s'mundte. Munda të bisedoj me të dhe ky më angazhoi»¹⁾.

Në një rast tjetër Moisiu tregon: «Rajnhardi pati besim tek unë dhe më mori në teatrin e tij në Berlin. Shumë ngritën supet, dikush bile u shpreh: «Ja, Maksi, filloj çuditë e tij!», «Çfarë mund të pritet nga ky djalosh i ri italian apo shqiptar, apo cilido goftë!».

Tregojnë se kur Rajnhardi e pa artistin e ri në provën e parë, iu drejtua kolegëve të tij me këto fjalë: «Meine Herren, hier bringe ich ihnen den Schauspieler» — Zotërinj, unë ju paraqes juve *aktorin*».

Këto fjalë, të cilat në atë kohë u kritikuan dhe u vunë në lojë, në të vërtetë ishin mjaft të goditura, sepse Aleksandër Moisiu përfaqësonte në sytë e regjisorit të madh aktorin e vërtetë. Rajnhardi formuloi këtë shprehje jo në kuptimin se përpara fuqisë aktoriale të Moisiut nuk mund të qëndronte asnjë aktor tjetër bashkëkohës, as në kuptimin se arti dramatik nuk mund të paraqitej më mirë veçse në mënyrën që ndiqte Moisiu. Ai e shprehu këtë mendim në kuptimin që Moisiu personifikonte pikërisht aktorin që rronte në ndërgjegjjen e popullit me individualitetin dhe shkëlqimin e interpretimit të tij.

Rajnhardi e angazhoi Moisiun në «Teatrin e vogël» të Berlinit, ku ky interpretoi rolin e Hanriut në pjesën «Kokadi i gjelbër». Kjo ndodhi në nëntorin e vitit 1904.

Kritikat e para në adresë të aktorit të ri nuk e shqetësuan Rajnhardin. Ai e angazhoi atë përsëri në role të

1) Aleksandër Moisiu, «Der, Die, Das», Revista «Nëntori» Nr. 5, 1970.

reja, duke e ndihmuar dhe pritur frytet e talentit krijues të aktorit të ri. Në muajin maj të vitit 1905 Rajnhardi përgatitej për të vënë në skenë pjesën «Konti fon Karole» të Ber Hofmanit. Në kërkim të aktorit të përshtatshëm për personazhin kryesor të dramës, Filipin, autori i drams, Hofman, i propozoi Rajnhardtit që të provonte Moisiun. Dhe pas një takimi, bisede dhe prove ata vendosën përfundimisht që rolin kryesor të kësaj pjese t'ia besonin aktorit të ri. Kjo ishte një ngjarje e rëndësishme në jetën e Moisiut, sepse i jepej rasti të dilte përpara një publiku të ngritur në një teatër të njojur në qendër të Berlinit.

Në rolin e Filipit spikatën vetitë e talentit të Moisiut, zëri i tij kumbues dhe harmonik, bukuria e lëvizjeve dhe e gjesteve. Pasionet e dashurisë rinore ai i paraqiti plot zjarr, ledhatim dhe koketëri.

Interpretimi i Moisiut ngjalli diskutime dhe polemikë. Disa publicistë si: Litish, Mina, Vitman, Baker etj. e kritikuan mënyrën e lojës dhe interpretimin e Moisiut. Dikush e quajti «aktor që nuk është i zoti të krijojë asgjë», një «Kainc komik e fals», «naiv i papjekur» etj.¹⁾ Të tjerë lavdëruan talentin e Moisiut dhe perspektivat e shkëlqyera të tij. Një ndër ta ishte dhe Feliks Salten. «Zoti Moisi, — shkruante ai, — duket se do të bëhet një artist i madh. Sot ai është duke kërkuar madhështinë e vet, bukurinë e vet, në qdo gjest ai kujton se e ka gjetur madhështinë e tij dhe mezi po e përmban veten nga gjëzimi. Megjithékëtë, ai ishte interesant.»²⁾

Moisiu tani kishte gjetur rrugën e tij. I përkrahur nga Rajnhardi, Holenderi dhe dashamirës të tjerë, duke studiuar e punuar me këmbëngulje, duke mos u thyer nga sulmet denigruese dhe shprehjet fyese të kritikës, po çante përpara duke kapërcyer të gjitha pengesat.

Në vitin 1905-1906 Moisiu interpretoi role të reja në pjesët: «Elektra», «Endrra e një nate vere», «Tregtar i Venedikut», «Stuhia», «Fantazmat», «Zgjimi pranveror»,

1) Gazetat: «Neue Freie Presse», «Extrablat», Berlin 1905.

2) Felix Salten «Graf von Karole» (Konti fon Karole). Gazeta «Die Zeit», Berlin, maj 1905.

«Edipi dhe sfinksi» etj., duke shkaktuar gjalléri dhe komente të ndryshme në faqet e gazetave të Berlinit. Mjaft komentatorë të gazetave «Berliner Tagesblat», «B.C. Am Mitag», «Tegliche Rundschau», e quanin aktor të pavlefshëm e pa prespektivë, disa të rrëmbyer, të çuditshëm dhe disa të tjerë e admironin. «Në mjaft raste kritika ndaj meje ka qenë e ashpër, — tregonte më vonë Moisiu në një bashkëbisedim me Maria Dobrozemskin. — Dikush shkruante se jam «femër histerike», dikush se jam çifut etj. Këto gjëra thoshin në fillim edhe berlinezët. Këto ishin zëra nga të njëjtët njerëz. Publikun e kam pasur që në fillim me vete. Për kritikën nuk jam zemëruar. Me kritikën njihem nga të dhënat e portierit të hotelit. Ai e lexon rregullisht. Kur shkoj për të ngrënë mëngjes, ai vjen me respekt të madh dhe më thotë:

— Hë, a e keni lexuar?

— Unë, çfarë? As që kam menduar fare se sot do të ketë një shënim kritik».

Unë e shoh nga sjellja e portierit se çfarë kritikë do të jetë, e mirë ose e keqe, nga qëndrimi dhe lëvizja e tij e kokës. Dhe kështu e humb interesin për kritikën. Dëshiroj që ajo të jetë e mirë në mënyrë që portieri të mos mendojë se nuk vlej për asgjë¹⁾.

Kjo ishte periudha e luftës për t'u afirmuar në skenat e Berlinit. Duhej luftuar kundër rrymës zotëruese të opinionit publik borgjez, që ishte formuar dhe që i qëndronte besnikë metodave dhe mënyrës impresioniste të interpretimit. Kjo shtresë e qarqeve artistike hyjnizonte idhujt e saj të artit skenik, duke frenuar afirmimin e talenteve të reja.

Kundër këtij tradicionalizmi konservator luftoi me këmbëngulje Rajnhardi. Skena ishte bërë arena e luftës

1) Nga kujtimet e M. Dobrozemskit, ish-nëpunëse pranë Bibliotekës Shtetërore të Vjenës dhe e njohur familjarisht me familjen e Moisiut. Këtu Moisiu e ka fjalën për kritikën Lenigruese.

ku ndesheshin e reja me tē vjetrēn, konservatorja me pērparimtaren. Rryma e vjetër konservatore u qëndronte besnikë koncepteve statiste tē trashëgimisë dhe tradicionallizmit teatral, kundërshtonte format dhe metodat e reja tē interpretimit, ajo kundërshtonte Moisiun dhe Rajnhardin, i cili me konceptet e reja tē inskenimit, me tendencat realiste dhe stilin e ri u shkaktonte konservatorëve shqetësim dhe frikë. Rajnhardi nuk u përkul përpara ndërhyrjeve dhe kritikave tē shumta dhe me vendosmëri vazhdoi punën krijuese me Moisiun.

Fillimet e shekullit XX përbëjnë periudhën më tē vështirë tē Moisiut, kur ai duhej tē punonte dhe luftonte pér tē përsosur artin e interpretimit, tē zotëronte metodat e reja, tē kapërcente ndikimet e artit natyralist. Dhe ai e bënte këtë me një luftë këmbëngulëse, plot nervozizëm, duke përballuar dhembjet dhe dëshpërimin, duke mos u thyer përpara pengesave tē çdo lloji, duke çarë me guxim në kërkim tē formave tē reja tē interpretimit, duke pasuri armë lufte talentin e tij, vullnetin e paepur pér tē studiuar dhe punuar, hirësinë e trupit dhe tē gjestit, virtuzitetin e teknikës e bükurinë e zërit tē tij. Ky artist, brenda tē cilit po piqej gjenialiteti, ndiente kënaqësinë e punës dhe tē përpjekjeve që bënte pér tē arritur majat e artit.

Ngjarje tē bucura në krijimtarinë skenike tē Moisiut në këtë periudhë qenë interpretimet në dramat: «Edipi dhe sfinksi» e H. Hofmanstalit, «Endrra e një nate vere» e Shekspirit dhe «Fantazmat» e Ibsenit. Që tē trija pjesët u vunë nën regjinë e Rajnhardit. Figurën e Kreonit, njeri melankolik e tē lodhur ngajeta, tek «Edipi dhe sfinksi» Moisiu e dha me lëvizje tē ngadalta, plot butësi, tē mbushur me një zjarr tē brendshëm. Kurse në figurën e Osvaltit tē Ibsenit mishëroi forcën e pakrahasueshme shpirtërore, urrejtjen ndaj servilizmit dhe moralit kishtar. Tanimë çdo gjë po tregonte se Moisiu po afirmonte vetveten si artist i madh.

Tone tē reja, optimiste, entuziazzte dëgjohen në botën e kritikës artistike. Rikard Nordhauzen shkruante në atë kohë: «Prej drizash e prej një grumbullimi ngatërrer-

sash, si një palmë e re, po ngrihet një talent i fortë». ¹⁾

Koha dhe zhvillimet po provonin vlerat e mëdha artistike të Moisiut. Ai skaliti role të reja e të rëndësishme në drama të ndryshme. Pa u lodhur ai kërkonte rrugë interpretimi për t'u futur sa më thellë në brendinë e rolevë, të njinte karakteret e personazheve e t'i mishëronte ato duke përsosur vazhdimisht teknikën e interpretimit.

Aleksandër Moisiu tani ishte duke u ngjitur në lartësitë e artit skenik, por ende nuk kishte arritur kulmin e krijimtarisë së tij. Megjithëse talenti i tij shpërtheu në mënyrë të vrullshme Moisiu nuk ishte një artist i parakohshëm, ai u formua si artist dalngadalë, duke përshkruar një rrugë pak a shumë të gjatë që nga komparasi e statisti e deri tek artisti, të cilit i besuan interpretimin e rolevë të kryeveprave të dramaturgjisë botërore. Në këtë proces të vështirë ai mblodhi përvojë të pasur, i zgjeroi mjaft njojuritë ideoestetike, u njoh pothuaj me poetët e dramaturgët më të mëdhenj të kohërave të ndryshme duke nisur nga ata të antikititetit e duke mbaruar me ata të shekullit XX. Zhvillimi dhe përsosja e artit të interpretimit të Moisiut ecën krahas me zhvillimin dhe formimin e tij si njeri. Personaliteti i tij u formua si përfundim i një pjekurie të gjithanshme. Dhe mund të themi se ky zhvillim i gjithanshëm dhe harmonik e ndihmoi atë që të arrijë maja të larta në artin skenik.

Në vitet 1907-1910 Moisiu interpretoi role të ndryshme si: Romeo (Romeo e Xhulieta) e Shekspirit, Durbedatin (Dilema e mjekut) e B. Shout, Karlosin (Klavigo) e Gëtes, Fieskon (Përbetimi i Fieskos) e Shilerit, Marki Pozën (Don Karlo) e Shilerit, Poetin (Nju) e O. Dymovit, Faustin, Jedermanin etj.

Nga roli në rol, nga pjesa në pjesë, çdo muaj, çdo vit rritej aftësia krijuese e Moisiut, zgjerohej përvuja artistike, ngrihej dhe përsosej arti i tij i interpretimit, lulëzonte talenti i tij madhështor.

Kështu filloi të endej dhe u përkrye portreti i këtij aktori të shkëlqyer dhe gjenial. Sulmet, kritikat dhe ku-

1) Cituar sipas Hans Böhm «Moissi, der Mensch und der Künstler» Berlin, 1927.

ndërshtimet e pjesës konservatore të publikut nuk e tronditën Moisiun.

Po të shikojmë listën e shfaqjeve të interpretuara nga Moisiu nën regjinë e Rajnhardtit, do të vërejmë një galeri të tërë personazhesh, mbi 90 role të ndryshme, të luajtura në skenat e kryeqyteteve kryesore të botës. Në një artikull kritiku i përmendur Artur Kahane ndër të tjera shkruante: «Ai ka lehtësinë dhe hijeshinë e trupit dhe të gjestit; ka lehtësinë e fluturimit të fjalës dhe të shpirtit; lehtësinë dhe elasticitetin e qenies dhe të formës së jetës. Ai të krijon përshtypjen se është i adhuruari i vetë «perëndive», është Beniamini i tyre. Të duket se vetë «perënditë» ia kishin vënë vetes si kusht për t'ia lehtësuar punën.

Po kjo është vetëm në dukje. «Perënditë» nuk ia lehtësuan atij as fillimin, as zhvillimin as edhe lartësimin e tij. Përreth tij pati gjithnjë luftë... Ai kishte me vete dhuntinë e talentit të tij, që e bëri më të pëlqyeshëm dhe të këndshëm përpara «perëndisë» dhe njerëzve.

Nuk ka asnje aktor që u ndoq aq shumë. Nuk ka asnje tjetër që ta adhurojnë si atë».¹⁾

Rajnhardi po provonte se kishte pasur të drejtë në besimin që kishte krijuar për Moisiun dhe në përkrahjen që i kishte dhënë aktorit të ri. Moisiu u bë aktori më i preferuar, ai interpretoi rolet më të bukura dhe më të vështira të dramaturgjisë botërore, duke korrur triumfe të panumërtë në skenat më të mëdha të botës. Duke folur për Rajnhardin, Moisiu tregon: «Ne rrinim së bashku, Rajnhardi dhe unë. Dhe mendonim: ç'duhet të bëjmë sivjet; çfarë pjese do të vëmë? Kjo na jepte kënaqësi dhe mandej ia fillonim punës me të vërtetë. Bëjmë prova sa të jetë nevoja, deri në fund. Nuk marrim parasysh pagesën, po mendojmë vetëm për punën që do të bëjmë. Dhe pastaj puna shkon mirë. Ne bëjmë atë që na gjëzon. Nganjëherë unë e bind atë dhe nganjëherë tjetër më bind

1) Artur Kahane, «Alexander Moissi, oder das problem der Schwerlosigkeit», «Aleksandër Moisiu ose problemi i pavështirësisë», Gazeta «Pariser Tageblatt», 1935

ai mua. Ndodh që e lemë fare punën dhe bëjmë diçka krejt tjetër. Ai nuk është eprori im, dhe unë nuk jam vartësi i tij. Ne e harmonizojmë punën dhe ndiejmë kë-naqësinë e saj».¹⁾

Natyrisht, besimi i Rajnhardtit te gjenia e Moisiut dhe talenti i tij i pakrashaueshëm, u bë realitet para së gjithash dhe mbi të gjitha në saje të punës së madhe e të palodhur që bëri si aktor Aleksandër Moisiu gjatë gjithë jetës së tij, si në vëftet e vështira, kur i duhej t'iu bënte ballë sulmeve dhe kritikave të keqdashësve, ashtu dhe në kohën kur sëmundja e rëndë e tuberkulozit po ia merrte fuqitë. Moisiu i ishte kurdoherë mirënjosë re-gjisitor të tij, të cilin gjithmonë e kujtonte me respekt e dashuri të madhe, edhe kur nga ana botëkuptimore u ngrit më lart se Rajnhardi.

Arti skenik i bashkoi këta dy gjigandë të skenës botërore, të cilët pëershkuan një rrugë, një luftë duke ngritur dhe lartësuar njëri-tjetrin, duke shtegtuar si lajmëtarë të idealeve të larta të artit përparimtar të njerëzimit.

Në qoftë se teatri gjerman nuk mund të kuptohet pa dhe jashtë gjenisë krijuese të Rajnhardtit, po kështu edhe epoka e shkëlqyer e Rajnhardtit nuk mund të konceptohet pa gjeninë krijuese të Aleksandër Moisiut.

1) M. Dobrozemski — Nga kujtimet e udhëtit të përbashkët
Vjenë-Pragë, 1918.

FILLIMI I TRIUMFIT BOTËROR

Fama e Moisiut po rritej. Emri i tij njihej tanimë në tërë zonën gjermane. Erdhi koha që Moisiu të fillonte turnetë jashtë shtetit.

Në vitin 1911 ansamblı teatral i Rajnhardtit ishte ftuar për një turne në Rusi. Një nga shfaqjet me të cilat ansamblı u paraqit para publikut teatral të Petërburgut ishte «Edipi mbret» i Sofokliut, e cila pati shumë sukses. Ka interes të përmendet se roli i Edipit u interpretua nga Moisiu krejt rastësisht. Vagneri, aktori që interpretonte Edipin, u sëmur një ditë përparrë nişjes dhe u detyrua të qëndrojë në Berlin. Moisiu në këtë pjesë interpretonte rolin e Terezias. Rajnhardi e pyeti Moisiun nëse do të mundte në kushtet e krijuara, domethënë brenda një afati mjaft të shkurtër, të merrte përsipër të luante rolin e Edipit. Dhe e mylli bisedën duke i kujtuar atij se si rasti e kishte sjellë, disa kohë më parë, që Moisiu të interpretonte dy role në të njëjtën pjesë si për shembull te «Cubat» e Shilerit. Moisiu e pranoi me kënaqësi propozimin e Rajnhardtit me gjithë vështirësinë e madhe që paraqiste detyrë. Të përvetësohej brenda një afati jashtëzakonisht të shkurtër, një rol i ri, bile kryesor, duke pasur parasysh së do të luhej përparrë një publiku të huaj, kjo ishte një gjë jo e thjeshtë. Po Rajnhardi ishte i sigurt, sepse aftësitë dhe talentin e madh të Moisiut ai i kishte provuar në raste të shumta dhe të vështira. Posa hipën në tren, ata filluan së bashku punën për përgatitjen e rolit të ri. Dhe kjo s'ishte një punë e thjeshtë. U duhej të sakrifikonin pushimin, të flinin pak. Gjatë

gjithë udhëtimit Berlin-Petërburg, Aleksandri përvetësoi tërë pjesën i pushtuar nga pasioni i rolit të ri.

Në Petërburg u bënë vetëm dy prova skene sepse për më shumë nuk kishte kohë. Pas këtyre provave Moisiu guxoi të dalë përpëra publikut thuaj me një rol krejt të ri, të cilin e interpretroi me mjeshtëri të lartë. Roli kryesor i Edipit ishte suksesi i parë i Moisiut në skenat jashtë Gjermanisë. Revista moskovite «Teatri dhe arti» shkroi me këtë rast këto radhë: «Suksesi i «Edipit» të Rajnharrit, në masën më të madhe, ishte suksesi i aktorit Aleksandër Moisiu. Ai triumfoi mbi Moskën. Gjatë një javë e sundoi atë. Emri i tij nuk u hoq nga goja gjatë gjithë javës në qarqet e gjera të publikut teatral».¹⁾.

«Edipi i Moisiut, — shkruante më vonë A. Lunaçarski, — nuk është ai Edipi monumental, të cilin ne e njohim nga tragjedia e lashtë. Përpunimi i Hofmanstalit e bëri «Edipin» më modern. Duke u nisur nga ky përpunim, Moisiu shtroi si qëllim para vetes së tij të krijojë jo figurën e Edipit mitologjik, po figurën e Edipit me vlerë të përgjithshme njerëzore dhe u përhoq ta luajë tragjedinë në një mënyrë që të na e afronte atë me botëkuptimin tonë. Pasi e aprovon interpretimin e Moisiut, duhet të mahnjitesh nga teknika me të cilën ai e ka përgatitur këtë rol. Përpunimi i zërit, i pozave, i gjesteve dhe vëçanërisht loja e duarve të Moisiut në rolin e Edipit ngjani sikur të ishin një sinfonji. Kursimi dhe përdorimi me vend i mjeteve të lojës gjatë akteve të para dhanë mundësi të arrijë nga fundi një forcë të jashtëzakonshme».²⁾

Kur ishte në Rusi, Aleksandri mori njoftimin mbi vdekjen e të atit. Ky lajm e hidhëroi shumë artistin. Në një letër që i dërgonte nënës së tij nga Odesa, Aleksandri ndër të tjera shkruante: «Me hidhërim mora vesh lajmin se babai ynë i shkretë na la njëherë e përgjithmonë. Shpresoj se nuk do të ketë vuajtur shumë. Më shkruaj me imtësi se si ndodhi».³⁾.

1) Revista «Teamp u ickyembo» (Teatri dhe arti). Moskë 1921.

2) Revista «Uckyembo тругящихся» (Arti i punonjësve) Nr. 6, 1925.

3) Fondi i Moisiut — Theatersammlung, Vjenë.

Programi i shfaqjeve teatrale në Moskë, Petërburg, Odesa dhe Riga u realizua plotësisht dhe me sukses të madh.

Nga Petërburgu, triumfi i Moisiut në rolin e Edipit vazhdoi në Berlin, Vjenë dhe në kryeqytetet e tjera të Evropës.



Vitet e Luftës së Parë Botërore ishin të rënda për Moisiun. Ai u rekrutua ushtar i thjeshtë dhe më vonë shërbeu si aviator në frontin gjermano-francez.

Një ditë, bashkë me pilotin tjetër shkuan të lahen në Ostende. Me të zbritur poshtë dhe sa po hynë në ujë, disa ushtarë, që ndodheshin aty pranë, i panë dhe iu afroan. Ushtarët nuk ishin austriakë, por anglezë. Ishte e qartë, ata kishin gabuar kursin e fluturimit. Aeroplani, në vend që të zbriste në Ostende, ishte ulur në Kale. Kështu, Moisiu u kap rob dhe u vendos në një ujdhesë të Bretanjës. Gjatë pesë muajve që qëndroi aty, Moisiu tentoi të shpëtonte. I veshur si një punëtor belg, ai u arratis dhe mundi të arrijë deri në kufirin zviceran, por u kap dhe që këtej u dërgua në Tuluz, ku u mbajt i lidhur në pranga.

Lufta e Parë Botërore imperialiste, me rrënimet dhe masakrat masive, i bëri përshtypje të thellë Moisiut. Ai i pa ato në front dhe prapavijë. «Lufta ndryshoi dhe deformoi çdo gjë, — thoshte ai në një bisedë me miqtë e tij. — Gjermania duhet të bindet se me topa nuk arrihet çdo gjë... Në shekullin e 18-të gjermanët ishin një popull i poetëve dhe mendimtarëve. Po më vonë drejtimi militarist u pa si qëllim kombëtar dhe tërë sistemi i edukimit u vu në funksion të këtij qëllimi. Fëmijëve u serviret një e vërtetë, që lufta ishte e nevojshme. Faji qëndron te Gjermania dhe Rusia, bile përvoja historike më bind se faji më shumë bie te Gjermania... Gazetat nxisin, i gënjejnë popujt ndaj njéri-tjetrit».

Nga kushtet e vështira të kampeve të përqëndrimit,

si rob lufte Moisiu mundi të shpëtojë në saje të ndërhyrjes së miqve të tij, e sidomos të Viktor Eftimiut, bashkatdhetarit dhe mikut të tij të ngushtë.

«Në vitin 1915, — shkruan Viktor Eftimiut, — kur ndodhesha në Berlin, erdhi tek unë aktorja Johana Tervin, grua e ardhshme e Moisiut. Ajo më tha se Aleksandri, ishte rob lufte në Francë, i sëmurë dhe se po të mbetej akoma për një kohë të gjatë në kampet e përqëndrimit, ishte rrezik të vdiste. U habita jashtë mase kur më tha se unë isha në gjendje ta shpëtoja. Lufta e Parë Botërore ishte në zhvillim e sipër. Rumania kishte mbetur deri atëherë asnjanëse. Johana Tervini më tregoi një plan të cilin unë e zbatova pa pasur ndonjë besim të madh se do të përfundonte me sukses. Me t'u kthyer në Bukuresht ndërhyra pranë Ambasadës së Francës dhe me të vërtetë munda t'ia arrij qëllimit. Aktori i madh u lirua duke u shkëmbyer me një gjeneral francez, i kapur rob prej gjermanëve. Po Moisiu s'kishte të drejtë të kthehej në Gjermani. Jetoi dhe interpretoi në Zvicëri deri në mbarim të Luftës».¹⁾.

Gazeta «Flamuri i Shqipërisë», që botohej në Konstancë të Rumanisë, i bënte jehonë lirimtë të A. Moisiut nëpërmjet përpjekjeve dhe shkrimeve që Viktor Eftimiut u drejtonte organeve të shtypit. «U thashë se përvëç admirimit tim për Moisiun, ajo që më shtyu të përpinqeshë tutje-tëhu, ishte edhe fakti se ai ishte shqiptar prej origjine. Ai ishte nga Durrësi, unë jam prej një vendi në afërsi të Korçës, jemi që të dy shqiptarë».²⁾

Pas mbarimit të luftës, i ftuar nga Viktor Eftimiut, i cili në atë kohë ishte drejtor i përgjithshëm i teatrove rumune, Moisiu, në dhjetor të vitit 1921, shkoi në Rumania së bashku me Tervinin e grupin e tij teatral dhe u priti me dashuri e përzemërsi nga miqtë e tij shqiptarë.

«Dhjetëra bashkatdhetarë me tufa lulesh në duar ishin grumbulluar në orën katër të mëngjesit për të pri-

1) V. Eftimiut «Aleksandër Moisiu». Revista «Nëntori» Nr. 5, 1971.

2) Gazeta «Flamuri i Shqipërisë». Kostancë, 1.VIII.1916.

tur dhe për t'i uruar mirëseardhjen atij, i cili megjithëse kishte ikur shumë i vogël prej atdheut, nuk harroi se ishte shqiptar. Po atë mbrëmje Moisiu dha shfaqjen e parë në teatrin «Carol del Mare» me pjesën «Hamleti». Gjysma e sallës dhe e lozhave ishin zënë prej shqiptarëve të Bukureshtit, të cilët patën fatin ta duartrokasin dhe t'i hedhin buqeta lulesh në skenë.¹⁾

«Erdha në Rumani të falënderoj Viktor Eftimiun se më shpëtoi prej kampit të përqëndrimit»,²⁾ i deklaroi ai një gazetari gjerman.

Shfaqjet triumfuese në teatrin «Eforia» të Buku-reshtit dhe pritet e përzemërtë e forcuanc miqësinë e singertë midis dy bashkatdhatarëve të mërguar.

*

* * *

Pas një dhjetëvjeçari, më 1924, Moisiu shkoi për të dytën herë në Bashkimin Sovjetik. Ai e ndërmori këtë turne me një dëshirë dhe gjëzim të veçantë, sepse shkonte sërisht në atdheun e Tolstoit dhe të Çehovit, të Gogolit dhe të Gorkit, që i adhuronte. Moisiu, që ushqente ideale përparimtare e revolucionare, ndiente krenari dhe gjëzim që viziton vendin ku shpërtheu Revolucioni i Madh i Totorit, vendin e parë socialist.

Aleksandër Moisiu ishte i pari ndër aktorët e më-dhenj të huaj që viziton Rusinë pas triumfit të Revolucionit Socialist. E bëri këtë pa marrë parasysh shpifjet e tërbuara të propagandës borgjeze kundër Revolucionit të Totorit dhe bolshevikëve, pa marrë parasysh kërcënimet e reaksionarëve. «Unë bëra turneun tim të katërt në Rusi ku qëndrova gjashtë javë, — theksonte Moisiu në një intervistë. — Dy herë kam qenë para Lufte në Rusi dhe dy herë të tjera këto vitet e fundit. Kësaj here unë luajta në Teatrin Artistik të Moskës dhe në Lenigrad me Stanislavskin e pakrahasueshëm. Unë u paraqita

1) Gazeta «Shqipëria e Re», Bukuresht, 15 janar 1922.

2) V. Eftimi, «A. Moisiu». Revista «Nëntori» Nr. 5, 1971.

si Hamleti, si Fedia te «Kufoma e gjallë», si Osvaldi në «Hijet», në pjesën me një akt «Ai është fajtor për të gjithë» dhe si Edipi. Këtë rol e luajta në Teatrin e Operas para 2500 spektatorëve.

Rolin tim, — kujton Moisiu, — unë e luajta në gjuhën gjermane, e megjithatë me partnerin rus çdo mbrëmje kishte një unitet harmonik të shkëlqyer. Gjuha nuk ndihet si diçka kufizuese, sepse nuk është fjala, po mendimi ai që ka rëndësi të përhershme në veprën e artit». ¹⁾

Në kujtimet e saj Tervini, bashkëshortja e tij, shkruan: «Me të arritur në Moskë, Aleksandri filloj një punë të madhe. Provat me aktorët rus ishin të vështira, sepse Moisiu interpretonte në gjuhën gjermane, kurse kolegët rusisht dhe çdo gjë duhej harmonizuar. Po me çfarë entuziazmi, dashurie dhe durimi zhvilloheshin provat me aktorët! Megjithëse flitej në gjuhë të ndryshme, ne punonim me orë të zgjatura pa ndier asnjë lodhje. Moisiu përgatiste interpretimin e Fedias në «Kufomën e gjallë» të Tolstoit dhe «Hamletin» e Shekspirit.» ²⁾

Premiera e «Hamletit» u dha më 14 mars 1924 para një publiku që mbushte plot e përplot sallën e teatrit. Dalja në skenë e Moisiut u përshëndet me entuziazëm dhe, pas çdo akti, publiku shpërthente në duartrokitje të stuhishme. «Njerëzit, — kujton Tervini, — rrinin në sallë me zemër dhe shpirt, dhe javë të tëra shkëmbenin mendimet, përshtypjet dhe ndjenjat për atë që kishin parë dhe jetuar në skenat e teatrit». ³⁾

Në Moskë Moisiut iu bë një pritje e ngrohtë. Që të nesërmen Moisiu u prit nga Lunaçarski dhe zhvilloji me të një bisedë të përzemërt. Pas këtij takimi, Lunaçarski thoshte me dashuri: «Ai (Moisiu — shënim i ynë) është një aktor i vërtetë, një intelektual i vërtetë përparimtar evropian. Ai shfaqi mjaft interes për atdhe-un tonë, kryesisht për marrëdhëniet e reja ndërmjet

1) Gazeta «Neue Frei Presse», Prill 1924.

2) J. Terwin — Kujtime, Theatersammlung, Vjenë.

3) J. Terwin — Po aty.

njerëzve në shoqërinë socialiste, për literaturën, teatrin, edukimin». ¹⁾

Seksioni i kulturës të qytetit organizoi një pritje të madhe për ndër të tij.

Kostandin Stanislavski duke e përgëzuar Moisiun si artist të madh të skenës i tha «Ju jeni yni» dhe e përqafoi me përzemërsi.

«Mua më thoshin, — shkruante më vonë në përshtypjet e tij Moisiu, — se në Rusinë Sovjetike sot nuk kanë kohë të merren me art, se atje arti është transformuar në agjuracion politik. Shpifje! Unë u binda për larminë e repertorit bashkëkohor dhe klasik të teatrove... Ah, sikur të mos ishin kontratot, të cilat më lidhin duart dhe këmbët, me kënaqësi do të jetova disa kohë në Bashkimin Sovjetik, do të shikoja muzeumet, galeritë e piktorëve, teatrot, do të takohesha me rininë, kolegët». ²⁾

Në Bashkimin Sovjetik Moisiu zuri shumë miq, me të cilët shkëmbente mendime. Ndër më të shquarit ishin Stanislavski, familja e Tolstoit, Lunaçarski, aktorë të shquar të Teatrit Artistik si: Kaçalov, Moskvin, Kniper etj., njerëz të thjeshtë, adhurues të artit. Gjatë kohë që kaloi në Bashkimin Sovjetik, ai diskutoi probleme të artit dhe të dramaturjisë së re. Bashkë me J. Tervinin të shqëruar nga Tatjana, bija e shkrimitarit gjenial rus, ai vizitoi Ermitazhin, shtëpinë muze të Tolstoit, ambiente këto që i bënë një përshtypje të madhe. Tolstoi ishte ndër shkrimitarët më të dashur të Moisiut. Vlen të përmendet se sipas dëshirës së Moisiut, manteli me të cilin ai mijëra herë interpretoi Fedian u vendos pas vdekjes së artistit në muzeumin e Tolstoit. Moisiu vlerësonte lart krijimtarinë letraro-artistike ruse, çmonte shkollën teatrale të Stanslavskit, realizmin e saj.

Aleksandër Moisiu jetonte me proceset e zhvillimeve shoqërore, përpiquej t'i kuptonte ato dialektikisht, të zbu-

1) N. Lunaçarskaja — Rozenjel. Cituar sipas revistës «Nëntori» Nr. 7, 1965.

2) Alexander Moissi über seine Fahrt in Russland (A. Moisiu mbi udhëtimin e tij në Rusi). Gazeta «Algemaïne Zeitung», 6.II.1925.

lonte ndikimet e përbysjeve revolucionare jo vetëm në zhvillimin e përparimit shoqëror, por edhe në botën artistike. Ai përiqejet të futej në përbajtjen dhe pasojat e revolucioneve sociale në zhvillimin e artit, të njihte krizen dhe rënien materialo-shpirtërore të botës kapitaliste, fenomenet e reja të krijimtarisë revolucionare të masave.

Moisiu adhuroi idetë transformuese të Tectorit, realizmin socialist që po çante brazdat e para për zhvillime të reja revolucionare në fushën e krijimtarisë artistike.

Pas largimit nga Moska, Moisiu i ruajti dhe i zhvilloi lidhjet miqësore me njerëzit e shquar të artit socialist. Miqësia e tij me Stanislavskin, Lunaçarskin, familjen e Tolstoit u forcua në takimet dhe përmes korrespondencës që vijoi deri vonë. Në letrën që Stanislavski i dërgonte Moisit në janarin e vitit 1925, shkruante:

«Miku im i dashur, Aleksandër Moisi!

Njerëz dhe artistë të mëdhenj si ju i përkasin gjithë botës. Prandaj ju quaj si shokun tonë të dashur dhe si artist të Teatrit Artistik të Moskës. Shkoni, udhëtoni në Evropë, po mos qëndroni gjatë atje dhe kthehuni shpejt te ne, në Moskë, në Teatrin Artistik. Do të dëshiroja t'ju shihja prapë midis nesh, përgjithmonë.»¹⁾

Ishë koha kur kultura dhe artet e realizmit socialist, të udhëhequra nga Partia Komuniste e Leninit dhe e Stalinit, po ecnin përparrë me vrull të paparë.

Pas usurpimit të pushtetit dhe të partisë nga udhëheqësit revisionistë hrushovianë në Bashkimin Sovjetik u shkelën me këmbë traditat e shkëlqyera të realizmit socialist dhe iu hap rruga artit dekadent borgjez dhe izmave të ndryshme. Tashmë degjenerimi borgjezo-revisionist ka hyrë në të gjitha fushat e krijimtarisë artistike e kulturore, ky degjenerim po e çon artin sovjetik drejt greminës, drejt shkatërrimit.

1) Cituar sipas Hans Böhm: «Moissi der Mensch und der Künstler» Berlin 1927.

ETAPA E PJEKURISË SË PLOTË

Pas Luftës së Parë Botërore veprimtaria teatrale në Evropën Perëndimore u gjallërua. Në krahasin me periudhën e paraluftës tani bëhej më me lehtësi thyerja e traditave të vjetra teatrale, tashmë të vdekura. Nën ndikimin e luftës klasore edhe në fushën e teatrit, ashtu si në fushat e tjera të artit e letërsisë, u ashpërsua lufta midis rrymave të ndryshme formaliste e dekadente borgjeze dhe realizmit. Si në Evropën Perëndimore ashtu dhe në Amerikë, në këtë periudhë, filluan të lindin shumë rryma të ndryshme formaliste teatrale.

Në Gjermani rryma sunduese në teatër, pas Luftës së Parë Botërore ishte ekspresionizmi. Kjo rrymë u shfaq në artin borgjez që para Luftës së Parë Botërore. Teatri ekspresionist lindi si një reaksion ndaj teatrit natyralist, simbolist e impresionist por që nuk arri ti dot të kapercante kufijtë e përbajtjes artistike, prandaj mbeti një reaksiون vetëm pér formën dhe jo pér përbajtjen e veprës artistike. Në fushën ideologjike ekspresionizmi ishte shprehës i filozofisë iracionaliste, megjithëse brenda përbenda ai brehej nga kontradikta të thella botëkuptimore. Në përgjithësi teatri ekspresionist, në themel, shpreh shpërthimet e botës së brendshme subjektive të artistit. Paqartësia politike e teatrit ekspresionist gjeti shprehjen edhe në përzjerjen e problemeve shoqërore me problemet intime, thjeshtë individuale, personale.

Nga gjiri i ekspresionistëve, nën ndikimin e ideve revolucionare të lëvizjes punëtore në Gjermani e në shkallë ndërkombëtare, do të shkëputen mjaft personalitetë artistikë, të cilët do të luftojnë kundër teorive dekadente

të «artit për art», duke pohuar nevojën e ndërhyrjes aktive në jetë në emër të mbrojtjes së interesave të masave popullore. Ata pasqyronin aspiratat paqedashëse, antikapitaliste, të masave punonjëse gjermane kundër luftës.

Në këtë periudhë të pasluftës, në artin teatral gjerman, dukuria më e qartë dhe progresive mbetej krijimtaria e M. Rajnhardtit.

Ngjarjet e mëdha historike si: fillimi i krizës së përgjithshme të kapitalizmit, Lufta e Parë Botërore dhe Revolucionari Socialist i Totorit, ashpërsimi i luftës klasore në vendet kapitaliste, zgjerimi i lëvizjeve të popujve të varur, krijimi i lëvizjeve të majta dhe i partive komuniste në vendet kapitaliste Perëndimore si rezultat i ndikimit të Revolucionit të Totorit, të gjitha këto shërbjen si shtytje e madhe për zhvillimin e dramaturgjisë të përshkuar nga fryma e luftës klasore dhe e transformimeve të mëdha revolucionare.

Material të pasur revolucionar njerëzve të letërsisë dhe të artit u dhanë veçanërisht ngjarjet e stuhishme revolucionare të viteve 1919-1923 në vendet qëndrore të Evropës si në Gjermani, Hungari, Çekosllovaki, Itali, Austri, Bullgari e gjëtkë, lufta e përditshme e proletariatit në vendet kapitaliste, veprimtaria aktive e partive të reja komuniste, shembulli frymëzues i Republikës Sovjetike të porsalindur.

Idetë e mëdha të zhvillimeve shoqërore revolucionare depërtuan në skena, nga to u ndikuan aktorët dhe regjisorët e zonës gjermane. Këto ishin vitet kur Moisiu filloi të njihte më mirë zhvillimin dhe lëvizjet e mëdha shoqërore. I prirë ndaj ideve socialiste, Moisiu fillon të manifestojë fuqimisht tendencën e aktualizmit të veprave artistike duke interpretuar me realizëm rolet kryesore të dramave të Shekspirit, Gëtes, Shout e Tolstoit dhe duke nxjerrë në pah vlerat e tyre sociale.

Kështu, periudha pas Revolucionit Socialist të Totorit mund të quhet si faza e pjekurisë së plotë artistike të Moisiut, kur ai largohet nga ndikimet e rrymave të ndryshme në art. Në krijimet e tij artistike spikat fuqishëm prirja realiste për t'u futur në mendimet dhe ndje-

njat e personazheve që mishëroi, duke zbërthyer anët socialo-filozofike të brendisë së tyre.

Epoka e re kërkonte ndryshime edhe në artin skenik. Rajnhardi e kishte mbyllur ciklin e krijimeve të konceptuara deri diku në kuadrin e realizmit pa shkuar më tutje demaskimit dhe protestës pasive. Koha kishte hedhur në arenën sociale, pra dhe të artit skenik, idetë e mëdha marksiste-leniniste. Ashtu siç po transformohej mbi baza revolucionare shoqëria, po mbi këtë bazë duhej të transformohej edhe arti, teatri etj. Këtë domosdoshmëri e kuptonte qartë Moisiu dhe luftoi që arti i tij t'u përgjigjej kërkjesave të kohës, ai u ngrit në një shkallë më të lartë pjekurie duke shkuar në këtë drejtim më tej se Rajnhardi.

Në artikullin e tij «Kriza e teatrit gjerman» dhe «Problemet e teatrit gjerman» Aleksandér Moisiu zbuloi shkaqet sociale dhe ideologjike të rënies dhe shthurjes së teatrit borgjez. Duke i parë dhe jetuar këto procese, Moisiu theksonte se një ndër shkaqet e thella të kësaj gjendjeje ishte rënia e përgjithshme ekonomike dhe ideologjike e borgjezisë. Rënia e përgjithshme e borgjezisë, e cila po e tregonte veten si forcë regresive në ideologji dhe art, i hapte rrugën «izmave» të ndryshme, po jo artit të vërtetë. «Kriza» e teatrit, sipas Moisiut, ishte shkaktuar gjithashtu edhe nga fakti se disa regjisorië e kishin zhveshur aktorin nga personaliteti dhe individualiteti i tij njerëzor, duke e shndërruar në një kukull. Regjisura kishte bërë qëllim në vetvete shkëlqimin dhe lustrën e jashtme, duke i kushtuar më shumë kujdes dekorit, trukeve, dritave dhe efektit skenik. «Publiku, — nën-vizonte Moisiu, — duhet të shohë prapë në skenë njeriun, ta dëgjojë atë... Pasqyrimi i njeriut, ja ku fshihet fenomeni më madhështor, përjetësisht i ri, tronditës. Dhe një gjë të tillë mund ta japë vetëm një teatër i ri. Për këtë arsyё spektakli duhet ndërtuar jo sipas metodës së ekspresionizmit dhe as të konstruktivizmit ose të ndonjë «izme» tjetër, po në forcën e fjälës».¹).

1) Revista «Жизнь и искусство» (Jeta dhe arti), Nr. 5, Moskë 1924.

Duke kapërcyer teatrin natyralist, që ishte i paaftë për përgjithësime të fuqishme, Moisiu nuk ra në ekstremin tjetër. Ai iu shmang, përbuzi dhe luftoi formalizmin, ekspresionizmin, simbolizmin, etj. «Uf! — pshëretinte Moisiu i mërzitur. — Nuk kemi kohë të marrim frymë dhe menjëherë nga shtigjet e errëta e rrugicat dëgjohen klithma të rrezikshme: Arti mundet dhe duhet të jetë antrosofik, teosofik, neopatik». Moisiu kërkonte me durim të përcaktonte dhe përpunonte drejtimin e tij artistik realist. Ai theksonte me bindje se: «Egërsimi i ndjenjave, mungesa e ideve dhe dashuria për krijimin e «izmavë» të ndryshme nuk tregon se arti është në rrugë të drejtë.¹⁾ Ai thellohej gjithnjë e më shumë në konceptimin e asaj që interpretonte duke kërkuar forma dhe mjete për të shprehur thelbin, kuptimin e thellë të asaj që thoshte.

Moisiu i shikonte me shqetësim deformimet dhe rrugën e shtrembër që po merrte teatri borgjez, i cili, si edhe gjinitë e tjera të krijimtarisë, po bëhej arenë e përhapjes së ndikimeve moderniste dhe «izmavë» të ndryshme. Ai ishte për një teatër progresist e popullor, institucion me vlera pozitive edukuese. «Te ne, në Gjermani, — shkruante Moisiu, — teatri ndodhet në dekompozim e sipër. Nga rënia e teatrit, natyrisht, është prekur më tepër pjesa teatrale që arrin të mbahet në këmbë vetëm nëpërmjet dekoreve të pasura.

Meqenëse marifetet e regjisë kërkojnë shumë shpenzime, çmimet e hyrjes janë rritur vazhdimisht, dhe nga kjo, për shtresat e publikut të interesuarë për artin, skena mbetet e mbyllur si «institucion moral». Kështu që unë kam kohë që po mendoj për krijimin e një teatri të madh për popullin me çmime sa më të ulëta dhe unike, domethënë për një teatër proletar dhe për këtë dua të vë në lëvizje mjaft aktorë që luajnë rol në jetën teatrale. Unë kam parasysh një skenë e cila të ketë yetëm kulisat më

1) Aleksandër Moisiu «Проблемы современного театра» (Проблемы театрата в СССР) Revista «Жизнь и искусство» Nr. 5, 1924.

të nevojshme dhe ku çdo gjë të mbështetet te fjala e thënë dhe te interpretimi. Sepse «fjala» në vetvete është e lirë. Në qoftë se kjo, që gjer tani është propozim dhe plan, do të vihet në jetë, atëherë do të fillojë një epokë e re dhe shpresoj e vazhdueshme për teatrin serioz, dhe para së gjithash për pjesët teatrale që përdoren si bij të njerkës».¹⁾

Moisiu, me gjithë pengesat dhe vështirësitë tekniko-materiale u orvat për të vënë në jetë projektin e tij. Ai grumbulloi rreth vetes një bërrhamë aktorësh të shquar progresist si A. Baserman, Evans etj., dhe duke përdorur me shkaktësi mjetet më të thjeshta skenike, si projeksionin, vuri me sukses Faustin e Gëtes, që u shfaq në shumë skena të vendeve evropiane.

Ndikimi i proceseve të mëdha revolucionare solli një evolucion të madh në konceptet e tij ideoartistike, e brumosën artistin e madh me idetë e vërteta mbi artin skenik, të cilat u reflektouan në lojën e interpretimit, në skalitjen sa më realiste të figurave të mëdha letrare duke materializuar në to impulset sociale. Moisiu fillon të njohe dhe të zotërojë dialektikën e fenomeneve, të thellohet në to, përpinqet të kuptojë proceset dhe kontradiktat sociale. Kjo ngritje ideoestetike, intelektuale dhe shpirtërore u pasqyrua qartë në tërë krijimtarinë artistike të Moisiut, i cili i qëndroi larg çdo natyralizmi dhe «izime» tjetër në skenë.

Në këtë fazë të zhvillimit të tij, të pjekurisë së tij si artist, ai zbuloi plotësisht madhështinë e vetvete. Duke rivënë me një këndvështrim dhe koncept të ri rolet kryesore të Shekspirit (Hamletin), të Bernard Shout (Dubedatin), të Gëtes (Faustin) dhe të Tolstoit (Fedian), Moisiu ngrihet në piedestalin e artit skenik botëror, i adhuruar nga publiku i Evropës dhe i kontinenteve të tjera, nga shkrimtarët dhe kritikët, nga gjenerata e rinisë së atëhershme, pasionet dhe aspiratat

1) A. Moisiu «Die Krise des deutschen Theaters» (Kriza e teatrit gjerman»).

e së cilës ai i mishëroi me shkëlqim në krijimet e veta.

Të ndalemi shkurtimisht në këto katër krijime të Moisiut:

Rolin e Hamletit, të cilin Moisiu e kishte interpretuar më 1909 nën regjinë e Rajnhardit, ai e përsosi duke i dhënë poezisë shekspiriane gjenialitetin e interpretimit, virtuozitetin shpirtëror dhe muzikalitetin e mrekullueshëm, po mbi të gjitha zbuloi vlerat sociale, duke i dhënë një përmbajtje të re filozofike, duke sintetizuar një epokë të tarrë. Në qoftë se në dekadën e parë të shekullit tonë personazhi i Hamletit u dha i mbështjellë nga një tis pesimizmi, delikatese, melankolie, si një njeri i dërrmuar shpirtërisht e një ironizues i vëtmuar, (në periudhën e viteve të Luftës së Parë ai e interpretoi sipas mënyrës së ekspresionizmit), më vonë, në vitet njëzetë Moisiu e pasuroi lojën e vet në rolin e Hamletit, duke zbuluar përmbajtjen sociale dhe njerëzore të kësaj figure monumentale.

Moisiu e skaliti Hamletin gjatë tarrë rrugës së krimtarisë së tij (gati tri dekada). Kjo ishte rruga e evolucionit të Moisiut si aktor, e formimit dhe e pjeturisë së tij.

Metamorfoza e këtij roli u duk qartë në të tria etapat e zhvillimit të tij. Në fillim të krimtarisë së tij, Moisiu mishëroi te Hamleti anën sentimentale, melankolinë dhe dhembjen shpirtërore. Më pas, ai e mbushi këtë rol me humanizëm e cilësi njerëzore dhe nga fundi, në etapën e pjeturisë së tij si aktor, Moisiu vendosi në skenë Hamletin kryengritës, që gris maskën e sovranëve, luftëtar të idealeve humanitare. Hamleti i Moisiut nuk ishte thjesht një vrasës i etur për hakmarje, po një demaskues i mbretërve; revolta e tij fiton një përmbajtje të gjerë që përshkohet nga një notë e theksuar sociale dhe përgjithësuese. Në Hamletin e Moisiut nuk jepet thjesht legjenda e princit të Danimarkës, po nëpërmjet tij jepej revolta e së resë, e përparimtares kundër tiranisë dhe shëmtimave të saj, kundër violencës, intrigës, poshtërsisë tradhtisë, ligësh-

tisë, brutalitetit që rrrethojnë fronet e sovranëve. Hamleti i Moisiut ngrihej me vendosmëri kundër së keqes, ai gjen forcë, fiton guxim, vringllon shpatën, provon mprehtësinë e tehut të saj, duke u hedhur në aksion me bukuri shpirtërore, retorikë të fortë dhe dramacitet. Ai e dha Hamletin me shpirtin e pastër dhe fisionik të një të riu të frymëzuar në jetë nga ide fisnikë.

Roli i Hamletit gjatë shekujve ka qenë ëndërr e aktorëve më të mëdhenj të kohës. «Princip e Danimarkës» e interpretuan Talma, Garrik, Kainc, Barrymore, Rosi, Rici, Oliver, Karavalia, secili me individualitet. Po Moisiu i hyri këtij roli në thellësi me forcën e interpretimit të tij gjenial. Për këtë ishin të një mendjeje shumë kritikë të njohur.

«Roli i Hamletit, — shkruante Feliks Salten, — paraqet sot shkallén më të lartë që ka dhënë përsosja artistike e Moisiut. Ai këtë rol nuk e krijoj përnjëherë e që me hovin e parë, megjithatë, ai e rroku njëherë konceptin gjenial e krejt njerëzor të kësaj figure të pavardekshme. Që në skenën e parë ai rrëmbeu publikun... Kurrë ndonjëherë nuk ishte parë që të shfaqej Hamleti që në aktin e parë aq thjesht dhe aq prekës nga ana njerëzore... Hamleti i Moisiut është i pasur me shumë çaste të një mjeshtërie të madhërishme, i pasur në skena ku ana njerëzore dhe ana teatrale arrijnë në një shkrirje të plotë».¹)

Maks Brod shkroi këto rreshta pas shfaqjes së Hamletit: «Unë asnjëherë nuk e kam parë pjesën e Hamletit të luajtur kaq bukur, asnjëherë nuk e pashë Moisiun të luante kaq bukur si në këtë të shtunë mbrëma, që filloi me mërzitje dhe mbaroi me sukses të madh. Hamlet dhe Moisi, ju falem nderit! Si duket të dy janë bërë për njëri-tjetrin. Hamleti është shkruar për Moisiun dhe Moisiu ka lindur që të interpretojë Hamletin, dhe vetëm ai të interpretojë Hamletin».²)

1) Felix Salten «A. Moissi», Berlin 1920.

2) Max Brod «Sternenhimmel» (Qielli i yjeve), Munchen 1923.

Me një forcë të madhe artistike interpretoi Moisiu rolin e Dubedatit në pjesën e B. Shout «Dilema e mje-kut». Piktori Dubedat — Moisi u paraqit me tërë bukurinë e tij shpirtërore, pastërtinë dhe fisnikërinë e ndjeknjave, humanizmin dhe madhështinë e tij si njeri. I varfér materialisht, por i pasur në ndjenja, talent dhe virtute, Dubedati ua grisi vellon e rreme dhe shkëlqimin fals «ruajtësve të moralit» borgjezo aristokratik, fjalamanëve idiotë e pa vlerë njerëzore, po që paraja u kishte dhënë pushtet dhe luks. Tërëjeta e Dubedati — Moisi qe shumë më e pasur, më e bukur dhe më fisnike nga jeta plot ndriçim të zbrazët e shoqërisë borgjeze dhe atyre që bë-nin ligjet e saj. «Ky piktori i ri e i varfér, ishte një gjeni dhe të gjitha ato që ai merrte për vete ia jepte një e drejtë më e lartë, që ligjet borgjeze nuk mund ta njo-hin... Jetën e tij të shkurtër ai e mban plotësisht të pastër, larg çdo paragjykim, shumë më lart se morali hipokrit i mikroborgjezit filistin, në një etikë që shkëlqen kaq shumë nga pastërtia dhe të mbushur kaq shumë me poezi».¹⁾

Moisiu — Dubedat shpalosi gjerësinë e shpirtit të artistit, finesën e ndjenjave të tij, altruizmin e tij ndaj njerëzve të thjeshtë, ndaj shërbëtores, kolegëve, bashkë-shortes. Prekëse qe dashuria e Dubedatit për të shoqen. Moisiu tregoi se sa madhështore, se sa optimiste, sa vëtmohuese, përnderuese dhe e pastër mund të jetë dashuria e një artisti. Loja e Moisiut. — Dudebat ishte mjaf e qartë, fisnike. Një lojë e pastër, e tejdukshme duke i bërë të kuptueshme deri në detaje të gjitha veprimet dhe raportet e tij njerëzore. Kur jetonte, ai dashuronte, shpër-thente në gjëzime të ciltra e të pastra. E paharrueshme qe skena e fundit. Moisiu, në agoninë e vdekjes, gjeti forca për ta shprehur natyrshëm buzëqeshjen e Dubedatit, duke thirrur fotoreporterin që çdo gjë të dilte bu-

1) Cituar sipas Hans Böhm «Moissi, der Mensch und der Künstler», Berlin 1927.

kur në gazeta. Dhe këtë ai e bëri me një forcë të madhe realiste dhe plot hir.

Skena e vdekjes së Dubedatit, në aktin e katërt, ishte një kryevepër e vërtetë e ndërthurjes së ndjenjave, të patosit dhe ironisë. E paharrueshme mbetet ajo skenë, kredoja e tij shpirtërore: «Unë besoj në Mikelanxhelon, në Velaskezin e në Rembrandin, në fuqinë e vizatimit, në misterin e ngjyrave, në zhdukjen e të gjithë të këqijave nëpërmjet bukurisë së përjetshme dhe në misionin e artit që i ka bekuar ato duar...» Moisiu i shqiptoi këto fjalë plot kuptim me gjithë ndjeshmérinë e madhe të qenies së tij, i shqiptoi nga zemra e tij, nga zemra e rinisë, të cilën e ndezi zjarr, nga zemra e tèrë njerëzve që janë pér nga ndjenjat dhe krijimtaria e tyre gjithnjë të rindje e pérparimtarë. Në personalitetin e fortë të Moisiut — Dubedat, pasqyrohej rinia e kohës dhe aspiratat e saj.

«Moisiu, — shkruante F. Salten, — u jepte udhë, u jepte zgjidhje kérkesave të saj (të rinisë — V.M.) pér zhvillim, sa kohë që zhvillohej pérpara syve të tyre edhe ai vetë. Të gjitha sa ndodhin, ndodhin sipas disa ligjeve të caktuara edhe atëherë kur ne nuk e kuptojmë menjëherë ose nuk e kuptojmë fare ligjshmérinë e rreptë të shkaqeve dhe të lidhjeve reciproke ndërmjet fenomeve. Në personalitetin e Moisiut, unë, si në pasqyrë, pashë rininë bashkëkohëse. Ai i jepte forma kësaj rinnie me fuqinë suggestive të artit e të origjinalitetit të tij. I jepte kësaj rinnie dhe ndjenjave të saj një gjuhë, një deklamacjon, një gjest, një muzikë. Ky Dubedat i Moisiut mbetet një ngjarje e pakrashaueshme».¹⁾

Drama «Dilema e mjekut», është një nga kryeveprat e B. Shout, Dubedati i krijuar nga Moisiu një nga sukzeset më të mëdha të krijimtarisë së tij artistike.

Ndër krijimet më të bukura artistike të Moisiut është edhe roli i Faustit të Gëtes. Kjo pjesë e rivënë në skenë nga Moisiu më 1932, me rastin e 100 vjetorit të vdekjes

1) Felix Salten «Alexander Moissi», Berlin 1920, f. 9.

së poetit të madh gjerman, qe një spektakël madhështor. Trioja e korifejve të skenës gjermane Moisi-Baserman-Evans, përkatësish në rolet Faust-Mefistofel-Margeritë, ringjallën me një shkëlqim të ri kryeveprën e Gëtes, të konceptuar dhe zgjidhur nga pozita të reja, revolucionare. Fausti, si lajmëtar i çlirimt të njerëzimit, del fitimtar mbi të keqen nëpërmjet përpjekjesh e sakrificash.

«...Roli i Faustit, — shkruante A. Lunaçarski, — është një nga krijimet më të mëdha të Moisiut. Duke qenë përgjithësish një recitues i madh dhe ndoshta më i madhi i ditëve tonë, ai e lexon veçanërisht në mënyrë deklarative Gëten. Që në fjalitë e para të Faustit juve ju pushton plotësisht timbri i mrekullueshmë i zërit, një farë shqiptimi i butë, i qartë i qdo fjale. Përpunimi i hollësishmë, kuptimi i gjithë asaj që shqiptohet, pastaj në mënyrë të veçantë pasuria e pakrahasueshme e ngjyrave të zërit shoqërohet gjithmonë dhe me gjestet plot hirësi dhe plot kuptim.

Unë kisha për të thënë, — përfundon A. Lunaçarski, — se Fausti i Moisiut është një apoteozë e inteligjencës, e njerëzve të mendjes dhe të ndjenjës së mprehtë... Fausti i Moisiut është jashtëzakonisht simpatik. Ai të mahnit me një forcë ngadhnjimtare. Në momentet kur bie në mendime ose kur është i dëshpëruar, në momentet e hoveve shpirtërore të erotikës, ai gjithmonë e pandërprerje është një njeri i mprehtë, është një njeri i shkallës së parë përsa i përket «pasurisë shpirtërore». Nga natyra e tij Fausti i Moisiut është një figurë e pa-harrueshme».¹⁾

Dramat e L. Tolstoit zënë një vend të rëndësishmë në fondin e artë të dramaturgjisë ruse dhe të asaj botërore. Ato tërhoqën menjëherë vëmendjen për tematikën sociale dhe mprehtësinë e paraqitjes së tyre, për koloretin, për forcën e kritikës kundër falsitetit të marrëdhënieve borgjeze dhe institucioneve që i mbanin ato të

1) Revista «Вечерная Москва» (Moska e mbrëmjes), Moskë, 24 maj 1932.

gjalla, për mjeshterinë artistike të paraqitjes së këtyre problemeve me mjetet e dramaturgjisë.

Moisiu i interpretoi personazhet e dramave tolstojane me dëshirë, pasion dhe forcë të pakrahasueshme artistike. Ai hyri thellë në psikologjinë e heronjve të shkrimtarit të shquar të letërsisë ruse, në filozofinë tolstojane, duke skalitur karakteret e dramave me një forcë të madhe bindëse realiste dhe emocionuese. Rolet: i Nikutës te «Pushteti i errësirës», i Serincevit te «Drita ndriçon në errësirë», i Çirakut në pjesën «Ai i ka fajet për të gjitha» dhe sidomos i Fjodor Protasovit te «Kufoma e gjallë» treguan talentin e madh të Moisiut.

«Kufoma e gjallë», e njojur dhe e vënë në skenë për herë të parë më 1911 nga K. Stanislavski në Teatrin Artistik të Moskës, është jo vetëm një nga veprat e mëdha të dramaturgjisë botërore, po njëkohësisht nga dramat ku Moisiu arriti një nga kulmet e aftësisë së tij interpretuese. «Kufoma e gjallë» u shfaq në teatrot e Vjenës, Çikagos, Berlinit, Milanos, Tokios, Bernës, Parisit, Londrës, Stambollit, Pragës dhe u interpretua nga artistë të ndryshëm si: Xhon Barrymore, Xhekob Ben-Ami, Donald, Vorfi, etj. Por, ndër interpretuesit e personazhit kryesor të kësaj vepre, vendin e parë e zë Aleksandër Moisiu.

Roli i Fedias tërhoqi edhe aktorë të tjerë të shquar si: Baserman, Palenberg, Krause etj, po fakti që dëshira e tyre mbeti pa u realizuar dhe aktorë të tjerë u drujatën t'i hynin kësaj pune, dëshmon përfuqinë e madhe interpretuese të Moisiut, të artistit që e paraqiti Fedian për herë të parë në skenën gjermane.

Fedia ishte roli më i dashur i Moisiut, rol mbi të gjithë rolet e tjerë. «Kulmi i aftësisë artistike të Moisiut — shkruan E. Faktor është paraqitja e figurës së Fedias në dramën «Kufoma e gjallë» të Tolstoit». ¹⁾

Kur ajo vepër ra në dorën e Rajnhardtit, ai dëshironë ta interpretonte vetë këtë rol, po shpejt hoqi dorë nga kjo dëshirë, pasi siç u shpreh ai «Kishte gjetur aktor-

1) Emil Faktor, «Der Schauspieler Alexander Moissi», Berlin 1920.

rin më të përshtatshëm që i duhej për këtë rol». Mendimi i tij ishte fiksuar te Moisiu, për të cilin besonte se do ta paraqiste në mënyrë të plotë atë.

Është mjaft interesante të tregojmë rrrethanat se si Moisiu u njoh me kryeveprën e Tolstoit. «Shtytjen e parë ma dha S. Fisheri, — shkruante A. Moisiu në artikullin e tij «Si e njoha Fedian». — Dhe kjo ndodhi kështu: E takova si zakonisht, një pasdreke çaji... «Mirë që ju gjeta këtu, që dje ju kam pasur në mendje. Lexova një pjesë... atij i thonë rol! Dhe po jua dërgoj që sonte ta shikoni», Dhe pastaj duke qeshur shtoi: «Po, këtë pjesë ama s'e ka botuar shtëpia ime e botimit».

Ne vazhduam të pinim çaj. Dera u hap me rrëmbim, në dhomë u fut si stuhi Feliks Holenderi, m'i mbërtheu sytë, mblodhi dorën grusht dhe e ngriti mbi kokë duke thirrur:

— Moisi! Një pjesë... një rol.., dhe ç'rol, pa! (Natyrisht, ai s'e pat dëgjuar bisedën ndërmjet Fisherit dhe meje).

Pas shfaqjes, atë natë unë interpretova Romeo, gjeta në shtëpi dy pakon me përmasa të njëjta. E hapa të parën (dërguesi S. Fisher): «Kufoma e gjallë» e Leon Tolstoit. Hapa pakon e dytë (dërguesi F. Holender, me një shënim: Lexojeni! Po sa më shpejt!): «Kufoma e gjallë» etj. Duhej të haja darkë... po megjithatë shfletovata shpejt njërin nga librat me faqe ende të paprera... Personat, disa fragmente dhe pjesën e fundit... Nga fjalët e pakta të faqes së fundit kuptova aq sa duhej dhe s'ishte nevoja ta lexoja pjesën. Po, natyrisht e lexova dhe menjëherë u ndodha në leqet e atij Fedias së gjorë... sot dhe përgjithmonë. Një shkëlqim, një rrufe më goditi sytë. Më goditi dhe unë e dija: kjo dashuri që në vështrim të parë do t'u qëndronte të gjithave... Dhe ajo u qëndroi... Unë e mbajta me vete në kohë luftërash dhe rrëmuje... bille edhe para kritikash të mençura apo të qmendura... Po, të kthehem te çështja, Feliks Holenderi dhe unë ishim plotësisht të një mendjeje, po mjeshtri ndodhej në Londër (është fjala për Rajnhardin). Megjithatë, Holenderi i bëri shpejt të 1000 kilometrat Berlin-Londër

dhe ia bëri të njohur Rajnhardtit veprën e Tolstoit. Rajnhardi prishi programet që kishte përgatitur me aq kujdes, Shekspiri u shty, u ndërpre leja... Ai u kthye, iu përvesh punës me tërë atë dashuri fanatike e gjeniale, me fuqinë e tij të pakrahasueshme prej artisti.

Ishte viti 1912.

Që atëherë unë Fedian e kam interpretuar 1200 herë... për të mos pasur keqkuptime po e shkruaj edhe një herë me fjalë: një mijë e dyqind herë!... Një pjesë pa bubullima dhe vetëtima, pa fjalë kumbuese e tingëlluese, jo e rëndë, jo shtypëse, jo erotike, jo demoniane, — bile as me fjalë të urta, as me aforizma të mprehta — vetëm disa këngë cigane, pa stoli të tjera, bile mund të thuash vetëm belbëzime... dhe 1200 herë!... Përpara afro një milion e gjysmë njerëzve unë isha Fedia i Tolstoit. Nga Moska deri në Nju-Jork, nga Osloja deri në Stamboll... dhe gjithmonë e kam ndier refleksin e këtij belbëzimi tolstojan...»¹⁾.

Drama «Kufoma e gjallë» trajton një subjekt social. Fedia, personazhi qëndror, është martuar me një grua nga një klasë e privilegjuar. Sipas «kodit të nderit» të kësaj klase shoqërore ai është i paaftë për një jetë të rregullt. Fedia Protasov, pasi prishi pasurinë e së shqes, largohet nga shtëpia. E shoqja, duke besuar se ai ka vdekur, martoitet, përsëri. Po Fedia nuk ka vdekur. Vjen një kohë kur prania e tij në këtë botë kërcenon jo vetëm lumturinë, lirinë e gruas së tij por edhe të burrit të saj të dytë... Pikërisht tanë Fedia ndien një ngritje shpirtërore, që lulëzoi përsëri mbi pavleftësinë dhe shthurjen e tij të dikurshme.

Për të kuptuar planin e ndërtimit të kësaj drame duhet ditur se ligjet ruse të shkurorëzimit, që mbizotëronin në atë periudhë, ishin shumë të rrepta. Fedia nuk ka forca të dalë përparrë provës së rëndë për ta lënë të lirë gruan e tij që të martoitet përsëri.

E shoqja mendon se është e lirë, ndërsa ai endet

1) Aleksandër Moisiu «Si e njoha unë Fedian» cituar sipas H. Böhm. Moissi, der Mensch und der Künstler, Berlin 1927.

fshehurazi nëpër lagjet më të varfëra të qytetit, në shqërítë gazmore të ciganeve. Ai u fajësua për mashtrim dhe tenton të vrasë veten.

Moisiu e interpretoi Fedian, burrin endacak, jo me një pamje të ashpër dhe të vrazhdë, po me një butësi sentimentale. Moisiu bëri të mos vihej re e meta e tij si pianec, duke e dhënë me një delikatesë dhe natyrshmëri shpirtin e tij plot kontradikta. Sensibilitetin, dobësitetë shpirtërore, impulset sensuale, tekat dhe kapriçiot Moisiu i paraqiti të gjitha jo si fragmente të palidhura të një individi, po si pjesë përbërëse të karakterit të Fedias, të një njeriu të gjallë, duke i shtuar, bile, disa tipare të tij emocionale. Fedia i Moisiut është një njeri që nuk është mësuar me botën, jeton i mbyllur, është i pakë-naqur bile edhe nga shoqëria e lirë dhe e qetë e ciganëve, ku jeton i rrëmbyer nga ëdashuria për muzikën dhe ciganen Masha.

Moisiu e paraqiti Fedian, si një èndërrues të përmbajtur, të pazot, si një njeri që nuk ndien e nuk punon ashtu siç thonë parimet dhe normat e klasës së privilegjuar, por edhe që nuk ka forcë t'i kundërshtojë ato, Moisiu nuk e idealizon Fedian. Ai e interpretoi heroin e Tolstoit gjysmëmendimtar, gjysmëvagabond, siç ishte në të vërtetë, pa karakter, një kriesë impulsive, mjaft e fortë për t'u kënaqur në jetë, po njëkohësisht edhe aq e dobët për ta drejtuar atë.

Fedia i tij ishte prekës: një njeri i mashtruar, i munduar, që nuk e do të keqen, por as që di ta luftojë atë. Fedia nuk di as ku ndodhet e mira, prandaj ai ndihet dhe jeton i vetmuar në botën e tij të zbrazur. Aiendet si një njeri i humbur, pa plang e shtëpi, si një kufomë e gjallë.

«Protasovi i Moisiut, — shkruan N. Lunaçarskaja, — ishte një shpirt i hedhur, i ardhur nga një botë tjeter. Moisiu dukej aq i ndershëm dhe aq naiv, si një foshnje që vritej lehtë në mes të njerëzve servilë dhe egoistë. Marrëdhëniet e tij me Mashën nuk kishin asgjë të ngjashme me «dashurinë» e zotnisë me ciganen. Për të Masha ishte mishërim i këngës së lirë, herë të gëzueshme dhe

herë të përmallshme. Fedia Protasovi i krijuar nga ai, ishte një qenie që ekzistonte në jetën e tij të veçantë shpirtërore; me ata që e rrethonin dhe nga të cilët deshi të ikte, ai sillej urtë, duke falur çdo gjë, megjithëse nuk merrete pjesë në shqetësimet e tyre dhe as në moralin e tyre servil...»¹⁾.

Duke zbuluar dobësitë e karakterit dhe kontradiktat e Fjodor Protasovit, dialektikën e shpirtit të tij, Moisiu ngrihet mbi personazhin e tij si një akuzues i pabarazisë shoqërore, duke iu kundërvënë ligjeve trashanike dhe mizorisë së shoqërisë së atëhershme.

«Kufoma e gjallë», si dhe dramat e tjera reflektonin filozofinë tolstojane të moskundërshtimit të së keqes me dhunë.

Me rolin e Fedias, Moisiu u pranua njëzëri si interpretuesi gjenial dhe më i talentuar i heronjve të Tolstoiit.

Një lojë të bukur dhe mjaft të qartë realizoi Moisiu në pjesën e B. Shout «Tepër e vërtetë pér të qenë e mirë». Në vështrimin e parë, pas Edipit, Hamletit, Protasovit, ku Moisiu paraqiti plot zjarr dhe vërtetësi tragjedinë e njeriut të vetmuar, të humbur dhe të mybutur nga ambienti rrethues plot intriga dhe gënjeshtra, tek pjesa e B. Shout atij i duhej të shfaqte me një cinizëm dhe emocionalitet figurën e një njeriu kompleks, të një banditi «të pandërgjegjshëm».

Në rolin e një gangsteri, ai ka grabitur vajzën e bukur të një milioneri dhe e shpie «viktimiën» në një vend të fshehtë në fund të botës, duke i kërkuar babait të pasur një shumë të madhe të hollash.

Kështu, gangsteri dhe «viktima» e tij ndodhen në breg të detit në një nga ishujt e vetmuar të tropikut... të veshur me rroba banje ata bisedojnë.

Moisiu, — me një trup plastik në ngjyrë bronz, me një buzëqeshje rinore i tregon «viktimës» së tij se ai

1) N. Lunaçarskaja-Rozenjel. Cituar sipas Revistës «Nëntori» Nr. 7, 1965.

është një pilot ushtarak që për shërbime në luftë ka marrë mjafit dekorata. Pas luftës, Anglia e priti atë me ftohtësi dhe ai nuk mundi të rregullojë qetësish jetën e tij në atdhe. Atij nuk i mbeti veçse të bëhej grabitës, kusar, njeri kundër ligjit. Moisiu-pilot, të tërë këtë autobiografi në formë monologu të zgjatur dhe mjafit të vështirë e realizoi në mënyrë të shkëlqyer, herë-herë duke ushtruar gjimnastikë, herë duke i hedhur vajzës një top të madh me ngjyra, herë duke u rrotulluar mbi hekur. Ai e kreu monologun pa asnjë tension, pa lodhje, pa monotoni duke bërë ushtrime të vështira gjimnastike, që për moshën e tij, tanimë pesëdhjetëvjeçare, ishin të pabesueshme.

Monologu ishte plot ide, sarkazëm, ironi dhe kur vajza e qorton ish-pilotin për mungesë humanizmi dhe shpirtegërsi të pamoralshëm, ai i përgjigjet se të gjitha dekoratat e arta i kësaj marrë për bombardimin e qyteteve paqësore, për masakrat e përbindshme që shkaktonin bombat vdekjeprurëse që ai vërviste mbi kryet e njerrëzve të pafaj, fëmijëve, nënave, pleqve etj. Dhe këtë masakër të përbindshme e quanin akt heroik... dhe si-gurisht në krahasim me këtë të kaluar kriminale, profesioni i gangsterit ordiner ishte një fisnikëri...

Në rolin e pilotit-bandit, A. Moisiu demaskoi më zjarr dhe urrejtje hipokrizinë dhe egërsinë kriminale, antinjerëzore të shoqërisë kapitaliste ku paraja deformon shpirtin njëzetor dhe kthen në mall çdo gjë, që nga talenti i piktorit dhe idetë e shkencëtarit e deri tek nderi i vajzës. Ky bandit nuk është më i keq nga ujqit e tjerë të strofkës së tij qofshin ata pronarë apo bandierë. Në stalin e tyre sundon kriminaliteti dhe banditizmi. Moisiu e realizoi me thjeshtësi, vërtetësi dhe sinqueritet rolin e këtij «banditi», që u bë i tillë «pa vullnet» duke i dhënë pjesës një aktualitet të imprehtë dhe kuptim të drejtë.

I tërë monologu u ndërpren disa herë nga stuhi duartrokitjesh. Publiku brohoriti miqësish jo vetëm interpretimin e bukur të Moisiut por edhe idetë e B. Shout.

Në interpretimin e tij të fuqishëm, rolet më të njo-

hura të dramaturgjisë përparimtare botërore u gjallëruan dhe tingëlluan me një forcë më të madhe dhe nën një dritë të re.

Moisiu u ngrit mbi interpretët paraardhës dhe ata bashkëkohorë pér domethënien e thellë ideoartistike që shprehte me anë të figurave të tij, ku spikasnin tingëllimi aktual, fuqia mahnitëse përgjithësuese dhe mishërimi i tyre i përsosur realist. «Me artin e tij të interpretimit, — theksion E. Oktrova, — Moisiu shënoi një zhvillim dhe ngritje të mëtejshme të artit realist të interpretimit në mjeshtërinë e aktorit duke i zgjeruar kufijtë e artit të tij në proporcione botërore. Pa qenë gjerman u çmuia si interpreti më i madh i Gëtes dhe Shilerit, pa qenë rus u cilësua si interpreti më i madh i Tolstoit, pa qenë anglez u vlerësua si interpreti më i madh i Shekspirit dhe Shout». ¹⁾

Njerëzit, bashkëkohësit e tij, të gjithë ata që e panë në skenë, pavarësisht nga kombësia që kishin, vërejtën te Hamleti, Fausti, Fedia, Dubedati, Osvaldi, përgjithësisht te heronjtë e Moisiut, aspiratat, ndjenjat, përpjekjet dhe luftën e inteligjencës demokratike bashkëkohore, të gjeneratës së re pér progres, kundër despotizmit, e tiranisë, kundër dhunës e moralit borgjez aristokratik, sistemit kapitalist që e kthen njeriun në një kufomë të gjallë, kundër të gjitha forcave regresive obskurantiste, gjithashtu panë revoltën e njeriut të ndershëm, të pasur me virtute dhe aspirata fisnike.

«Moisiu, në të gjitha rolet e interpretuara prej tij me gjenialitet, — shkruan I. Hoxha, — ishte gjithmonë heroï i drobitur, ose njeriu i «Qytetit të madh evropian» që sillte me vete notat tragjike të heroit që digjesh pér të jetuar, po që në kushtet e realitetit të një shoqërie të mbushur me kontradikta është i destinuar të vdesë. Po vdekja tragjike e këtyre heronjve ishte kushtrim i guximshëm». ²⁾

Figurat e thjeshta, e në mënyrë të veçantë të nje-

1) E. Oktrova, *Gazeta* «Zëri i popullit», 2 prill 1975.

2) I. Hoxha, *Gazeta* «Bashkimi», 22 mars 1960.

rëzve të vuajtur, të shtypur e të shfrytëzuar, Moisiu i ngrinte në simbole të mëdha, fisnike, të luftës së njerëzve për një jetë më të bukur, më të pastër, më të lirë.

Kritikët kanë shfaqur mendime të ndryshme për çështjen se cili ka qenë për Moisiun personazhi më i preferuar dhe cilin rol ka luajtur ai më mirë. Në një intervistë dhënë korrespondentit të gazetës «Daily Meil» të Londrës, Moisiu u shpreh: «Dilema e mjekut» e B. Shout ka qenë një nga sukseset e mia më të mëdha në Austri dhe Gjermani. Supozoj se dy nga shfaqjet e mia më të njohura janë: «Jederman» dhe «Kufoma e gjallë» e Tolstoi.¹⁾

Megjithatë, një gjë është e vërtetë dhe e pranueshme nga shumica: Aleksandër Moisiu i donte, i vlerësonte dhe punonte me ngulm e dashuri për të gjitha rolet që interpretonte. Për të nuk kishte «role të mëdha» dhe «role pa rëndësi». Dhe pikërisht se punonte me dashuri, këmbëngulje për të gjitha rolet, se i donte njësoj të gjitha, ai shkëlqeu me madhështi në interpretimin e një galerie të tërë rolesh të dramaturgjisë botërore. Hamleti, Otello, Dubedat, Fedia, Franc Mor, Fausti, Osvald, Taso, Romeo, Jederman, Markiz Poza, Golo, Fiesko, Orest etj. etj. të gjitha këto figura të dramaturgjisë botërore Moisiu i interpretoi duke iu kushtuar zemrën, temperamentin, vullnetin, ndjenjën, logjikën dhe pasionin e tij pa rezerva. Dhe në çdo personazh ai vuri vulën e karakterit dhe temperamentin e tij, në çdo rol transfuzonte nervin dhe gjakun e tij, gëzimin dhe hidhërimin e tij, ngazëllimin dhe melankolinë e tij, butësinë dhe ngrohtësinë e tij, gjithë koloritin e ndjenjave të vërteta njerëzore.

1) Gazeta «Daily Meil» Londër, 19.V.1934.

ZËRI, MIMIKA DHE FORCA INTERPRETUESE E MOISIUT

Në skenë Moisiu paraqiste aktorin që tërë shpirtin e tij, nervat, gjakun, ndjenjat, lëkurën dhe flokët e tij; të gjitha i vërvit furishëm në shtratin e veprës dramatike.

Fjala, gjesti, lëvizja mimika e shndërronin atë në një artist të madh, që me forcën e vet interpretuese magjepsi të gjithë ata që e panë dhe admiruan lojën e tij. Fuqia krijuese e interpretimit të Moisiut pasqyrohej në stilin e lojës, fisionominë e tij, në organin e tij vokal, hirësinë e gjestit dhe të lëvizjeve të tij. Të gjitha këto, të sintetizuara, e bënë Moisiun një ndër artistët më të mëdhenj të epokës së tij, qoftë pér nga individualiteti i tij artistik ashtu edhe pér nga popullariteti që fitoi në të gjitha ato vende në skenat e të cilave luajti.

Te Moisiu çdo gjë ishte e harmonishme: gjuha, ftyra me atë fuqi jashtëzakonisht shprehëse, gjesti dhe lëvizjet e tij. Kjo harmoni spikaste tek ai në rolin e Hamletit, kur qëndronte i heshtur përpara fronit të uzurpatorit, por i mbushur plot indinjatë dhe akuzë; në rolin e Franc Morit, kur kërcente i shkathët si një mace mbi muret e fuqishme të zakonit dhe ngrihej pastaj shpresë-humbur kundër gjyqit, të cilit vetë ia kishte deponuar të gjitha. Tërë harmoni ishte ai në rolin e Edipit, kur i kërrusur me një dashuri të dhembshme dhe me një buzë-qeshje të mjerë, kërkonte ndjesë para Jokastrës; në rolin e Dantonit kur përkëdhel lulet, tek po i jepte lamtumirë njerëzve përpara arrestimit dhe vdekjes; në rolin e Fedias, kur shpaloste shpirtin e tij kontradiktor dhe të ndërlíkuar.

Intuita e tij rrokte dhe shprehte me të njëjtën etje dhe forcë si kënaqësinë e atij që dashuron ashtu edhe lumturinë e mprehtë mendore të kalkulatorit, si britmat e dëshpërimit dhe të dyshimit të mbretit, ashtu edhe frikët tallëse të një bufoni tek e ngacmojnë të tjerët. Gjithçka për Moisiun ishte një formë e asaj që ai e ndiente aq fuqishëm, aq në mënyrë të papërbajtshme në veten e tij.

Moisiu kishte një fytyrë me plasticitet të mahnitshëm. Disi e verdhë, e thatë, me buzë të gjëra dhe gojë të madhe, fytyra e tij kishte lëvizshmërinë e të gjitha vijave dhe tipareve. Kjo fytyrë herë merrte pamjen groteske të një palaçoje, herë shprehte zbetësinë tronditëse të të vdekurit. Ai dinte t'i jepte fytyrës së vet shprehjen e një fëmije që çuditej, lakminë e njeriut me kënaqësi të pangopura, shprehjen e saktë dhe të caktuar të një delikatese të ëmbël si dhe të një talljeje sarkastike. «Fytyra e tij, — shkruante J. Bab, — është fytyra e një shenjti dhe e një të degjeneruari, e një fanatiku të së mirës dhe ajo e një krimineli; ajo është fytyra e një artisti të madh që çdo gjë njerëzore, qoftë atë më të lartën, më fisniken, qoftë dhe atë më të ultën, di ta rrokë thellë me intuitën e tij, di ta jetojë, ta transformojë në një personazh të gjallë. Moisiu i manovronte maskat shprehëse të fytyrës me një shpejtësi dhe violencë të çuditshme».¹⁾

Moisiu zakonisht nuk bënte makiazh. Plastika e pasur e mimikës i jepte fizionomisë së tij herë bukuri mahnitëse, herë pamjen e parregullt dhe të tmerrit. Kjo mimikë, me sytë e tij, me anë të habisë, të shtangies, të qeshjes, të jepte edhe afrimin e shtërngratës së ndjenjave dhe ngrohtësinë e rrezeve të diellit pranveror. «Mimika e fytyrës së Moisiut ose më mirë të themi loja e vijave të saj, — shkruante Julius Bab, — spikat befas me bujë si një mjet efekti mbizotërues dhe i vrazhdë, duket, dhe është këtu vetëm natyrë, asgjë tjetër veç natyrë, temperament tek ai... i cili shndërron çdo impuls të brend-

1) Julius Bab «Deutsche Schauspielerporträts aus Berlin und Wien», Berlin 1908.

shëm me një fuqi të papërbajtshme, në dukuri trupore nga më të fortat. Po aq i shkathët, po aq i ndezur paraqitet edhe trupi i tij i brishtë, i pafuqishëm si ai i një çunaku, ky trup që s'ka si bëhet më i lëvizshëm, me ca gjymtyrë që në një rast krijon disa gjeste aq të buta e harmonike, dhe në një rast tjetër aq të rezikshme, kanosëse. Në këtë duket sikur digjet brenda pareshtur një flakë, e cila e shkrin lëndën jetike të këtij njeriu dhe e ndryshon atë, të papërzier në një figurë... Vala e tij aktoriale nuk ka kufi, pasioni i tij për mishërim është i pakak». ¹⁾

Aleksandër Moisiu me forcën gjeniale të interpretimit, me individualitetin e tij krijues të pakrahasueshëm u dha heronjve që krijoit tiparet e temperamentit të tij, u dha shpirtin e tij, u dha mall e afsh dashurie, përbuzje dhe dëshpërim, forcë dhe melankoli duke iu larguar shablloneve dhe të gjitha këto i dha me një intensitet shprehës të furishëm.

«Me gjenialitetin e tij, me fuqitë e individualitetit të tij krijues, — thekson regjisori Esat Oktrova, — Moisiu u ngrit mbi interpretuesit e tjerë bashkëkohorë për vlerat e reja ideore dhe artistike me të cilat ai skaliti dhe brumosi figurat e tij, ku spikati tingulli aktual, forca përgjithësuese dhe arti i tij realist». ²⁾

Gjithë artin e tij gjenial dhe krijues, Moisiu e vuri pa rezerva në shërbim të idealeve progresive të njerëzimit, të problemeve më të mëdha të kohës duke i shërbuer masave popullore dhe transformimeve revolucionare.

Moisiu kishte një intuitë, shkathësi dhe forcë improvizuese të jashtëzakonshme.

Tregojnë një rast, kur Moisiu kishte harruar të lyente duart me ngjyrë të zezë në rolin e Otellos. Spektatorët e

-
- 1) Julius Bab, «Deutsche Schauspielerporträts aus Berlin und Wien», Berlin 1908.
 - 2) Esat Oktrova, «Aleksandër Moisiu — aktor i madh shqiptar i teatrit botëror». Gazeta «Zëri i popullit», 2 prill 1975.

vunë re këtë detaj dhe filluan të reagojnë e të qeshin. Moisiu sapo dëgjoi reagimin e spektatorëve e kuptoi «difiktin» që i kishte shpëtuar. Erdhi rasti për të dalë një çast nga skena. Ai leu me shpejtësi duart dhe veshi një palë doreza të bardha. I dha rast edhe një herë spektatorëve që të reagonin... Si ishte e mundur që Moisiu të mos e ndreqte «gafën» e bërë? Në këtë moment ai hoqi dorezat tërë elegancë dhe i dolën duart e zeza. Në sallë shpërthyen duartrokitje të stuhishme. Shumica e spektatorëve që e dalluan këtë truk e duartrokitën më shumë. Po kështu, në një rast tjeter, kur po interpretonte në «Lorenco de Medici» Moisiu kishte harruar të vinte kolanën e brilantëve. I prunë kutinë që mbante xhevahiret. Hapi kapakun... për çudit Kutia ishte bosh. Atëherë Moisiu, duke lëvizur duart mbi kuti krijoj me kërcitjen e dhëmbëve një zhurmë krejt të ngjashme, sikur në duart e tij lëviznin xhevahiret. Duartrokitjet e spektatorëve nuk kishin të mbaruar. Truku u realizua në mënyrë të shkëlqyer. Kjo skenë i «kushtoi» Moisiut dy dhëmbë të thyer...

Forca interpretuese e Moisiut u shpreh edhe në zërin e tij. Moisiu zotronte një teknikë të përsosur të të folurit skenik. Ai e shikonte artin e të folurit skenik si një nga elementët thelbësorë të mjeshtrisë së aktorit, art që lidhet me tingëllimin, elasticitetin, volumin e zërit, procesin e frymëmarrjes, saktësinë dhe qartësinë e diksionit. Duke punuar me fjalën artistike, ai bënte që në çdo fjalë të shqiptuar të ndiheshin jo përfytyrime të shkëputura, pojeta e plotë dhe e gjallë dhe si e tillë ajo të rrëmbente, të bindte me forcën e saj, me imazhet, ndjenjën dhe veprimin e saj. Intonacionet dhe larmia e pasur e ngjyrave të zërit të tij, rrroknin tinguj të intensiteteve të ndryshme, që depërtotonin thellë në ndjenjën e spektatorit. Përveç tingullit jashtëzakonisht të ëmbël dhe pasurisë së pamatur të nuancave dhe ngjyrave, Moisiu kishte veçorinë e të folurit depërtues, fjalë e tij tingëllonte e ngrohtë, e ëmbël, e njerëzishme. Zëri i tij i madhëri-shëm përhapej pa mundim në çdo skaj të hapësirës dhe e sundonte plotësisht atë, të dilte përpara për t'u futur në zemër si një këngë përkëdhelëse, si një trishtim i ha-

rruar, si një melodi dashurie, si një fllad i freskët bregdetar.

Aleksandër Moisiu dinte shumë gjuhë, mbi të gjitha gjermanishten dhe italishten. Kuptonte mirë dhe fliste frëngjisht, greqisht, rusisht, anglisht e spanjisht. Gjermanët habiteshin për fjalën e tij të bukur, të ngrohtë dhe tingëlluese saqë nuk ngopeshin duke e dëgjuar vetëm në skenë, po kërkonin që ai të jepte konferanca në salla të ndryshme. Në skena të ndryshme ai recitonte përparrat turmave, në Paris frëngjisht, anglisht në Londër, rusisht në Moskë, italisht në Milano, spanjisht në Meksikë . . .

Për zérin e Moisiut, për koloritin e pasur të tij, kanë shkruar shumë kritikë dhe njohës të shquar të artit. Një nga kundërshtarët e tij pat thënë: «Moisiu nuk është një aktor, po një tenor». Disa ishin dakord me këtë, bile në shumicën e roleve të tij arti i tij të duket më tepër si një art këngëtar se sa i një recituesi. «Moisiu është një aktor-këngëtar, — shkruante kritiku gjerman Klabundi. — Muzika qëndron në brendësinë e tij. Gjuha e tij këndon, shikimet e tij shprehin dhe trupi i tij kumbon».¹⁾ Por, me gjithëse cilësia vokale e zërit të tij ishte mjaft e theksuar, prapë ai gjithmonë ishte një zë i folshëm pa intonacione të lodhshme e monotone, një zë që kurrë nuk të detyronte të dëgjoje tingëllimin e fjalëve dhe të harroje kuptimin e tyre.

«Zëri i Moisiut, — shkruante L. Untermajer, — njeriu e ka gjithnjë në vesh. I butë dhe përkëdhelës. Moisiu, ky belcantist i teatrit diti t'ia sjellë këtë zë skenës gjermane. Në melodinë e tij të mbetur e plot kolorite të errëta e lëkundëse, shpërthenin në raste të volitshme tone akute të një fanfare me një forcë të imprehtë si të rrahuara kamxhiku, duke u tërhequr përsëri në vibracione qetësuese të organos».

«Në zérin e tij, — shkruante Julius Bab, — kemi një këngëzim që luhatet nëpër errësirë, si një melodikë të shtypur e cila bëhet shumë e efektshme në pasion,

1) Cituar sipas Hans Böhm «Moissi, der Mensch und der Künstler», Berlin 1927.

duke shpërthyer me një forcë e një qartësi të hollë e të mprehtë si një majë kame. Ky zë drithërues, që rrjedh drejt nga shpirti, përmban një fuqi e cila nuk mund të tregohet saktë me fjalët «e madhe», apo «e fortë». Jo, ky zë duhet quajtur «intensiv», ai mund të gjëmojë i shurdhëri si një kambanë që hesht dhe përkundrazi mund të shpërthejë i mprehtë, fshikullues si kamxhik. Ky zë është kaq përbindësish i pasur me jetë sepse ka diçka të fshehur, sepse duket sikur fsheh, në shumicën e rasteve, diçka të përbajtur, diçka të rrezikshme, diçka të egër...»¹⁾

«Moisiu, me kantilenën e tij, — shkruan B. Bjornson, — ka hyrë në zemrat tonë, sepse gjuha e tij kumbon si një muzikë e bukur në vuajtje e në gjëzime. Dhe kumbimin e kësaj muzike ne e ruajmë në kujtesën tonë si një akord të mrekullueshëm». ²⁾

Zëri i Moisiut i ngjante një orkestre me të gjitha modulacionet dhe intensitetin, që nga notat më të ulëta e deri te shpërthimet tronditëse. Ai i paiste shqiptimet e zakonshme dhe kuvendimet me dridhje poezie plot imagjinatë dhe të lirë nga retorika. Një zë i kumbueshëm, i ashpër, i mprehtë, një zë tipik shqiptar nga timbri i tij, tonaliteti i tij, melodia dhe shqiptimi. Fjala e tij në çdo gjuhë që të theksohej, kishte diçka tipike shqiptare.

Intonacionet dhe larminë e ngjyrave të zërit në të folurit skenik, Aleksandër Moisiu nuk e përdorte si një stoli të jashtme, po nëpërmjet tyre me një diksion të qartë, nxirrte në pah brendinë dhe kuptimin e thellë të fjalëve që thoshte.

Me hirin elokuent të trupit, me zotësinë e gjallë shndërruese të fytyrës, me magjinë robëruese të zërit, Moisiu bëri që të gjithë personazhet e tij të ndizeshin flakë.

1) Po aty.

2) Po aty.

NË SKENAT E BOTËS

Në goftë se turneu i parë i Moisiut në Moskë e Petërburg, në vitin 1911, ishte vetëm fillimi i suksesit ndërkombetar, vitet që pasuan më vonë shënuan një varg triumfesh të panumërtë që ai korri në skenat e teatrove më të mëdha të botës.

Interpretimi i shkëlqyer i Faustit, i Hamletit, i Jedermanit, i Dubedatit, dhe veçanërisht i Fedias bënë që fama e tij të përhapej si stuhi në vende të ndryshme të botës. Grupi i Moisiut, i përbërë nga artistë të talentuar si: Paul Hartman, Hans Timig, Rozamud Pinsho, Eduard fon Vintershtajn, Helen Timig, Hans Moser, Lili Darvas, Herman Timig, Herald Kreutzberg, Maria Solveg, Johana Tervin, Oto Valburg, Arnold Korf, Erih Shiling etj, filloj turnetë në vende të ndryshme, i ftuar dhe i pritur me përzemërsi të madhe. Kështu, duke filluar nga viti 1911 e deri në fund të jetës së tij, Moisiu nisi shtegtimet plot emocione, duke luajtur me sukses në skenat e qyteteve më të mëdha të botës. Ai luajti me madhështi në amfiteatrot antike të Athinës, në sheshet e mëdha përparrakatedraleve të Salsburgut dhe Milanos, në arenat gjigande të cirqueve të Berlinit, Moskës dhe të Vjenës, në sallat e mëdha të «Gloube Thietër» të Londrës, «Sençeri Thietër» të Nju-Jorkut, në Teatrin Artistik të Moskës etj, duke marrë nga publiku i këtyre vendeve admirimin e pafund dhe kurorën e lavdisë si artist i madh i kohës së tij. Në miliona spektatorë të Berlinit, Parisit, Moskës, Bernës, Budapestit, Çikagos, Bukureshtit, Londrës, Stokholmit, Meksikos, Pragës, Nju-Jorkut, Kairos, Tokios e Stambollit ai la mbresa të pashlyeshme, i brohoritur dhe i përshëndetur me entuziazëm.

<i>Data</i>	<i>V e n d i</i>		<i>Rolet e interpretuaro</i>
Qershorr	1912	Turneu në Paris	Hamlet, Fedia
Maj	1913	» Pragë	Fedia, Fausti
Dhjetor	1913	» Pragë	Hamlet, Fedia
Prill	1914	» Romë, Trieste	Edipi, Hamlet
Nëntor	1921	» Suedi, Rumania	Otello, Hamlet, Osvald
Janar	1922	» Zvicër, Rumania	Fedia, Otello, Hamlet
Janar	1923	» Zvicër	Osvald, Fedia
Shtukurt	1923	» Hollandë	Hamlet, Fedia
Shtukurt	1924	» Budapest	Hamlet, Fedia
Mars	1924	» Bashkimin Sovjetik	Osvald, Fedia, Hamlet
Prill	1925	» Budapest	Dubedat, Osvald
Sintator	1925	» Zvicër, Suedi	Osvald, Konti von Karole
Dhjetor	1926	» Zvicër	» » »
Tetor	1927	» Paris	Fedia, Hamlet
Nëntor	1927	» Nju-Jork	Oberon, Fedia, Jederman
Dhjetor	1928	» Cikago	Fedia, Hamlet
Vitë	1929	» i madh në SHIBA	Hamlet, Fedia, Oberon
Tetor	1929	» në Rumania	Fedia, Dubedat
Maj	1930	» Londër	Hamlet, Fedia
Nëntor	1930	» Egjipt	»

<i>Data</i>	<i>V e n d i</i>	<i>Rolet e interpretuara</i>
Janar	1931	Turneu në Zvicër
Prill	1931	» Argjentina
Dhjetor	1931	» Meksikë
Shtator	1932	» Stokholm
Janar	1933	» Hollandë
Korrik	1933	» Milano
Gusht	1933	» Romë
Nëntor	1933	» Holandë, Çeki
Viti	1934	» Itali
Viti	1935	» Itali
		Idioti, Taso
		Jederman, Dubedat, Fedia
		Antoni, »
		Fausti, Fedia
		Osvald,
		Jederman, Osvald
		» »
		Markiz Poza, Ekdal
		Hamlet, Fedia
		Dubedat, Fedia

Pas turneut të parë në Rusi, shtegtimet e Moisiut në skenat e kryeqyteteve të ndryshme të botës u bënë më të shpeshta. Po japim një grafik të turneve që Moisiu ndërmori gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit të jetës së tij.

Të shkëlqyera ishin sidomos shfaqjet e Moisiut në skenat e Anglisë gjatë turneut të vitit 1930.

Nuk ishte hera e parë që grupi i artistëve gjermanë me Rajnhardin në krye vizitonte Londrën. Ai kishte debutuar në skenën angleze në vitin 1910 dhe pas Luftës të Parë Botërore. Në atë kohë mjegullia e Londrës mbante akoma të gjallë në zemrat dhe mendjet e njerëzve avullin helmues të urrejtjes nga lufta.

Ndërsa në turneun e viteve 30 atmosfera kishte ndryshuar krejt. Ishte koha kur Moisiu po korri te suksese sensacionale, ai u prit me admirim nga publiku anglez.

Organizimi i turneut dhe paraqitja e tij u bë nga personalitetet e artit londinez K. Koçren dhe M. Brovni, Në sallën e «Gloub Thiëtér» në Londër, në Glaskou, Birmingham, etj, Moisiu interperetoj rolet e Fedias dhe Hamletit. Kronikat e shtypit të atëhershëm u bënë jehonë të madhe këtyre shfaqjeve, veçanërisht interpretimit të shkëlqyer, të pakrahasueshëm të Moisiut. Gazeta «Deli Telegraf» botoi një artikull të madh ku ndër të tjera thuhej: «Z. Moisiu, më i famshmi ndër aktorët modern gjermanë, u paraqit me një version gjermanisht të «Kufomës së gjallë» të Tolstoit. Z. Aleksandër Moisi është një nga të paktët aktorë madhështorë që rrallë kemi pasur fatin të shohim ...

Menjëherë ju mësoni, pastaj nuk ju hiqet kurrë nga mendja, se keni qenë në praninë e një inteligjenti syprehtë, zëri i lakuveshëm dhe i sjellshëm i të cilit, ashtu si edhe fytyra e tij shprehëse janë thjesht një mjet përcues. Dhe, gradualisht, ju kuptoni se këto veti kaq të pasforcuara dhe të pakontestueshme formojnë një nga personalitetet më të forta, më interesante dhe më tërheqëse, të cilin ju i jeni dorëzuar në ndonjë teatër». ¹⁾

1) Gazeta «Daily Telegraph», Londër 25.5.1930.

«Zoti A. Moisi, — shkruante «Dhë Tajms» e Londrës, — mund të përvijojë një portret në ato tipare që janë të pakaphme, ndërsa dallon në mënyrë delikate dhe të vërtetë midis elementeve të ndryshme e të shumëllojshme të punës së tij, se ai është në gjendje t'i bashkojë ato në një pikturë të vërtetë mahnitëse». ¹⁾

Në artikullin «Zë mjeshtri» gazeta «Glaskou Ivëning Tajms» shkruante: «Megjithëse versioni «Kufoma e gjallë» e L. Tolstoit është paraqitur në gjermanisht, është një gjë e mrekullueshme të dëgjosh A. Moisiun në këtë shfaqje... Është një zë magjepsës, «i fuqisë dhe i hapësirës», një zë me fleksibilitet të mrekullueshëm dhe i përthyeshëm me një kuptim të madh dhe të gjerë». ²⁾ «Zoti Moisi, — shkruante «Manchester Guardian», — vetë do të luajë një pjesë të një cilësie më të përmbajtur javën tjetër, kur ai do të na japë «Hamletin» e tij. Ndërkaq ai ka mahnitur një publik të tërë». ³⁾

Në atdheun e Shekspirit ishte krejt e natyrshme që publiku të priste me interes të madh «Hamletin», të cilin e kishte parë ta interpretonin shumë artistë të talentuar dhe që me ardhjen e Moisiut i jepej rasti të bënte krahasime. «Për vetë anglezët, — shkruante gazeta «Pester Lloyd» — shfaqja e «Hamletit» ishte, natyrisht, ngjarja më me rëndësi. Me interes dhe sy kritik ata ndiqnin çdo fjalë dhe veprim të Moisiut në këtë rol që ishte për ta aq i afërt sa asnjë tjetër. Dhe kur më vonë u pa në shtypin londinez se kjo, shfaqje e parë e «Hamletit» në Angli në gjuhën gjermane, ishte «më e mira që ishte parë në Angli qysh prej vitesh», atëherë ne besojmë se është vështirë të korrësh një lavdërim më të madh se sa ky». ⁴⁾ «I mirënjosuri Moisi me grupin e tij, — shkruante më tej po kjo gazetë, — ka pasur këtu një sukses të madh. Duartrokitjet kanë qenë nga çdo pikëpamje të shkëlqye-

1) Gazeta «The Times; Londër 27.5.1930

2) » «Glaskow Evening Times», 27.5.1930

3) » «Manchester Guardian», Londër, 29.5.1930

4) » Pester Lloyd», 8.6.1930

shme dhe ai e ka nderuar artin teatral me shfaqjen e dy pjesëve. Shfaqja përsëri e «Kufomës së gjallë» ka qenë realiste dhe bindëse saqë edhe njerëz, si redaktori i këtij reportazhi, që këtë pjesë e ka parë shpeshherë në Moskë në Teatrin Artistik, e ndienin veten të magjepsur rishtazi. Inskenimi u bë simbas traditave të njoitura të Rajnhardt dhe iu përshtat në mënyrë të goditur korrektorit të pjesës. Pjesa më e madhe e skenës mbeti në një gjysmerrësirë dhe lejoi vetëm personazhet që vepronin dhe sendet që dilnin të ndriçuara në ballë të skenës. Mbi gjithçka dhe mbi të tërë spikaste Aleksandër Moisiu. Ai, në rolin e Fedias, ishte më rus se sa mund të ishte ndonjëherë një rus.¹⁾

Triumfal ishte turneu i Moisiut në SHBA në vitin 1927, ku interpretoi rolet e Fedias, të Hamletit dhe të Oberonit.

«Stina e Maks Rajnhardt në Nju-Jork, — shkruante Gilbert Gabriel në gazeten «Dhë Nju-Jork», — arriti kulmin. Moisiu në një rol të famshëm botëror ka çuar peshë emocionet e një milion njerëzve. Në këtë rol, pikërisht përpëra se të vinte në Nju-Jork, Moisiu korri një triumf të madh si Fedia në Paris. Vajza e Tolstoit, Tatjana shkroi: «Ta shikosh atë, është gjëja më e madhe që teatri mund të të ofrojë të shikosh...»²⁾

«Thirrje të forta dhe duartrokitje të pareshtura kumbuan mbrëmë në «Sençeri Thiëtër» dhe prësëri e përsëri perdja finale ngrihej lart, dhe trupa e aktorëve gjermanë përkulej për të përhëndetur, — shkruante një nga gazetat më të mëdha të Nju-Jorkut. — Publiku më i mirë i Nju-Jorkut natën e parë u derdh në teatër. Aleksandër Moisiu, favoriti i Gjermanisë, si Oberon, mjeshtër i shqiptimit, gjeniu që e bënte gjermanishten të tingëllojë më bukur se sa e ka bërë ndonjëherë ndonjë aktor tjetër, mori duartrokitjet nga një publik i ngritur në këmbë i rrëmbyer nga arti i tij i mrekullueshëm. Aleksandër Mo-

1) Gazeta «Pester Lloyd», 8 qershori 1930.

2) Gazeta «The New York», 18 nëntor 1927.

isiu ishte i shkëlqyer»¹⁾). «Fjala përfundimtare në lidhje me Moisiun, — shkruante kritiku amerikan Luis Untermejer, — është se ai është një triumf i virtuozitetit. Bota e ka parë Rajnhardin si krijues të spektaklevë madhështore. Pasi zbuloi mrekullinë e Moisiut, ai e dërgoi atë në ske-nat e botës, duke qenë i bindur se aktorët dhe kritikët do të kenë një simbol të ri dhe të lartë drejt të cilit duhet të synojnë».²⁾ «Midis aktorëve të mëdhenj të Gjermanisë, — shkruante Gerhard Hauptman, — personaliteti i Moisiut është i padiskutueshëm. Më shumë se te kush-do tjetër, talenti i tij është i mbështetur mbi një personalitet të madh. Sikundër toni i Stradivariusit, me të cilin lot mjeshtri i madh Beethoven, shprehja e shpirtit të Moisiut, kur vihet në shërbim të një drame poetike, është një zë malli, dhembjeje, gjëzimi dhe mbi të gjitha, një zë i përfakte»³⁾.

Mbresa të mëdha la arti i Moisiut në publikun francez.

Në letrën që i dërgonte nga Parisi motrës së tij, Elvirës, në qershori 1912, Aleksandri ndër të tjera i shkruante: «Do të qëndroj në Paris deri më 6 korrik, ndoshta dhe më vonë sepse punët shkojnë mirë dhe suksesi në Paris është i madh, dhe në qdo rast më tepër se sa unë e prisja».

«Moisiu me interpretimin e Hamletit, — shkruante Antonio Andre, regjisori i shquar francez, — e bëri për vete spektatorin francez. Ai e luante të gjithë rolin me sinqeritet, thjeshtësi dhe natyrshmëri, pa asnjë teatralitet... Moisiu e krijojti Hamletin si njeri të gjallë. Çast kulminant ai arrinte në monologun e famshëm «Të rrosh a të mos rrosh», të cilin e jepte me intonacione shumë të pasura».

1) Gazeta «New York Evening Journal», 28.XI.1927.

2) Lonis Untermeyer «A poet Describes Mid. Europe's Greatest Actor», (Një poet përkruan aktorin më të madh të Evropës së Mesme»).

3) Cituar sipas H. Böhm «Moissi, der Mensch und der Künstler» Berlin, 1927.

«Përshëndes Aleksandër Moisiun, — shkruante Lui-xhi Pirandelo, — të cilil i jam mirënjoës pér jetë, si njërit nga interpretuesit më të përsosur të figurave të mia... Unë shpresoj se do të vini një herë këtu te ne, në Itali, pér të shfaqur pér ne «Henrikun» tuaj dhe gjithë ato figurat e shumta që ka krijuar gjenia juaj».¹⁾ Në turneun e Italisë, Moisiu shkoi me një repertor të gjerë dhe njëkohësisht do të përgatiste pjesën e re, «Savanarola» të R. Alesit, që bënte aluzion kundër fasizmit dhe klerikalizmit që kishin krijuar një atmosferë mbytëse në Italinë e viteve 30,

Vitet e fundit të jetës së tij A. Moisiu i kaloi në turnetë e Italisë, duke mahnitur publikun e qyteteve më të mëdha të këtij vendi. Në tretot e Romës, të Milanos, të Triestes etj., ai emocioni publikun me pjesët teatrale «Hamleti», «Kufoma e gjallë» «Jederman» etj.

Gazeta «Najes Viner Zhurnal» në artikullin me titull «Shfaqja e parë e Moisiut në «Legjenda e secilit» sukses sensacional» — shkruante: «Kjo natë e bukur fantastike e 11 korrikut, ku natyra mori mbi vete rolin e një drejtuesi të dekorit, dhe me këtë dha me sukses të plotë e të pabesueshmë një horizont rrethues, të cilin vetëm një piktor klasik italian është në gjendje ta bëjë, do të mbetet pér një kohë të gjatë një datë e denjë pér t'u kujtuar. Poezia «Cilitdo» e Hofmanstalit e pushtoi me sukses triumfal publikun italian... Debutimi i Moisiut ishte i bujshëm dhe tronditi publikun. Shpërthimi i duartrokitjeve gjëmoi dhe nga fundi arriti në një demonstratë... Moisiu e pushtoi menjëherë publikun dhe ajo që ka rëndësi është fakti që nuk tërroqi vetëm publikun, por edhe bashkëpunëtorët e tij. Shfaqja u bë një ngjarje e veçantë pér të parë Moisiun në kulmin e karrierës së tij».²⁾

Gazeta «Noje Fraj Prese» në një artikull me titull

1) Cituar sipas H. Bohm «Moissi, der Mensch und der Künstler» Berlin, 1927.

2) Gazeta «Neue Wiener Journal», 12.7.1933.

«Protagonisti: Aleksandër Moisiu, «Legjenda e secilit» (Jederman) në Milano» — shkruante:

«Në një natë vere të pakrahasueshme për nga bukuria, u dha shfaqja e parë interesante «Legjenda e secilit» (Jederman). Filloi para orës dhjetë të mbrëmjes. Pesë minuta para fillimit flitej se këtu do të tregonte shumanshmërinë e tij një aktor gjerman dhe se do të guxonë të bënte një eksperiment të vështirë, të luante befas italisht pas një aktiviteti tridhjetëvjeçar në gjuhën gjermane. Pesë minuta pas fillimit të shfaqjes së pritur me tension të madh, pamja ndryshoi thëllësisht... Aleksandër Moisiu erdhi dhe fitoi. Publiku italian, i entuziazmuar nga bukuria e gjuhës së tij, e brohoriti në skenë të hapët dhe ai u bë me të vërtetë, siç e kishin shpallur në pllakatat, një yll...

...Në mbarim duartrokitjet u shndërruan në ovacione gjëmuese; me kohë të matur ato u zgjatën mbi një çerek ore. Ishte një pamje prekëse: Moisiu nën dritën e reflektorëve, shumë i lodhur, i zbetë, i lumtur, me një buzëqeshje të trishtuar dhe me sy që shkëlqenin nga lotët... Ja tek qëndronte një aktor i madh dhe i famshëm i cili në kulmin e karrierës së tij filloi përsëri si një njëzetvjeçar, një karrierë të re... Gjatë shfaqjes Moisiu e ka trondit tur publikun me paraqitjen e vuajtjeve njerëzore. Pas shfaqjes populli e futi në zemër njeriun që vuante.»¹⁾.

Për fuqinë e pakrahasueshme emocionale të Moisiut, që bënte të rrihnin zemrat e spektatorëve, tregon edhe një nga bashkatdhetarët tanë, Dr. Vasfi Sâmimi, i cili pati rastin ta shikonte aktorin bashkatdhetar në skenat e Berlinit. «Jemi në një tempull arti të gjerë dhe gjysmë të errësuar, — tregon ai, — pikërisht në «Berliner Teater», në mbrëmjen e 29 marsit 1932. Aleksandër Moisiu do të interpretonte pjesën e parë të Faustit... Dëgjuesit, të heshtur dhe me respekt të thellë shpresojnë, dhe që të gjithë kërkojnë të ndiejnë zërat më të hollë, dridhjet më

1) Gazeta «Neue Freie Presse», 13.7.1933.

të ndjeshme dhe fryshtuarjet e pafuqishme që dalin nga altari pa humbur asnjë grimcë tingulli... Një zë dhe vetëm një zë sundon. Ky zë ulerin, shkumëzon, rënkon dhe më në fund, humbet... si valët që fshihen njëra pas tjetrës, si zëra magjikë, si lule të vyshkura dhe si flatra të thyera... Është zëri i artistit, zëri i Aleksandër Moisiut.

...Perdet e kuqe kanë rënë si krahë të këputur. Për disa çaste gjendemi të mahnitur. Një heshtje e thellë... Pastaj... përnjëherësh shkëputet një shtrëngatë e rrëmbyeshme, një stuhi e vrullshme, një katarakt i fuqishëm. Duartrokutje të pandërpresa!

Kjo botë, që pak më përpara rrinte si një tufë e hipnotizuar apo si një turmë e skllavëuar, tanë duket sikur ka vodosur të bëjë një kryengritje gëzimi dhe bërtasin, ziejnë me uturimë të pandërpresa: Moisi! Moisi! Moisi!

Për një çast përpara perdes së kuqe një mrekulli: del një njeri me një shtat të vogël, fytyrë të thjeshtë, me sy të shkëlqyer: ulet, përkulet dhe shfaq mirënjojhe përpara këtij breshëri duartrokutjesh. Flatrat e perdes së kuqe bien e ngrihen si krahët e një shkabe mitologjike, hapen e myllen si flaka e një zjarri të shenjtë në një tempull arti, ku besimtarët nuk rrëmbehen prej dogmave qiellore, po përmbysen nga sovraniteti i bukurisë së artit. Përpara skenës tanë gjendet një turmë e dehur prej bukurisë, nuk di çfarë bën, po vetëm ulerin dhe gjëmon. Moisiu del vazhdimesht, përulet, nënqesh dhe fshihet prapë përpara stuhisë së duartrokutjeve. Një gjë e çuditshme, kush është sunduesi dhe i sunduari? A është vallë mjeshtri artist apo turma adhuruese? Në këtë çast dhe në këtë vend është trazuar kufiri i sovranit me të të nënshtruarve».

Në të gjitha skenat e vendeve të ndryshme Moisiu u ngrit fuqishëm në botën e ndjenjave, të mendimeve dhe të vetëdijes së njerëzve, duke e bërë veten të pavdekshëm.

«Moisiu, — shkruante F. Molnar, — ishte një zog shtegtar, i cili me temperamentin e nxehëtë të këngëta-

rëve, me poezinë e ëmbël të kujdeshshme të Jugut, shkon drejt Veriut, gjithmonë në shtegtim, gjithmonë në fluturim, gjithmonë në rrugë. Kështu ai, me artin e tij të bukur lidh pareshtur e papushim Veriun me Jugun, dhe anasjelltas Jugun me Veriun... Zogu shtegtar, më i dashuri e më bujari i historisë së teatrit në ditët tona»¹⁾.

Moisiu vlerat artistike të popujve të ndryshëm i kthente në pasuri të vyera pér të gjithë botën. Me gjuhën e ndjenjës, të zemrës, të artit ai komunikoi me të gjithë popujt e botës. Moisiu u fliste popujve me gjuhën e fuqishme të krijuesve të vlerave të tyre shpirtërore. Gjermanëve me gjuhën e Gëtes dhe të Shilerit, anglezëve me gjuhën e Shekspirit dhe të B. Shout, rusëve me gjuhën e Tolstoit dhe të Gorkit, francezëve me gjuhën e Molierit dhe të Bomarshesë. Universaliteti i personazheve të këtyre mjeshtreve të dramaturgjisë botërore u mëshirua në një mënyrë të përsosur edhe nga personaliteti i Moisiut. Me artin e tij realist ai interprettoi me madhështi personazhet e epokave dhe të kombeve të ndryshëm. Bashkëkohësit panë në rolet e tij aspirat, ndjenjat dhe luftën e inteligjencës e të rinisë përparrimitare bashkëkohore.

Kështu plot ngadhnjim, Aleksandër Moisiu shtegtoi në vise të ndryshme të botës duke shpërndarë në zemrat dhe në ndjenjat e njerëzve gjëzimet më të bucura, ndjenjat dhe aspiratat më të pastra, dëshirat e zjarrta pér përparrimin e shoqërisë njerëzore. Dhe kudo ai e valviti flamurin e artit të tij si një simbol që lartëson aftësinë dhe vitalitetin e kombit shqiptar midis popujve dhe kontinenteve të botës.

1) Citar sipas Hans Böhm «Moissi, der Mensch und der Künstler», Berlin 1927.

MOISIU DHE ARTI KINEMATOĞRAFIK

Kinematografia, ky lloj i ri arti, me mundësi të pakufizuar në pasqyrimin e jetës, qe një nga ngjarjet më sensacionale dhe me një të ardhshme të shkëlqyer në shekullin tonë. Arti i kinematografisë, me gjithë mungesat e mëdha teknike që kishte në fillim, ishte lloji i artit më premtues. Ai ngjalli diskutime dhe shpresat të mëdha. Ai grumbulloi rreth vetes shumë firma, grupe njerëzish, artistësh, financierësh që kërkonin të lidhnin me të interesat e tyre materiale dhe shpirtërore. Kështu, që në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit tonë në shumë vende të Evropës dhe Amerikës u zgjerua rrjeti i kinoteatrove, pronarët e të cilëve synonin të kënaqnin kërkuesat në rritje të spektatorëve duke siguruar fitime të mëdha.

Synimet për t'i dhënë kinematografisë karakterin e një arti u dukën në përpjekjet për ekranimin e pjesëve teatrale. Me gjithë karakterin primitiv, këta filma lejonin pasqyrimin në ekran të lojës së mrekullueshme të aktorëve të teatrit si: Sara Bernar dhe Rezhan në Francë, Duze dhe Xakoni në Itali, Çarli Çaplin në Angli, etj. Në SHBA trustet dhe industria e reklamës, krijuan sistemin e «yjeve» të kinematografisë, që gjeti zhvillim në studiot e Hollivudit dhe që u bë një nga burimet e eksportit kombëtar dhe të fitimeve përralllore të monopoleve, i cili vazhdon edhe sot me tërbim.

Në vitet 20 në historinë e kinematografisë fillon një periudhë e re. Nisen të duken frytet e para të përpjekjeve dhe kërkimeve të mjeteve shprehëse, të cilat e transformuan kinemanë nga atraksione tregtare dhe regjistrim mekanik i shfaqjeve teatrale në një art të vërtetë.

Në Gjermani, e cila jetonte kohërat e vështira të kri-zës, inflacionit dhe të pasigurisë, mori një përhapje të gjerë ekspresionizmi, veçori e të cilat ishte shkëputja nga realiteti, kthimi në botën fantastike irrationale. Karakteristikë e këtyre filmave ishte pasqyrimi i anëve negative të njerëzve vampirë, të sëmurë shpirtërisht, të vrasësve, etj. Krahas ekspresionizmit fillooi të duket rryma e të ashtuquajturës «Kamershpile», që i kishte vënë vetes si detyrë pasqyrimin me vërtetësi të jetës së vështirë të njerëzve të thjeshtë në Gjermaninë e pasluftës, të realitetit të ashpër shoqëror të kohës. Filmat më në zë të kësaj rryme ishin «Njeriu i fundit» i F. Murnau dhe Rrugica e mjerueshme» e G. Papst.

Me shumë simpati u priten në publik filmat me problematikë të mprehtë sociale të Çarli Çaplinit, i cili satirizonte propagandën e luftës, fenë, klasat shfrytëzuese etj.

Në historinë e kinematografisë shënoi epokë të re filmi me zë. Grupet monopoliste, veçanërisht ato amerikane, e shfrytëzuan këtë mundësi pér të larguar vëmen-djen e masave popullore nga vështirësitë ekonomike dhe problemet e luftës klasore. Në ekrane filluan të duken paradat muzikore, që e mahnitnin publikun me gjëresinë e ekranizimit dhe pasurinë e luksit dhe të dekorit, filmat që paraqisin gangsterizmin në format më të shëmtuara dhe banale.

Zhvillimi i vrullshëm i artit kinematografik ngjalli diskutime dhe debate lidhur me çështjen e raportit të tij me artet e tjera, kryesisht me teatrin. Pati njerëz që u ngutën të deklaronin se ekrani me mundësitë e pakufizuara do ta ekripsonte skenën. Po koha provoi se skena dhe ekrani, teatri dhe kinematografia, do të ecnin dhe zhvilloheshin pranë njëri-tjetrit, sipas ligjeve të tyre spe-cifike, duke plotësuar njëri-tjetrin.

Arti kinematografik, që po merrte përpjesëtime zhvi-limi të mahnitshme, nuk mund të mos tërhiqtë vëmen-djen e Moisiut.

Në një artikull të shkruar prej tij në revistën «Ilus-trite Film-Cajtung» Aleksandër Moisiu, duke shprehur

idetë e tij mbi artin kinematografik, mbi rolin dhe të ardhshmen e tij, shkruante ndër të tjera: «Çështja nëse filmi me zë ka për të pasur një të ardhshme, dhe çfarë të ardhshme, mua më duket se kjo çështje tashmë është kapërcyer. Nuk ka dyshim se filmi me zë është sot shiriti i fotografisë së sotme dhe të ardhshme... Kush e pat parë një herë Çaplinin, e di mirë se edhe në gjuhën me-mec mund t'u flitej edhe të varfërve, edhe spektatorëve të «pashkolluar» të karrigeve të lira. Shansi ishte ky: mundësia e lidhjes midis artistit dhe masës së njerëzve, veçse filmi memec nuk mund të shfrytëzohej me përjashtim të rasteve të rralla.

Po a ka për të mundur filmi me zë të apelojë, jo vetëm nevojat sensacionale të llojeve të ndryshme të histrikëve dhe sentimentalisteve, të atyre plot ankth e të pakënaqur, të qejflinjve dhe të atyre plot humor, a ka për t'u folur filmi njerëzve në mënyrë njerëzore?... Filmi, — vazhdon Moisiu, — jo vetëm nuk mund t'u zëvendësojë teatrin dhe koncertin miliona njerëzve, siç dëgjohet shpeshherë të thuhet, po duhet t'u ofrojë atyre mundësinë e angazhimit shpirtëror, të thellimit, të lartësimit.

... Ajo që fillon tanë është lufta për nivelin e filmit folës. Nga drejtimi që do të marrë ai në fillim, varet në një masë të madhe ndikimi kulturor dhe zhvillimi i gjenaratës sonë.¹⁾

Këto ishin disa nga mendimet dhe shqetësimet e Moisiut mbi artin kinematografik, mbi perspektivat dhe rolin e tij edukativo-shoqëror.

Moisiu shfaqi interes për artin kinematografik që në dhjetëvjeçarin e parë të shekullit tonë. Atë e ftuan të interpretonte në filma të ndryshëm. Moisiu gjononte një simpati dhe adhurim të madh në qarqet kinematografike. Fama e tij si artist i madh i skenës, nxiti mjaft drejtues të shoqërive kinematografike ta ftonin për të luajtur në filma.

Ernest Lubitsch, në atë kohë drejtor artistik i shoqërisë «Paramount», që pati krijuar një plejadë artistësh

1) Gazeta «Illustrierte Film-Zeitung», Berlin, 25 korrik 1929.

të shquar, ka shkruar për Moisiun këto fjalë: «Përpara pesëmbëdhjetë vjetëve, Aleksandër Moisiu ishte pothuaj kaq i famshëm sa edhe sot. E mbaj mend Moisiun një natë vere, përpara se të hynte në skenën e teatrit, i rrethuar me respekt nga intelektualët dhe i admiruar nga të gjithë. I vaja pranë Moisiut, e përqafova duke i thënë: «Zoti Moisi, më lejoni t'ju përqafoj, që njerëzit të mendojnë se edhe unë jam diçka!». Drejtori i shoqërisë «Paramount» i etur përfamë dhe para, shpresonte që me yllin e artit skenik të ndriçonte ekranet e filmave të shoqërisë së tij.

Moisiu e provoi artin e kinemasë. Ai luajti në më shumë se dhjetë filma. Filmi i parë ishte «Le maschre» më 1910 dhe pastaj me radhë: «Fati i zi» (1912), «Sytë e Ole Brandis» (1914), «Dama Pik» (1918), «Unaza e tri dëshirave» (1918), «Fati i trashëguar» (1919), «Biri i tij i vetëm» (1919), «Martesa e Figaros» (1920), «Ndërmjet qiellit dhe tokës» (1921), «Lozha e mbretit» (1929), «Mbretëreshat e klubit të natës» (1931) dhe i fundit «Lorenco de Mediçi» (1935). Tre filmat e fundit u interpretuan me zë. Muajt e fundit të jetës së tij ai u përgatit të interpretonte në filmin «Savonarola», po nuk arriti ta kryente për arsyen të lodhjes fizike dhe shëndetit të tij të dobët. Të gjithë filmat artistikë ku Moisiu interpretoi me kollegë të shquar si: Kamila Horn, Sara Bernar, Eleonora Duze etj., kanë vlerë të madhe artistike.

Filmi i fundit i Moisiut, «Lorenco de Mediçi» të cilin e kemi parë edhe në ekranet e kinemave tonë, ishte dëshmi e dhundive artistike të talentit të Aleksandër Moisiut. Filmi demaskonte sunduesit e Italisë fashiste, që trashëgonin vetitë më të shëmtuara shpirtërore të dukëve të Firencës.

Megjithëse u angazhua me interpretime filmash, Aleksandër Moisiu nuk u apasionua pas tyre. Ëndërrimet, virtuziteti dhe pasionet krijuese të tij ishin të lidhura pazgjidhshmërisht me teatrin. Teatri ishte fusha e vërtetë e veprimtarisë së tij krijuese artistike. Ai i qëndroi besnik asaj, në skenë korri triumfe të panumërtë, i parë dhe i duartrokitur nga miliona njerëz.

MOISIU SI SHKRIMTAR

Në vitet 20 dhe 30 të shekullit tonë, Moisiu kishte arritur kulmet më të larta në artin e interpretimit ske-nik. Fama e tij ishte përhapur në të gjithë Evropën dhe kishte vërvshuar nga Berlini në Çikago, nga Parisi në Rio-de-Zhanejro, nga Moska në Meksiko etj. Moisiu arriti çdo triumf që mund të arrinte njeriu në intepremin e dramave dhe tani dëshironte të shkruante vetë drama.

Horizonti i tij i gjerë letrar, intelekti i shquar, gjallëria e tij mendore, aftësia e tij e çuditshme për të rrokur çdo imtësi dhe nuancë në karakteret e personazheve, mendimet e shumta të ngjeshura me figura e shtynë atë për të provuar veten si shkrimtar.

Moisiu na ka lënë një tok artikuj, novela të vogla, skica letrare dhe memuare. Ato janë mjaf têrheqëse dhe shquhen për ndjeshmëri dhe bukuri mendimesh.

Dikur Moisiu pat menduar të shkruante një monografi autobiografike mbi rrugën e jetës së tij, po nga kjo pat hequr dorë si një punë që mund ta kryente më vonë.

Në gjininë e dramaturgjisë, Aleksandër Moisiu bëri një përpjekje të apasionuar për të shkruar një dramë mbi figurën tiranike të N. Bonapartit. Kjo ishte orvajtja e parë dhe e fundit e tij në këtë gjini.

Ideja për të shkruar një dramë mbi fundin e Bonapartit nuk ishte një gjë e rastit. Një frysëzim i tillë i erdhi nga leximi i kujtimeve të Shën Helenës, ku diktatori i madh kaloi vitet e fundit të jetës së tij. Moisiu mendonte që me anën e kësaj drame, mbi fundin e pa-

lavdishëm të Napoleon Bonapartit, të shtronte probleme sociale që preokuponin njerëzimin. Sepse në disa shtete po dukeshin fenomene të tilla në procesin e zhvillimit të jetës politike e shoqërore që çonin në rivendosjen e diktaturave fashiste.

Mbi personalitetin e Bonapartit, mbi figurën e tij mjaft komplekse janë shkruar një mori e madhe veprash historiko-letrare. Personaliteti i tij si strateg ushtarak dhe reformator, si politikan dhe diplomat, despot dhe lejislator dhe së fundi si njeri, ka qenë dhe vazhdon të jetë edhe sot e kësaj dite objekt i studimeve me karakter të ndryshëm.

Moisiu mendoi gjatë për këtë figurë historike, u interesua për grumbullimin e literaturës së nevojshme, lexoi mjaft libra e monografi, duke krijuar gjithnjë e më të gjallë në fantazinë e tij shembelltyrën e perandorit të rënë nga froni, skëterrën e Shën Helenës në të cilën shndriste akoma, po zbetë, lavdia e dikurshme, përmbyrsja dhe vdekja e palavdishme e sovranit të Evropës.

Natalia Lunaçarskaja kujton një nga bisedat e zhvilluara midis Anatoli Lunaçarskit dhe Moisiut më 1928, në Berlin, kur Moisiu ishte mbërthyér nga pasioni për krijimin, e dramës së tij. Pyetjes së Lunaçarskit drejtuar Moisiut nëse shkruan ndonjë gjë për teatrin, aktori iu përgjigj:

«— Po, punoj për dramën «Napoleoni» studioj materiale dhe dokumente, ato janë aq të shumta sa edhe ujët e detit. Mendoj se nuk o dtë ketë figurë tjetër historike, për të cilën të jenë shkruar aq shumë vepra dhe aq memuare. Sa më shumë ta njohësh atë, aq më tepër formon bindjen se është një shfaqje e vetme dhe e pa-përsëritshme.

— Ju do të dëshironit ta vinit këtë person në skenë?

— Oh! Po, patjetër. Unë do ta luaja korsikanasin, njeriun e gjakut të jugut, me një temperament të shfrenuar. Endërroj të jetoj disa kohë në Korsikë, të vërej njerëzit, zakonet. Po, në mes të tjerash, e përfytyroj aq të qartë Korsikën, saqë shpesh më duket se kam qenë

atje më se një herë. Korsika, korsikanasi, ja ky është deti Mesdhe, i kaltër dhe i mrekullueshmë.

— Po, unë e përfytyroj Moisiun-Napoleon. Kjo mund të jetë têrheqëse, po për këtë rol ju duhet të ndryshoni parimet tuaja. Duhet të luani me paruke dhe makiazhe, sepse duhet të krijohet maska e Napoleonit...

— Jo, jo, ju garantoj se e keni gabim. Nuk do të bëj kështu, — dhe Moisiu i hodhi prapa flokët e tij të butë kaçurrelë dhe i ngjeshi. Para nesh, papritur, qëndronte gjenerali i ri, Bonaparti, sikur kishte dalë portreti i Davidit! Moisiu qeshi me atë buzëqeshjen e tij të çelur dhe të ëmbël, pastaj i ngjeshi edhe më tepër flokët në ballë dhe la të dukej një tufë e vogël flokësh, buzët iu mblo-dhën në një buzëqeshje të hollë dhe zyrtare, dorën e vari në xhaketën e mbërthyer.

— Napoleoni! Imperatori! — thashë unë. — Juve me të vërtetë nuk ju duhet makiazhi! Po kostumet?

Moisiu buzëqeshi.

— Unë do të detyrohem të vesh xhaketën tradicionale bojë hiri dhe kapelen trikëndëshe. Po nuk duhet që vëmendja e spektatorit të fiksohet në këto. Kryesorja është njeriu!»¹⁾

Kështu, pra, Moisiu e filloi punën plot pasion. Lexonte, shkruante, shkruante gjatë udhëtimeve të tij, në vagonat e trenave, në dhomat e hoteleve, shkruante natë e ditë, i lodhur, por entuziazzt.

Tervini kujton:

«Kur kishte kryer një skenë, Aleksandri ma sillte mua dhe ma lexonte. Në qoftë se unë ia miratoja, ai gëzohej si një fëmijë i vogël. Për çdo përparim të veprës ai mallëngjehej dhe gëzohej si fëmijë... meqë këtë radhë ai nuk dilte në skenë vetëm për të luajtur, po tanimë mundte edhe të krijonte. Ai kishte provuar suksese të panumërtë në skenat e teatrove dhe i kishte shijuar deri në fund. Tani, si fillestar në një fushë të re, atij i

1) N. Lunaçarskaja — Rozenjel. Cituar sipas revistës «Nëntori», Nr. 7, 1965.

duhej të luftonte dhe një herë me gjithë forcën e personalitetit të vet, duke provuar trazimet e pasigurisë dhe të dyshimit edhe në këtë fushë».¹⁾

Moisiu e vizatoi Bonapartin në vitet e fundit të jetës së tij, si i burgosur në Shën Helenë. Në dramë, rrëth personazhit kryesor veprojnë figura të tjera historike si: mareshali Berton dhe gjenerali Montolon me gratë e tyre, konti Las Kazes, mjeku Antomarki, prifti Vitali, guvernatori anglez i ishullit Shën Helena, Hudson Llove, etj.. Në dramë veprojnë edhe personazhe të tjerë, një gazetar, ushtarë, popull, sklevër dhe fëmijë.

Sapo e përfundoi së shkruari dramën, Moisiu ua dha për ta lexuar disa miqve të afërm si: Gerhard Hauptmanit, Feliks Holenderit, Maks Rajnhardit, Riçard Ber-Hofmanit, të cilët i thanë përshtypjet dhe fjalët më të mira. Moisiu u nxit dhe u inkurajua mjaft nga fjalët e mira të miqve, të cilët me gjithë dobësitë dhe impulset e përzemërtë miqësore që kishin për njëri-tjetrin, në këtë rast gjykuant objektivisht. «Asnjërit nuk i shkonte ndër mend, — kujton Tervini, — që Aleksandri të arrinte si shkrimitar efektin që ushtronte si aktor... Mua nuk ma thoshte zemra që ta ndaloja në entuziazmin e tij prej një djaloshi. Por ai, natyrisht, me muaj të tërë dyshonte në vetvete. Që ai do të ngrihej dhe do të kapërcente çdo diletantizëm nga pikëpamja letrare, këtë do ta arrinte me gjenialitetin e tij të natyrshëm për art, dhe për këtë nuk kisha asnë dyshim. Unë kisha frikë vetëm se vepra e tij dramatike dhe epike do të mbetej prapa forcës dhe shkëlqimit të tij si aktor».²⁾.

Moisiu e trajtoi materialin dramatik me një kolorit të pasur. Akti i parë fillon me arritjen e të «burgosurit të madh» në Shën Helena, pastaj tregohet përcëmimi me të cilin e rrëthuan sunduesit anglezë të ishullit dhejeta e tij plot vuajtje. Skenat që pasojnë, në përgjithësi, janë të imagjinguara lirisht nga autor, i cili nuk i vë detyrë

1) J. Terwin. Kujtime. Theatersammlung. Vjenë.

2) Po aty.

vetes tē japë një pamje historike tē vërtetë tē viteve tē fundit tē Napolonit.

Epilogu i perandorit është i trishtueshëm dhe fatal. I mbyllur në një stallë tē vjetër lopësh, ku rreth e rrotull vërtiten minj, zotëruesi i dikurshëm i botës, perandori i rrëzuar nga froni, pret në shtratin e tij vdekjen e palavdishme. Atë e rrethon një karikaturë tallëse e një «oborri» dhe ngacmimet ironike e poshtëruese tē guvernantorit anglez. Mbi muret e zbrazëta tē burgut, fantazia e tij projekton ironinë e fatit, figurat e së kaluarës së shkëlqyer dhe ëndrrat e kohës së ardhshme që ngadalë vijnë duke u zbehur, projekton vizitorë fantastikë që vijnë nga viset e largëta, tē bindur se do ta gjejnë aty, që veprojnë mbi tē si oshëtimat e zërave që grinden në shpirtin e tij.

Në dramën «I burgosuri», Moisiu nuk synon tē idealizojë këtë personalitet tē dëgjuar dhe as ta paraqesë në pozën e Prometeut tē lidhur. Me kontrastin e fuqishëm që krijohet në tē midis figurës së njeriut që i diktonte më parë botës vullnetin e tij, tē despotit tē dikurshëm, dhe «të burgosurit» tē mundur, tē internuar në një ishull tē shkretët në fund tē botës, Moisiu u bënte thirrje njerëzve që tē studionin përvojën historike, tē nxirrin mësimet e duhura prej saj. Pér Moisiun, Napoleoni simbolizon përbysjen e tiranëve, shembjen e froneve dhe fatin që do tē kenë tē gjithë sundimtarët e pashpirtë, sado tē mëdhenj dhe tē fuqishëm tē jetë.

Le tē japim disa fragmente nga dorëshkrimi i kësaj drame:

(Bisedë nga akti i parë, midis guvernatorit tē ishullit, Hudson Llove, një koloneli e një kapiteni, që është caktuar tē ruajë Bonapartin.)

Guvernatori — *Sipas mendjes suaj, ai ka qenë një tiran i tmerrshëm?*

Kapiteni — *Jo gjithmonë sër.*

Guvernatori — (Qesh me ironi) *Atëherë paska qenë heroi i lirisë. (Kolonelit.) Kolonel, ju a keni shërbyer në Santo-Domingo?*

Koloneli — Po, në brigadën Lesler.

Guvernatori — Ç'farë bëri ky heroi në ekspeditën e të 25 mijëve?

Koloneli — Atë poshtërsi e dinë të gjithë.

Guvernatori — Kapiteni ynë me siguri nuk e di.

Kapiteni — Negri Tusen, një nxënës i Uashingtonit, njeri me aftësi dhe karakter, zhduku skllavërinë dhe shpalli Republikën e Haitit.

Guvernatori — Pastaj ç'ngjau?

Koloneli — Napoleon me ushtrinë e vet e zuri Tussenin rob, e çoi në Francë dhe atje e vrau.

Guvernatori — E çfarë bëri pastaj në Haiti ky hero i lirisë?

Koloneli — E mbyti lirinë me gjak dhe vendosi prapë skllavërinë më të egër se të parën.

Në një fragment bisede midis Las Kazes dhe Napoleonit mbi artistin e famshëm Talma të teatrit «Komedi Franzeze», të cilin perandori e adhuronte për forcën e deklamacionit, spikat ironia e fatit të perandorit.

Las Kazes — Fliste në mënyrë të shkëlqyer... Por edhe madhëria e juaj fliste në mënyrë jo më pak të shkëlqyer. Talma i fliste publikut në teatër, kurse madhëria e juaj i fliste gjithë botës.

Napoleoni — Po sot? Talma ende flet nga froni i tij, që gjendet në skenën e mrekullueshme të «Komedi Franzeze» dhe publiku e dëgjon. Kurse froni im tanë është kjo stallë lopësh. (Ngre kokën.) «Rroftë Talma!»

Perandoria e Napoleonit, ndonëse në dukje e madhe, e fuqishme dhe pompoze, në fakt qëndronte në themel krejt të dobëta. Ajo ishte mbërthyer nga kontradikta të fuqishme antagonistë midis pushtetit despotik e skllavëruesh e Napoleonit dhe popujve të vendeve të shtypur prej tij. Luftërat e Napoleonit ishin grabitqare. Ai rrënoi vendet e pushtuara, skllavëroi popujt, bëri luftëra dhe beteja të panumërtë për t'i siguruar Francës dhe borgjezisë së re franceze sundimin ushtararak, politik, ekonomik mbi popujt dhe vendet e tjera të Evropës.

Duke vlerësuar dhe karakterizuar Bonapartin dhe luftërat e tij Lenini thoshte: «Luftërat e Revolucionit të madh Francez filluan si luftëra kombëtare dhe ishin të tilla. Këto luftëra ishin revolucionare: mbrojtja e Revolucionit të madh kundër koalicionit të monarkive kundër-revolucionare. Dhe kur Napoleoni krijoi Perandorinë Franceze, duke skllavëruar një varg të tërë shtetesh të mëdha, me vitalitetet dhe të formuara prej kohësh të Evropës, atëherë luftërat kombëtare franceze u shndërruan në luftëra imperialiste, të cilat lindën nga ana tjetër luftërat nacionalçirimitare kundër imperializmit të Napoleonit». ¹⁾

Ky kriter marksist vlerësues i figurës dhe veprës së Napoleonit, ishte udhërrëfyes edhe për Moisiun në vlerësimin dhe analizën që i bën në dramën e tij Bonapartit.

Moisiu kurdoherë aspironte një regjim të vërtetë demokratik, një regjim të popullit. Duke sulmuar tiranët dhe monarkët, ai shfaqte simpatinë për Revolucionin e Tetorit dhe veprën e tij transformuese revolucionare. Fundi fatal i monarkëve stigmatizohet në dramë nëpërmjet antagonizmit midis Napoleonit dhe personazhit me tendencë revolucionare.

Napoleoni — *Nga vini ju, milord?*

Gazetari — *Nuk jam lord, sër...*

Napoleoni — *Më thoni të drejtën, a jeni i kënaqur nga unë? (Gazetari hesht). E njihni mirë rrugën që unë kam përshkuar?*

Gazetari — *Unë ju kam ndjekur në të gjithë karriérën tuaj, sër, në fillim me shpresë dhe besim.*

Napoleoni — *Kjo më gëzon. Po pastaj?*

Gazetari — *Unë pashë se si ju po ngriheshit, po ngriheshit...*

Napoleoni — *Vazhdoni!*

Gazetari — *Dhe si ju filluat të mbretëroni.*

1) V. I. Lenin, vep. Vëll. 22, f. 376.

Napoleoni — Ju erdhi keq për rrëzimin tim?
Gazetari — (Shkurt). Jo, sër.

Napoleoni — Jo!? Pse?

Gazetari — Se unë gjithmonë e dëshiroj rrëzimin e perandorëve.

Napoleoni — Flisni më qartë, shpjegohuni!

Gazetari — (Me vendosmëri). Sër, ju revolucionin...
Napoleoni — Unë jam i bir i revolucionit.

Gazetari — (Tund kokën dhe thotë me zë të lartë.)
E shkreta nënë!

Napoleoni — Cila nënë?

Gazetari — Nëna juaj, revolucioni... Se ju qetë një
bir shumë i keq, që e vratë nënën tuaj...

Napoleoni — A e dini se unë i shkatërrova fronet
e tiranëve?

Gazetari — I shkatërruat, po pastaj i vutë kthethra
të pangopura, u ngjitët në majë të tyre dhe nuk u mjaf-
tuat me kaq, po kërkonit dhe frone të tjera. Kënga e
lirisë, që premtuat në fillim se do të sillnit me vetë
flamurin tuaj, nuk u dégjua fare.

Napoleoni — Liria! Dëgjoni, Montolon! Liria Ai që
mbarsët me liri gjithmon dështon.

Gazetari — Po ju folët krejt ndryshe më 18 Brymer!

Napoleoni — (Në vegim.) Unë ndoqa pas yllin tim.

Gazetari — Por edhe popujt kanë yllin e tyre, dhe
kur pesha e tiranëve rëndon, ata dinë të ngrihen dhe në
dritën e yllit të tyre shohin shpëtimtarin dhe atëherë të
gjenjyerit, të mundurit i fshijnë nga froni perandorët dhe
i flakin tej.

Napoleoni — E pra, ky perandor që i ka shtypur
popujt, u ka dhënë atyre shumë thesare dhe ka bërë shu-
më vepra e ndërtime, duke rimëkëmbur ato që pati shka-
terruar revolucioni.

Gazetari — Po, i keni bërë këto, por a nuk më thoni
me çfarë çmimi?

Napoleoni — Për çfarë çmimi më flisni?

Gazetari — *Me çfarë çmimi i keni bërë këto?*

Napoleoni — *Montolon, ky njeri është çmendur!*

Gazetari — *Mos u nxehni, sër. Le të bëjmë një llogari të vogël. Ju të gjitha këto i keni paguar me çmimin e kufomave, me çmimin e vdekjes dhe të fatkeqësisë. Sa njerëz kanë vdekur për lavdinë tuaj? Nuk mund t'i numëroni. Apo s'keni pasur kurrë kohë ta bënët këtë llogari?*

Napoleoni — *Ç'i përmendni të vdekurit? Unë kam bërë 60 beteja gjithsej.*

Gazetari — *Dhe pse u vranë ata njerëz në 60 beteja? Pse qanë nënët për djemtë e vrarë? Pse vuajtën popujt, pse mbetën pa bukë, pse u përgjakën, pse vdiqën? Vëtëm se... dikush donte të rrinte mbi një fron të artë dhe të mbante në kokë kurorën e perandorit.*

(Napoleoni i tërbuar shkon në dhomën pranë, merr një gotë dhe e thyen përtokë.)

Drama mbyllt me një skenë të vogël që simbolizon një ide të madhe, një mësim historik, që popujt dhe brezat kurrë nuk duhet të harrojnë se diktatorët, tiranët, sunduesit e popujve i pret një fund fatal i pashmangshëm.

(Në ishull është përhapur lajmi i vdekjes së Napoleon Bonapartit.)

Një grua nga populli — (Bijës së saj.) *A e di, Kiti, kush qe ky njeri?*

Kiti — *Po, një gjeneral.*

Gruaja — *Ç'flet kështu? Thonë se ai qe djalli vetë.*

Kiti — *Vërtet?*

Gruaja — *Ai pat bërë pluhur e hi shumë vende. Ky djall u shkaktoi shumë vuajtje njerëzve.*

Kiti — *Eja, mama, unë kam frikë! Eja të ikim!*

Vendosjen në skenë të dramës së Moisiut e mori përsipër Herrman Robelind, drejtori i teatrit «Thalia» në Hamburg. Vetë Moisiu ndihmoi mjaft për vënien e saj në skenë. Gjendja e tij shpirtërore nuk ishte e qetë. Gjatë provave, bëhej nganjëherë nervoz. Kjo ishte e natyr-

shme. Fjala ishte për veprën e parë të tij, e cila do të jepej për të parën herë në publik dhe para kritikës letarre. Në kujtimet e J. Tervinit lexojmë: «Moisiu dhe unë rrinim gjatë tërë shfaqjes në fund të një lozhe. Shfaqja qe e shkëlqyer. Ne e ndjenim se sa përshtypje të fuqishme bëri drama. Ne u gjëzuam për pjesëmarrjen e gjerë të publikut dhe për suksesin vërtet të madh. Shtypi i Hamburgut dhe korrespondentët e gazetave të huaja e trajtuan veprën e parë të Moisiut në përgjithësi të meritueshme dhe të mirë».¹⁾

Disa muaj më vonë premiera «I burgosuri» u shfaq në Berlin, në Teatrin Popullor. Artisti i shquar Baserman interpretoi rolin e Napoleonit. Edhe në Berlin shfaqja doli mirë dhe u prit me duartrokite entuziaste.

Më vonë ngjarjet rrodhën ndryshe. Pas premierës, kritikët berlinezë u vërsulën mbi Moisiun dhe veprën e tij me sulme fyese, tallëse dhe kërcënuese. Moisiu, të cilit për dhjetëvjeçare të tëra shtypi i thuri aureola lavdie, tani u bë objekt i një fushate denigruese nga ca kalemxhinj, që vunë penat e tyre në shërbim të nazifashizmit.

Ishte e qartë se kjo dramë e shkruar dhe e shfaqur në prag të vendosjes së diktaturës naziste të Hitlerit në Gjermani, bënte aluzion të hapur kundër këtij diktatori fashist. Duke paraqitur fundin e palavdishëm të sovranit Bonapart, Moisiu paralajmëronte edhe fundin fatal të diktatorit nazist.

Kritika denigruese e preku mjaft Moisiun. Dikur, në fillimet e rrugës së tij si aktor, kur hidhete hapat e para në trasenë e artit skenik, ai i priste me gjakftohtësi dhe indiferentizëm kritikën dhe sulmet e ndonjë kritiku skeptik e keqdashës. Tani ai ishte artist i afirmuar, me një personalitet ndërkombe tar dhe vetë mosha e tij kishte bërë që ai t'i shikonte dhe jetonte gjérat më seriozisht.

1) J. Terwin. Kujtime. Theatersammlung. Vjenë.

Sulmi frontal i kritikës naziste e tronditi mjaft autorin. Kurrë ndonjëherë, edhe kur s'kishte pasur sukses në ndonjë rol si aktor, Moisiu nuk ishte shqetësuar dhe tronditur aq sa nga «disfata» e dramës së tij, për të cilën punoi me aq pasion e dëshirë.

«A e di Johana, — i tha ai në një çast dëshpërimi së shoqes, — qëkur më vdiq nëna e deri më sot, asgjë tjetër nuk më është dhimbur kaq shumë sa vepra ime e shkretë, e dërrmuar në themel?»¹⁾

Drama «I burgosuri» e A. Moisiut ka vlera ideore dhe artistike. Ajo është përkthyer në gjuhën shqipe dhe ka ngjallur interesin e studiuesve, aktorëve tanë dhe gjithë dashamirësve të artit.

Në fillim të viteve 30 Moisiu kishte menduar të shkruante një dramë për gruan, për ndjenjat e saj fisnike si nënë. Këtë dëshirë ia zgjoi një shok dhe mik i tij, mjek gjinekolog, i cili edhe e ftoi që të vizitonte institucionin e tij dhe të vërente gjëra mjaft interesante dhe prekëse, të nevojshme për dramën që do të shkruante.

«Ai, — kujton Moisiu, — më thoshte se në fytyrat e grave të reja, kur u çojmë pranë fëmijën e tyre të parë, unë vrej një shprehje të pakrahasueshme kënaqësie, që të frymëzon dhe të jep impulse nxitëse për mendime krijuese. Kështu, pasi më veshën përparsen e bardhë, festën dhe më mbuluan gojën me napë, së bashku me mikun tim kalova nëpër sallat e pavijonit...»

Ky veprim i Moisiut, i nxitur nga dëshira e mirëfilltë për të shkruar një dramë mbi gruan-nënë, përënëndrrat e bardha dhe lumturinë e saj të papërshkruar, u keqkuptua me qëllim dhe shkaktoi një reagim jashtëzakonisht të ashpër në qarqet reaksionare naziste. Ata e shfrytëzuan këtë rast dhe shtypi i Salsburgut i lëshoi frerin një fushatë të egër kundër Moisiut. Në faqet e gazetave naziste u dukën artikuj plot sulme dhe shpifje, sa qesharakë aq dhe të trishtueshëm: «Një i huaj i postër kënaq sadizmin e tij me dhembjen e grave gjer-

1) J. Terwin. Kujtime. Theatersammlung. Vjenë.

mane», «Komedianti futet në sallën e operacionit duke
fyer kështu sedrën e grave», etj.

Këto ngjarje të hidhura, që morën pamjen e një
skandali të egër denigrues, e shqetësuan jashtëzakonisht
artistin e madh.

Këtë valë të dytë plot sharje dhe shpifje Moisiu nuk
mundi ta përballojë. Ai nuk shkroi më kurrë dhe e la
Gjermaninë, ku erërat fashiste kishin filluar të frynin
me tërbim.

MENDIMET E MOISIUT MBI ARTIN E INTERPRETIMIT

Karakteristikë themelore e artit të interpretimit të Moisiut ishte thellimi në përmbajtjen e pjesës, të rolit që do të interpretonte, duke i dhënë lojës një kuptim të qartë dhe të caktuar. Moisiu nuk u mbështet vetëm dhe thjesht në dhunxitë natyrale të tij, në zërin e mrekullueshëm, në shkathtësinë apo plastikën e trupit dhe të fytyrës së tij. Ai bënte një punë të madhe, të vazhduese shme dhe të gjithanshme për ta luajtur rolin në mënyrë sa më të përsosur. Vullneti, puna, durimi, dashuria për artin e ngritën teknikën e tij në një shkallë të pakrahasueshme, në lartësinë e kërkeshave të kohës. Brendisë ideo-re të rolit, ai i jepte koloritin e caktuar të zërit të tij, formën e lëvizjes dhe të gjestit, hirësinë e trupit duke i bërë të gjitha këto jo një stoli zbukuruese të jashtme, po një veshje organike të përmbajtjes, të së brendshmes. Zërin, mimikën, lëvizjet, shikimin e syrit, plastikën e trupit — ai i vinte në funksion të idesë, të mendimit të personazhit.

Në periudhën e parë të përgatitjes, Moisiu e lexonte dhe e rilexonte pjesën pér të hyrë në brendi të rolit. «Aleksandri, — kujton Tervini, — më parë lexonte me shumë vëmendje tekstin e dramës, futej në epokën e ngjarjes, studionte me kujdes karakteret e personazhevë, sa të thuash i jetonte edhe vetë». Në këtë përpjekje, ai mundohej të përfytyronte çdo situatë në mënyrë reale, në mënyrë sa më të zakonshme. Kjo ishte një bazë e shëndoshë pér të ecur në rrugën e drejtë, pér të mos humbur, duke gjetur ngadalë dhe pa u rrëmbyer brazdat

që e çonin drejt afrit me personazhin, duke u futur në trupin, shpirtin dhe ndjenjat e tij. Dhe pasi futej në vetëdijen e personazhit që do të interpretonte, ai mbyllej në një dhomë ose dilte në kopsht dhe fillonte të deklamonte me tërë pasionin e tij, duke harruar jo vetëm ato q'ka kishte pranë, por edhe vvetveten. Dukej që bashkë me ajrin e pastër thithë më thellë përbajtjen e tekstit, ritmikën e tablosë, duke dhënë qdo nuancë të ndjenjave që do të interpretonte.

Motra e Moisiut, Elvira, kujton: «Që i vogël ai kishte dëshirë të luante teatër. E ndante dhomën në mes me një perde dhe pastaj na ftonte për të parë se si do të luante Otéllon. Pasi mbaronte dilte dhe na mblidhët parët: nga dy qindarka. Qëkur ishte djalë ai dëshironte të vinte në skenë rolin e Hamletit, thellohej në këtë rol me një zell aq të madh, saqë në dhomë përplasej gjithandej. Një herë ai shëtiste përmes parkut shtetëror (Stadtspark) të Vjenës dhe përsëri me frymëzim këtë rol e pa dashur gjestikulonte me duar. Iu vu prapa një qytetar, dhe pak më vonë shumë të tjerë. Kur pa turmën që i vente pas, u largua i turpëruar... Një rojtari të parkut që e kishte parë duke vrapuar, Aleksandrit iu desh ta bindte për pafajësinë e tij. Bile edhe tani, kur ai interpreton, i jepet krejt dhe aq shumë rolit, derisa rraskapitet plotësisht».

Moisiu nuk «lozte» personazhin në skenë, por interpretonte heroin ashtu siç ishte, i vinte rëndësi nxjerrjes në pah të vutive që e shquanin. Ai bënte përpjekje të mëdha për të njojur në thellësi karakterin e rolit, duke i bërë atij anatominë shpirtërore.

Ai luftonte të ishte personazhi e jo të dukej si ai. Interpretimi në skenë është art dhe prandaj, siç thoshte ai, zëri, gjestet jo vetëm duhet të mbushen me shpirt, po duhet të jenë edhe më të përbajtura, më të fisnikëruara, më të ngritura lart nga pamjet e përditshme.

«Unë, — thoshte A. Moisiu, — luftoj me të mirë e me këmbëngulje, me të butë dhe me forcë për rolin tim të dashur, derisa krijesa ime të jetë mbushur me gja-

kun dhe fryshten time»¹). Për Moisiun vlera kryesore e interpretimit qëndronte në përpjekjen për t'u futur në psikologjinë e personazhit, në botëkuptimin e tij, në karakterin e tij. «Në qoftë se në fund, — theksonte ai, — lëkura dhe ngjyra e flokëve nuk janë pikërisht siç duhet të jenë, atëherë siç dihet, kësaj të mete ke se ç't'i bësh. Dhe fare më në fund unë futem te njeriu që do të interpretoj, si në një xhaketë që më rri mirë për trup».².

Pikërisht bota e brendshme e personazhit, njohja deri në imtësitë më të vogla me karakterin e tij përbente shqetësimin kryesor të Moisiut. «Në qoftë se për njeriun e një roli nuk rreh zemra ime, në qoftë se në të nuk merr fryshtë kraharori im, në qoftë se në të nuk ka vend gëzimi im, vuajtjet e mia, botëkuptimi im, marrëzia ime, në qoftë se nuk gjej thelbin e qenies sime atëherë unë duhet të kem durim dhe të kërkoj më tej për të gjetur njeriun në të cilin do të isha unë me të vërtetë dhe jo vetëm në dukje».³

Në tërë trupëzimet që ai u bënte personazheve të ndryshëm, ai shfaqte në formë vepruese fenomenet shqërore, duke zbuluar fizionominë botëkuptimore, shpirtërore dhe morale të njeriut. Aleksandër Moisiu hynte në botën e figurave artistike me një forcë të madhe të brendshme vepruese, ku qdo gjest, lëvizje, shikim dhe pauzë transmetonte një ide, një mendim. Interpretimi i tij i natyrshëm ishte i zhveshur nga efektet e jashtme teatrale, pompoziteti, melodramatizmi, butaforia. Tek ai vërtetësia jetësore ngjeshej fort me vërtetësinë artistike.

Moisiu kurrë nuk «manipulonte» në skenë, nuk i pëlqente efektet e madhështisë së jashtme, shkëlqimin e stolive të tepruara. Nuk i pëlqenin teprimet, grimacat, ngër-

1) A. Moissi «Lügt der Schauspieler? (A gënjen aktori?). Cituar sipas Hans Böhm, «Moissi der Mensch und der Künstler», Berlin, 1927.

2) Po aty.

3) Po aty.

dheshjet, lëvizjet pa vend, nuk e pëlqente lojën që i sjell kënaqësi vetëm aktorit. «Sa më i madh të jetë gjeniu, nga i cili frymëzohet aktori, — thoshte ai, — aq më të rrezikshme janë Moloku që i afrohet gjithkujt, manierat dhe efektet që janë gënjeshtër».¹⁾

Ai ekte mbi brazdat e ndjenjave të brendshme të personazhit, duke zbuluar sa më thellë, anën e bukur apo të shëmtuar shpirtërore të tij dhe këtë nga një fushë në tjetrën, nga një rol në tjetrin, e bënte me një gjallëri dhe forcë emocionale krejt të re. Moisiu thoshte: «Gjatë këtyre viteve të krijimtarisë sime unë ende nuk kam mësuar të veproj sikur të isha një tjetër njeri, po sikur të isha vetë në ato rrethana dhe në gjendjet e krijuara me tiparet e caktuara të karakterit».²⁾

«Një nga cilësitë njerëzore artistike të Moisiut, — shkruante E. Faktor, — është dhe prirja që ka ai ta identifikojë vetveten me rolin. Kush e ndesh atë jashtë, larg nga portat e teatrit, mund të lexojë në sytë e tij Shekspinin, Shilerin ose Tolstoin. Kjo lidhet me gradën e veçantë të talentit të tij, me artin që është ngjitur në sytë e tij e në nervat e syve të tij, art me të cilin ai di ta shumëfishojë veten e tij me anë të një buzëqeshjeje, të një shtangieje, të shkëlqimit të diellit, të një shtrëngate apo të ndjenjave të njoma porsi vesa. Ekziston një rol, në të cilin kjo pasuri arti shpërthen e duket në një mënyrë të jashtëzakonshme. Në «Turandon» e Shilerit, në rolin kryesor, disi si me druajtje, ai hedh një vështrim te vajza. E kqyr atë me një vështrim e shprehje krejt indiferente e të ftohtë. Menjëherë ndërron vështrimin, e rrëmben një habi, sytë i zmadhohen e i zgurdullohen, në fytyrë i hipën një shkëlqim, ajo i çelet, i merr një shprehje ngazëllimi, e rrëmben një gëzim që s'mund të përbahet. Dhe, me këtë shprehje të heshtur të një pa-

1) Po aty.

2) Po aty.

sioni që ndizet, artisti ishte në gjendje të mbushte minuta të tëra».¹⁾

Moisiu me forcën e tij si artist vendoste kontakt me publikun që në minutat e para. Midis tij dhe sallës formojesh një lidhje e padukshme por e fortë, lidhje ndjenjash të vërteta të një organizmi të vetëm. Ai nuk përdorte efektet skenike sepse e dinte se kjo do të ishte një lidhje e qastit. Moisiu kishte një farcë të madhe bindëse, ai e kontrollonte dhe e zotëronte vetveten edhe në kulmin e shpërthimeve të furishme. Të gjitha këto cilësi ai i manifestonte në lojën e tij duke e harmonizuar lojën e vet me lojën e aktorëve të tjera, duke ndihmuar kështu në përsosjen e tërë pjesës në tëresi.

Aktorja e shquar Elisabet Bergner në kujtimet e saj shkruan: «Në dimrin e vitit 1917-1918 në Zurih u hap fjala se Moisiu do të shfaqte këtu Hamletin. Mua m'u caktua roli i Ofelisë dhe më ngriu zemra nga emocioni. Vetë emri i Aleksandër Moisiut ishte për mua simboli i artit më të lartë, megjithëse nuk e kisha parë ndonjëherë. Unë sapo kisha ardhur nga Vjena dhe u deziluzionova kur, në vend të tragedianit të madh që prisja, hyri në skenë një njeri me pamje djaloshi serioz dhe me cigare në gojë. Po shpejt m'u zhduk deziluzioni dhe druajtja kur pashë për së afërmë takthin artistik të Moisiut, modestinë dhe fisknikërinë e tij»...²⁾

«Kur u ndodha në prani të Moisiut mbi skenën e teatrit lirik, — shkruante një nga aktorët e shquar italianni, — përshtypja ime e parë qe habia; kisha përfytyruar për interpretuesin e kaq klasikëve, për nxënësin e Rajnhardt, një figurë madhështore, një zë kumbues, dikë heroike në çdo gjest, kurse përkundrazi m'u shfaq një krijesë krejt ndryshe; bjond, i brishtë, i thjeshtë, naiv, me një maskë shumë të lëvizshme, dy sy të mëdhenj të shqetësuar e depërtues, prej të cilëve dukej tejpërtej shqetësimi i brendshëm.

1) Cituar sipas Hans Böhm «Moissi, der Mensch und der Künstler», Berlin, 1927, f. 74.

2) E. Faktor «Der Schauspieler Alexander Moissi», Berlin 1920.

Gjatë provave ai u tregua menjëherë një mjeshtër i madh, ai dinte të krijonte një atmosferë të tillë ku të gjithë e ndienin veten të lirë, për secilin kishte gati fjalën bindëse, sugjerimin e nevojshëm, që e shprehte me modesti e ngrrohtësi. Menjëherë, të gjithë qemë të devotshëm. Qysht në mbrëmjen e parë ishim të gjithë entuziastë e të gëzuar prej suksesit që arriti me interpretimin e tij. Mbrëmja qe ndër ato të paharruarat».

Aleksandër Moisiu ishte një aktor me tipare aq të fuqishme, sa rrallëkush i ka pasur ndonjëherë. Fuqia e Moisiut qëndronte në faktin se ai shprehte natyrën e tij me të gjitha shpërthimet shpirtërore dhe në një mënyrë të pastër e delikate. Me këto veçori të natyrës dhe të interpretimit artistik, ai ndikoi te një brez i tërë aktorësh në një shkallë shumë të lartë dhe e detyronte publikun t'i shihte me një mënyrë të re figurat poetike.

«Aleksandër Moisiu, — siç thekson me të drejtë E. Oktrova, — solli nivele të papara në interpretimin skenik si për nga idetë përparimtare me të cilat gatuante figurat e veta, ashtu edhe për realizimin e virtuozitetin e mahnitshëm aktoresk»¹⁾. Në artin e tij Moisiu mbeti një artist i madh realist. Kur sistemi kapitalist botëror me degjenerimin dhe dekadencën e tij po krijonte gjithfarë «izmash» dhe shëmtimesh moderniste, duke e kthyer aktorin, e bashkë me të edhe njeriun në hiç, Moisiu ngriti me forcë kredon e tij: «Njeriu është fenomeni më i lartë dhe më i rëndësishëm i botës, dhe duke qenë i tillë, shpejt ose vonë teatri do të vëré në epigendër të krijimtarisë së tij, pikërisht njeriun... Pasqyrimi i njeriut, ja ku qëndron fenomeni më madhështor, përjetësisht i ri dhe tronditës».

1) Esat Oktrova «A. Moisiu — aktor i madh shqiptar i teatrit botror», Gazeta «Zëri i popullit», 2 prill, 1975.

VETITË MORALE TË AKTORIT

Për Moisiun si njeri, për bukurinë dhe pastërtinë e tij shpirtërore, për virtytet e tij morale dhe karakterin e tij kanë shkruar njerëz të shquar nga shumë vende, kolegë pune, të afërm, miq, njerëz të familjes, njerëz të thjeshtë, të gjithë ata që patën rastin ta njohin, të punojnë dhe jetojnë me të.

Moisiu — artist dhe Moisiu — njeri ishin një. Në shumë figura artistike që krijoj ai mishëronte vetitë e vvetvtes, gjithë gamën e pasur të ndjenjave të tij të paraqitura plot delikatesë, forcë dhe vërtetësi psikologjike. Moisiu i vinte veshin vetëm asaj që i diktonte zemra. Urrente pedantizmin, njerëzit e ftohtë, të komplikuar, intelektualët pa shpirt. Përbuzte paranë dhe pronën për të cilën nuk kishte asnjë lakmi.

«... Në përgjithësi pronën unë nuk e ndiej si lumburi të dëshiruar, — i deklaroi Moisiu një korrespondenti. — Sepse të disponosh, për mua do të thotë të jesh i lidhur dhe të mbash një përgjegjësi. Këtë unë nuk mund ta bëj».¹⁾

Aleksandri i donte njerëzit e thjeshtë, me të cilët sillej mirë dhe shfaqte ndaj tyre dashuri dhe respekt. Këtë e shohim në ndjenjat e ngrohta, përzemërsinë shpirtërore dhe përkujdesjet ndaj prindërve të tij, motrave, gruas, vajzës e farefisit; në ndihmën morale e materiale që u jepte nevojtarëve të ndryshëm, studentëve, artistë-

1) Gazeta «Algemeine Zeitung», 6.II.1965.

ve që endeshin pa shpresë, hallexhijve. Ishte i dhënë pas të përvuajturve dhe të varfërve; këtë gjë e dinin të gjithë prandaj i drejtoheshin me shpresë zemrës së tij.

Nëna e tij, Amalia de Rada, në kujtimet e saj shkruante: «Askush nuk është aq i mirë sa ai. Ndër miliona njerëz nuk ka njeri aq të mirë. Unë e them këtë, jo se pse ai është djali im. Të gjithë e dinë këtë... Ai besonte në çdo gjë të mirë te njerëzit. Në qoftë se dikush i tregonte diçka të keqe, ai i thoshte: «Mos e beso një gjë të tillë, këto janë gjepura, kjo nuk është e vërtetë». Ai bënte shumë për të tanishmen dhe më shumë kujdesej për të ardhshmen».¹

Aleksandër Moisiu kishte një zemër bujare. Me shpërbimet që merrte kur jepte shfaqje, ai mund të ishte bërë shumë i pasur sepse shuma e tyre arrinte në shifra fantastike, po Moisiu i shpenzonte duke përkrahur të varfërit dhe nevojtarët. Për atë mund të thuhet se dora e djathtë nuk dinte se çfarë falte e majta.

Motrat e tij kujtojnë se edhe kur ishte i ri, Aleksandri ishte shumë i dhemshur e bujar, ai shpërndante çdo gjë që kishte. Bile pat ndodhur që të falte edhe gjysmën e rrogës. Kur ishte student në konservator ai kthehej shpesh në shtëpi duke sjellë me vete njerëz të varfër dhe duke hyrë thoshte: «Shiko, ky sot akoma nuk ka ngrënë mëngjes», «Shiko, ky nuk ka fare pallto. A nuk keni diçka për t'i dhënë?».

Nga pamja e jashtme Moisiu ishte një njeri i zakonshëm. Ata që e kanë parë dhe kanë punuar me të e pëershkruanë si një njeri as të bukur as të shëmtuar: zeshkan, melankolik, me fytyrë shumë ekspressive dhe të lëvizshme, sytë i kishte të zinj, të thellë dhe të shqetësuar, në të cilët reflektohej dinamizmi i brendshëm. Ishte plot temperament dhe miaft tërheqës në bisedë. «Vetë mënyra se si të afrohet, — shkruante Stefan Cvajgu, — shkëndija e dritës në syrin e errët, hirësia në çdo gjest

1) Fondi i Moisiut. Theatersammlung. Vjenë.

të trupit të tij, melodioz pérherë dhe gjithmonë i ri me atë zjarr që i komunikohet edhe tjetrit të magjeps e të bën pér vete...»¹⁾.

Më poshtë Cvajgu shkruan pér të: «Njeri i jugut, gjithmonë njeri i jugut, ai, pér të mos ngrirë, sjell me vete kudo diellin e vendit të tij. Ai ka nevojë pér pérzemërsi, pérzemërsi njerëzore, pér ngrohtësi ndjenjash, pér shokë e miq. Ai është gjithnjë flakë, nuk mund të rrijë i ftohtë, ftohtësia do ta mbyste, mërzia do ta dërrmonte... Ai krijon me zotësinë e tij të çuditshme atmosferën e dashurisë shpirtërore, sidomos kur bisedimi ngrohet, sepse vetëm kështu e ndien veten se jeton... Është një gëzim i madh kur shohim buzëqeshjen që i ndrit në buzë, jo nga dashuria pér vetveten, po pér të tjerët. Nuk mund ta shohim kurrë këtë njeri të zymtë, të mbyllur në vetvete, ai është gjithmonë i gjallë, gjithmonë na dhuron diçka. Prandaj, kur bisedojmë me të, kuptojmë pérherë diçka të re mbi thelbin e së vërtetës, të kësaj bote».²⁾

Moisiu e filloi rrugën e jetës i uritur dhe çau pérpara me përpjekje dhe sakrifica të mëdha. Ai kishte vullnet të pathyeshëm. Simboli i tij ishte puna. «Kush ka jetuar me të fillimet e punës së tij, si i kam jetuar unë, — kujton aktori i madh A. Baserman, — kush ka pasur pérpara pengesa mbi pengesa, ai duhet të admirojë pér së tepërm energjinë e Moisiut. Ai e di se ç'do të thotë të mos dorëzosh armët në rrethana të tillë». ³⁾ Tatjana Tolstoi ka shkruar se, «Moisiu është i pajisur me të gjitha elementet që formojnë një artist të madh. Është një natyrë mjaft e ëmbël dhe një shpirt i qartë, i thellë. Moisiu dashuron singerisht artin e tij. Edhe sikur Moisiu të mos kishte zërin e tij të bukur, shpirti i tij i madh dhe talenti i tij do të kishin dhënë momente të një fry-

1) Cituar sipas Hans Böhm «Moissi, der Mensch und der Künstler», Berlin 1927.

2) Po aty.

3) Po aty.

mëzimi të madh. Por, që vepra e tij të ishte e plotë dhe e gjithanshme, atij iu desh të punonte shumë». ¹⁾

Moisiu që në moshë të re u prek nga sëmundja e rëndë e tuberkulozit. Me gjithë kurimet, kujdesin e prindërve dhe të motrave kjo sëmundje e ndoqi atë gjatë gjithë jetës. Letrat e ngrohta që ka shkëmbyer me anëtarët e familjes tregojnë se sa vështirësi e mundime i shkaktonte sëmundja. Në letrën dërguar familjes së vet, më 14 mars 1907, Aleksandri shkruante: «Mjeku thotë që jam më mirë dhe se këto pak ditë kanë bërë mrekullira. Ethe nuk kam pasur më, bile edhe temperatura më është ulur shumë. Mjeku thotë se do të përmirësohem me siguri. Në të gjitha rastet, duhet parë qartë se Lungenspitzencatarrh nuk është gjë tjetër veçse tuberkulozi dhe jo të gjithë shpëtojnë nga kjo sëmundje. Në çdo rast unë nuk kam frikë për asgjë, bile jam i bindur se do të shërohem ... Nga ç'shoh, kjo sëmundje do një vit për t'u shëruar dhe mjetet për t'u kuruar nuk i kam, pastaj humb edhe punën duke qëndruar aq kohë larg nga skena» ²⁾. Në një letër që i dërgonte nënës së tij, në qershor të vitit 1910, Aleksandri shkruante: «Jam mirë. Nuk ndihem më i lodhur e nervoz. Në një javë kam shtuar dy kile. Të dielën nisem për në Zurih, ku do të recitoj në tri mbrëmje, pastaj do të rikthehem ndoshta përsëri në senatorium.

Nga xhepat jam bosh, po do të dërgoj telegrafisht diçka ditën e hënë nga Zurihi» ³⁾.

Mund të sillnim citime nga letra të tjera të periu-dhave të ndryshme, po këto janë të mjaftueshme për të na bërë të qartë faktin sejeta e Moisiut ka qenë e mundimshme, e lodhshme, plot sakrifica e punë.

Pra, puna e madhe këmbëngulëse, vullneti i hekurt për t'ia dalë në krye qëllimit, forca e madhe morale, pasioni dhe dëshira për të arritur përsosmërinë ishin faktorët që e ngritën Moisiu në piedestalin e skenës

1) Po aty.

2) A. Moisiu – Letrat. Theatersammlung. Vjenë.

3) A. Moisiu, Letrat. Theatersammlung. Vjenë.

botërore. I paepur, plot besim në vetvete, ai kurrë nuk u thyte para vështirësive. Ai ishte optimist dhe kurdoherë shikonte përpara. Rruga artistike e Moisiut ishte rruga e një aktori të varfër, e një artisti që çau me mundim shtigjet e jetës.

Moisiu nuk ishte natyrë e mbyllur. «Unë, — thoshte ai shpesh, — futem midis njerëzve dhe shkrihem me të gjitha masat e popullit». Moisiu takohej me përzemërsi dhe bisedonte me njerëz të thjeshtë. Ai kishte respekt të madh për njerëzit e punës. Një mbrëmje, pas shfaqjes, duke ngrënë darkë me A. Lunaçarskin në restorantin «Pretoria» në Berlin, pranë tavolinës së tyre afrohet një punëtor i varfër italian i cili pasi i murmurit diçka në vesh Aleksandrit u largua duke i thënë: «Gracie, molto gracie!».

«Ky është një murator që e kam njojur në Trieste, — i shpjegoi Moisiu Lunaçarskit. — Qeveria e Musolinit nuk mund t'i sigurojë atij punë, kështu që shumë prej tyre detyrohen të kërkojnë punë jashtë shtetit. Po kriza tani ka shtrirë kthethrat e saj edhe mbi Gjermaninë, kështu që në radhë të parë po largojnë nga puna «gastarbaiter» (punëtorët e huaj). Ai ka marrë me vete edhe familjen e tij. Më ftoi në shtëpinë e tij me rastin e lindjes së fëmijës së pestë».

«Të pestit? — pyeti i çuditur bashkëshortja e Lunaçarskit. — Ai dukej mjaft i ri në moshë!».

Aleksandri qeshi: «Është njëzet e gjashtë — njëzet e shtatë vjeç... Italianët akoma nuk kanë menduar për «Zvajkindersistem»,¹⁾ ata përgjithësisht kanë familje të mëdha. Kurse kushérinjtë e mi shqiptarë kanë akoma më shumë fëmijë».²⁾

Figura e Aleksandër Moisiut do të dilte e zbetë dhe jo e plotë po të paraqitej e shkëputur nga fenomenet shoqërore dhe politike të kohës.

Ai interesohej për zhvillimet e reja shoqërore e po-

1) Sistem dy fëmijësh (gjerm.)

2) Po nga ai artikull i N. Lunaçarskaja — Rozenjel.

litike dhe përpinqej të kuptonte jo vetëm thelbin e lëvizjeve e përbysjeve sociale, por edhe forcat progresiste që kryenin këto ndryshime, rolin e tyre transformues revolucionar.

Moisiu interpretonte me tendenciozitet si mbrojtës i të drejtave njerëzore, si përkrahës i njerëzve të punës, i njerëzve të shfrytëzuar. Jo njëherë fjala e tij artistike kumboi në sallat proletare. Mik i Gorkit, R. Rolanit dhe i Barbysit, ai aspironte shndërrime revolucionare. Të shumtë ishin ata që e panë Moisiun në mbledhjet e punëtorëve duke recitar poezi revolucionare. Kur Republika Sovjetike Hungareze u shtyp me terror nga reaksi i hortist, Moisiu ishte ndër të parët që vuri nënshkrimin e tij në thirrjen që u bëhej personaliteteve më të shqarrë të kulturës përparimtare botërore në mbrojtje të Republikës së porsalindur. Këtë ai e bëri sepse kishte bindje përparimtare.

Aleksandër Moisiu bënte një jetë të gjallë, të mbushur me aktivitete të ndryshme. I dhënë shumë pas letersisë admironte mbi të gjithë poetët e mëdhenj: Dantën, Shekspirin, Gëten, Adhuronte Mikelanxhelon. Aleksandri ishte njohës shumë i hollë i muzikës. Edhe zëri i tij ishte melodioz, me nota melankolike, kumbues. I pëlqente më shumë muzika klasike, veçanërisht Beethoveni, po me shumë ëndje dëgjonte meloditë popullore, të cilat shpesh edhe i këndonte me kitarë në ambientin e tij familjar. I pëlqente të pikturnote dhe të gdhendte në dru. Profesor P. Vajzer, drejtor i shtëpisë së muzikës në Vjenë, më dhuroi një bust të punuar në dru nga vetë Moisiu. «E kisha ruajtur këtë bocet për më shumë se tri dekada, — tha ai. — Ju shqiptarët keni plotësisht të drejtë të krenoheni me këtë artist të madh».

Aleksandri ishte një gjimnast i mirë. Në qoftë se trupi i tij kishte një elasticitet dhe plastikë të bukur, kjo i dedikohet ushtrimit të sporteve, të cilët i shikonte si komponentë të domosdoshëm për mjeshtërinë e aktorit. Aleksandri ushtron te mjaft mirë notin, të cilin e kishte mësuar me shokët që i vogël, në Durrës. Gjatë kohës

së lirë ai ushtronte rregullisht gjimnastikën (paralelet dhe hekurin). I pëlqente hipizmi, skerma dhe aeronaufika. Moisiu ushtronte mirë mjeshterinë e pilotit.

Gjëra interesante ngajeta intime tregon Gustav Rykenbauer, ish-shoferi i Aleksandër Moisiut. «Unë nuk ditë tregoj përvlerat e mëdha artistike të Moisiut, gjatë viteve 1922-1926, kur Aleksandri debutonte në Burgteatër. Aleksandri ka qenë njëri me shpirt të mrekullueshëm. Ishte mjaft bujar dhe i dhembshur ndaj të varfërve. Për atë të gjithë ishin të barabartë. Asnjëherë nuk më ofendoi. Nuk ishte nervoz. Në jetë ishte optimist dhe plot humor.

Aleksandri zakonisht ngrihej herët në mëngjes, dilte në kopsht dhe bënte ushtrime fizike. Çdo mëngjes para orës 8, në kängellat e shtëpisë grumbulloheshin shumë gjimnazistë, të cilët para se të shkonin në shkollë do të përshëndeteshin me Moisiun. Tervini më thoshte që t'i largoja me pompën e ujit se po vonoheshin përvë në mësim. Kështu gati çdo mëngjes, kur pastroja makinën, kri-joheshin skena gazmore.

Moisiu kishte shumë adhurues. Pas shfaqjes zakonish hante darkë në restorantin «Vajser Han» ose në «Vajngarten». Gjatë shfaqjes unë prisja pranë Burgteatrit. Para mbarimit të shfaqjes më rrëtheonin dhjetëra adhurues dhe më pyesnin se ku kishte ndër mend të shkonë Moisiu pas shfaqjes. Ata më ofronin shumë dhurata. Unë kurrë nuk bleja vetë cigare, ato i siguroja nga adhuruesit e Moisiut. Pasi merrja dhuratat, ua tregoja emrin e restorantit dhe, përvë çudi, kur shkonim i gjenim të gjithë aty.

Unë isha bërë si njériu më i afërt i familjes së artistit dhe vëreja nga afér jetën e shtëpisë. Aleksandri bënte një jetë modeste. Në dhomën e tij kishte një shtrat të thjeshtë druri me një punim motivesh fshati. Dhoma e Tervinit, ndryshonte krejt nga luksi e komoditeti.

Moisiu, — përfundon Rykenbauer, — admironte njërzit e thjeshtë, njërzit e punës. Unë ruaj me kujdes

një certifikatë mirësjelljeje me nënshkrimin e tij, që ma dorëzoi për kohën që punova pranë tij».

Moisiu asnjëherë dhe në asnjë rast nuk vuri në dukje meritat dhe pozitën në të cilën ai u ngrit në artin skenik.

Tereze Rie tregon një rast:

«Moisiu dukej çuditërisht gjithmonë i ri. Njëherë, me rastin e një shfaqjeje në Noje Viner Byhne, në drejtorinë e teatrit, Moisiu takoi një aktore të re, e cila nuk e njihte Moisiun dhe iu duk si aktor fillestar, ashtu siç ishte edhe ajo vetë.

— A jeni kund i angazhuar?, — e pyeti ajo Moisiun i cili pohoi me kokë.

— Po ku?, — vazhdoi ajo.

— Pranë Noje Viner Byhne, — sqaroi Moisiu.

— Çfarë luani ju këtu?, — vazhdoi artistja kuresholare.

— Hamletin, Fedian etj., — u përgjigj me modesti Moisiu.

— Po këto janë rolet e Moisiut?, — tha e çuditur aktorja.

Në këtë çast ndërhyri drejtoresha, e cila sqaroi aktoren. Të tre qeshën të gëzuar».

Aleksandër Moisiu, si poet i skenës, ishte adhurues i së bukurës në art, luftëtar i së drejtës, simpatizues i çdo gjëje progresive. Ai ua zbuluronte jetën të gjithëve dhe i dashuruar pas poeziës i nxirrte në pah idetë, me të cilat bënte të emocionohej zemra e dëgjuesve.

Sado lart që u ngrit emri dhe vepra e tij, ky artist i madh dhe i vërtetë asnjëherë nuk u krenua. Ai mbeti gjithnjë i thjeshtë dhe i pastër. Ishte i padjallëzuar si një fëmijë, siç janë njerëzit gjenialë. Kurrë nuk harroi të kaluarën, brigjet nga ishte nisur. Kudo që vajti, ai pati një qëllim: t'i shërbente artit përparimtar, njerëzimit.

Moisiu me forcën e tij të interpretimit u dha një rezve atë kënaqësi, optimizëm dhe bukuri që mund të jepej nëpërmjet skenës.

JOHANA TERVIN — MOISIU

Johana Tervin ka qenë bashkëshortja dhe kolegia ideale e Moisiut. Ata jetuan një çerek shekulli në harmoni të plotë, duke krijuar së bashku çiftet ideale në krijimet e mëdha të dramaturgjisë botërore. Në jetën e tyre artistike, së bashku interpretuan plot pasion, dashuri e shkëlqim, çiftet e dashnorëve shekspirianë, Romeo e Xhulietën, Hamletin dhe Ofelinë, Otellon e Dezdemonën e shumë personazhe të tjera duke plotësuar njëri-tjetrin.

Johana Tervin (1884-1962) rridhte nga një familje bavareze. I ati i saj ka qenë profesor në gjimnazin e Vilhelmit. E apasionuar pas arteve, Tervini e nisi karrierën e vet si aktore që në moshë të re, në një nga teatrot e Mynhenit. Që në rolet e para, Johana, me talentin dhe interpretimet e saj, premtonte të bëhej një artiste e shquar. Në dhjetëvjeçarin e parë të shekullit XX artistja e re, gazmore, e pashme, me fytyrë të këndshme vezake, ishte në kërkim të rrugës së saj. Në vitin 1910 në qytetin e Mynhenit shkoi grupei teatral i Rajnhardt. Artistja e re mendoi se ishte një rast mjaft i volitshëm për t'u paraqitur përpëra regjisoret të shquar, duke iu lutur që ta merrte në ansamblin e tij artistik. Ajo kishte të dhëna të përshtatshme për t'u pranuar në këtë grup të shquar artistik. Rajnhardi pas disa provave të vogla, e pranoi artisten e re të debutonte në radhët e grupit të tij.

Kështu, për Johanën u hapën horizonte të reja. Ajo filloi atë rrugë të gjatë krijimesh artistike, të cilën e përshkoi krah për krah me Aleksandër Moisiun, bashkëshortin dhe mësuesin e saj shumë të dashur.

Në mbrëmjen e asaj dite kur u pranua në grupin e Rajnhardt, J. Tervin pa «Hamletin» të interpretuar nga Moisiu. Shfaqja i la mbresa të pashlyeshme. «Hamleti me sy të zinj», siç kishte qejf ta kujtonte ajo më vonë, e magjepsi aktoren e re, e cila mbeti e dashuruar. Në takimet dhe interpretimet e përbashkëta ata u njoħen më mirë, u miqësuan, u dashuruan. Në vitin 1919 Aleksandér Moisiu martoħet me Johana Tervinin dhe që nga kjo kohë ata interpretuan së bashku në shumë skena të botés. Kujtimet që Tervini i shkroi në vitet e fundit tē jetës së vet, janë dëshmi e jetës së tyre tē lumtur bashkëshortore. Tervini e ruajti deri në fund tē gjallë dashurinë me Aleksandrin, «bashkëshortin më tē mirë nē botë» siç e cilësonte ajo, tē cilin e adhuroi gjatë gjithë jetës së vet.

Johana Tervin-Moisiu e njihte mirë origjinën e bashkëshortit tē saj dhe ishte krenare pér tē. Ajo e ndoqi Aleksandrin pothuajse nē tē gjitha takimet me shqiptarët. Nën ndikimin e Aleksandrit i hyri edhe asaj dashuria pér Shqipërinë dhe këtë e ka shfaqur edhe pas vdekjes së Moisiut.

Në vitin 1959, Komiteti Shqiptar pér Marrëdhënie me Botën e Jashtme e ftoi Johanën pér një vizitë miqësore nē Shqipëri. Në përgjigjen e saj tē përzemërt ajo shkruante: «Jam prekur jashtëzakonisht dhe nderuar nga letra juaj dashamirëse. Do tē isha me tē vërtetë e lumtur t'i përgjigjesha ftesës suaj tē ngrohtë, tē shihja teatrin «Aleksandér Moisiu» dhe ībustin e tij, ngritur nē një kopsht tē Durrësit, po fatkeqësisht jam 75 vjeç dhe vuaj nga zemra, kështu që nuk mund tē rrezikoj tē ndërmarr një udhëtim që ma do shpirti, po që s'mund ta pérballoj. Më vjen keq gjithashtu, singerisht, që nuk kam mundësi tē adhuroj përparimet që ka bérë këto kohët e fundit Shqipëria, vendi që dashuroi aq shumë im shoq.

Me rastin e jubileut, me tē cilin ju po nderoni Aleksandér Moisiun, mendimet e mia do tē jenë pranë jush!

Johana Moisiu»

Me Johana Tervinin u mbajt korrespondencë e rregullt deri në ditët e fundit të jetës së saj. Letërkëmbimi, që ajo ka pasur me autorin e këtij libri, provon dashurinë dhe respektin për Atdheun dhe popullin tonë.

Në letrën që dërgonte nga Mynheni, më 8 maj 1960, Johana Tervin ndër të tjera shkruante:

«Ju falënderoj shumë për fjalët tuaja aq të dashura që më shkruanit... Fakti që në Shqipëri ka një teatër me emrin e Aleksandër Moisiut, është një nder i madh për emrin tonë. Sa déshirë kam të shikoj Shqipérinë, po unë jam 76 vjeçë dhe vuaj nga zemra, kështu që mjeku nuk më këshillon të bëj një udhëtim kaq të gjatë. Po me gjithë moshën time të kaluar, unë interpretoj ende në teatër. Tani jam duke dhënë shfaqje në Mynhen. Po ju dërgoj një fotografi timen nga ajo pjesë në të cilën po luaj tani. Me rastin e 25-vjetorit të vdekjes së burrit tim të dashur, kam folur në radion e Zvicrës dhe në radion e Austrisë dhe shumë gazeta kanë botuar artikuj mbi të.

Përshtendetni nga ana ime Shqipérinë dhe gjithë ata që e kanë në zemër Aleksandër Moisiun.»

J. Tervin interpretoi deri në ditët e fundit të jetës së saj. Ajo vdiq më 1962 duke ruajtur deri në fund të gjallë dashurinë dhe respektin për bashkëshortin e saj, Aleksandër Moisiun. Ajo kurdoherë shfaqi respekt dhe dashuri për Atdheun e bashkëshortit të saj, Shqipérinë.

DITËT E FUNDIT

Në marsin e vitit 1935 Moisiu ndodhej në turne në Itali. Në këtë kohë ai përgatitej të vinte në skenë komedinë «Nuk dihet se si», të shkrimtarit të njojur Luixhi Pirandelo, të cilën ky e pati shkruar posaçërisht për Moisiun. Premiera e komedisë do të jepej në Vjenë. Krahas përgatitjes së pjesës së re, Moisiu vazhdonte të jepte me sukses shfaqje të tjera në qytetet kryesore të Italisë. Më 12 mars ai interpretoi në Sanremo «Kufomën e gjallë» të Tolstoit. Fjalët e fundit të Fedias «E ndiej veten mirë! Sa mirë e ndiej veten!» ishin edhe fjalët e fundit që Moisiu shqiptoi në skenë. Ato ishin edhe ovacioni i fundit i publikut admirues. Fill pas shfaqjes, i përcjellë me dashuri nga miqtë dhe adhuruesit ai u nis për në Vjenë, nga ku mendonte të fillonte një turne tjetër të gjatë në-për Evropë. Ishin orët e vona të natës, kur ai hipi në trenin ekspres Riviera-Zurih. I mbetur vetëm në kabinë, ai filloi të ndiente ethe, të dridhura dhe dhembje të forta në anën e majtë të gjoksit. Treni nuk kishte vagon fjetjeje. Tërë atë natë të gjatë udhëtimi e kaloi i shtrirë mbi bankë duke u përpëlitar në ethe.

Më 14 mars, në ora 9 të mëngjesit, në stacionin Sud-banhov të Vjenës, Johana Tervin priste bashkëshortin e saj. «Unë kisha dy muaj që nuk e kisha parë Aleksandrin, — shkruante ajo në kujtimet e saj. — Prisja me padurim që nga treni të dilte bashkëshorti im i dashur dhe, si gjithnjë, plot gjallëri dhe ndjenjë, të përqafoheshim. Sa herë kisha qëndruar unë gjatë 25 vjetëve të jetës bashkëshortore në stacione të ndryshme hekurudhash!

Njerëzit zbrisnin dhe unë atë nuk e pashë. Ndoshta... ka mundësi të vijë me trenin tjetër.

Së fundi, kur njerëzit ishin rralluar, shoh Aleksandrin krejt të verdhë, që dridhej, duke m'u afruar:

— Shpejt, shpejt në makinë... Këtë natë... unë mendova se nuk do të vija më i gjallë te ti.

Unë shpresoja se dhembja e gjoksit ndoshta ishte me prejardhje reumatizmale po kjo nuk u provua. Një bronkopolmoni tashmë po përcaktohej.¹⁾

Gjendja shëndetësore e Aleksandrit që në ditët e para u keqësua shumë.

U shtrua në senatoriumin Kotazh të Vjenës, po me gjithë përpjekjet e dy mjekëve që e kuronin, të kujdesit të madh të së shoqes dhe motrës së tij, Sofies, që nuk iu ndanë pér asnjë çast, jetoi vetëm një javë. Më 22 mars, një goditje e re e zemrës bëri të pamundur çdo ndërrhyrje të mjekut.

Në mëngjesin e datës 22 mars, pas një keqësimi që erdhi gjatë natës, u vërtetua një kolaps i ri kardiak. Zemra e Moisiut nuk mund t'i bënte më ballë sforcimeve të tmerrshme. Fjala ishte pér një polmoni infektive, aq tok-sike, saqë në orët e fundit të mëngjesit iu shfaqën shpesh kriza dobësie të zemrës. Më së fundi iu shkaktua një emoragji polmonare.

Gjatë ditëve të pakta të sëmundjes, interesimi pér gjendjen shëndetësore të Moisiut qe i madh. Gazetat e Berlinit, Vjenës, Torinos, Budapestit, Milanos, Londrës etj, të të gjithë vendeve ku ai kishte korrur triumfe të panumërt, pothuaj çdo ditë njoftonin pér gjendjen mjekësore të Moisiut. Mijëra letra dhe telegramë arrinin nga vende të ndryshme në senatoriumin Kotazh nga miq dhe admirues të ndryshëm të cilët i uronin shëndet. Përpara dhomës së tij qëndronin shumë miq, por ai priti pak prej tyre dhe vetëm pér pak minuta. U përshëndet përzemërisht me miqtë e tij Ber-Hofman, Albert Baserman dhe Stefan Cvajg.

1) J. Terwin — Kujtime. Theatersammlung. Vjenë.

Theksojmë se pikërisht në çastet e agonisë, Musolini i dërgoi Moisiut një telegram me të cilin i njoftonte dhëni e shtetësisë italiane. Qeveria italiane e bëri këtë përtë përvetësuar lavdinë e artistit të madh tashmë të vdekur. Telegrami i Duçes ishte një spekullim skandaloz! Kur J. Tervini i lexoi telegramin e Duçes, Aleksandri murmuriti me përbuzje dhe ironi. Ai e kuptoi qëllimin e këtij akti të qeverisë fashiste italiane, e cila i ofronte shtetësinë italiane që ai nuk ia kishte kërkuar asnjëherë.

«Dy orë përpëra vdekjes, — kujton bashkëshortja e tij, Tervin, — ai m'u lut t'i sillja një penë për të shkruar dhe u përpoq me të gjitha forcat të shkruante diçka, po nuk qe në gjendje ta mbante penën. Unë iu luta të më thoshte se çfarë dëshironte të shkruante. Ai bëri një lëvizje të vogël sikur shkruante diçka me gisht në ajër, pastaj tha: «Çdo gjë të dashur e miqësore nga Moisiu!» Kjo ishte një lloj ndarje me të gjithë». ¹⁾

Aleksandër Moisiu vdiq më 22 mars 1935, ora 7.10'. Zemra e tij e lodhur nga një jetë plot punë dhe emociione, shëndeti i tij i rënuar nga tuberkulozi e ndau atë në moshën 56 vjeç, në kulmin e pjekurisë së tij artistike. Ai vdiq larg atdheut me zemër të zhuritur, siç vdiqën në mërgim bashkatdhatarët e tij, Naimi, Çajupi, Migjeni, Eftimiui, etj.

«Në varrimin e A. Moisiut, — kujton prof. A. Buda, në një bisedë në televizion, me rastin e përvjetorit të lindjes, — merrete pjesë çka kishte më të mirë bota kulturore e Vjenës dhe Austrisë, që i bënë një përcjellje plot nderim, plot mirënjoyje e me trishtim të thellë. Moisiu kishte lënë porosi që të mos mbahej asnjë fjalim në varrimin e tij».

Gjatë ceremonisë funebre, në krematoriumin e Vjenës, ndodhi një skenë shumë prekëse: aktori i dëgjuar gjerman Albert Baserman, mbajtës i unazës së Inflandit, e nxori nga gishti këtë unazë dhe e hodhi mbi trupin

1) Po aty.

e Moisiut, duke thënë: «Unë ta lë ty, mbi varrin tënd unazën e Inflandit».¹⁾

Veprimi i Basermanit ishte shprehje e dashurisë dhe e respektit për Moisiun, vlerësimi më i lartë i veprës së pavdekshme të Moisiut.

Në kodrinën e vogël të varrezave në Morkote, mbi liqenin e Luganos (Zvicër), ashtu si ai e pat dëshiruar në ditët e gjëzuara, u vendos varri i Aleksandrit. Nga lart, nën qiellin blu, varen trëndafilat e egër mbi pllakën e mermertë, që mban mbishkrimin e thjeshtë:

«Alexandër Moissi» 1879-1935».

Kështu, pushoi së rrahuri zemra e poetit të skenës, e artistit të madh. Skena botërore me vdekjen e Moisiut pati një humbje të madhe.

1) Unaza e Inflandit u krijua në kujtim të shkrimtarit dhe aktorit gjerman Infland. Duke filluar që nga viti 1814 ishte bërë traditë që kjo unazë të kalonte brez pas brezi në dorën e aktorit më të talentuar dhe më të madh të skenës gjermane. Në fillim të shekullit 20, atë e mbante aktori i shquar Posard, i cili pasi u largua nga skena ia kaloi Barnait, si një nga tragjedianët më të mëdhenj gjermanë. Barnai premtoi se do t'ia jepte dhe ia dha Albert Basermanit, i cili e mbajti për një kohë të gjatë. Me kalimin e kohës, publiku teatral gjerman interesohet gjallërish se cili do të ishte aktori i preferuar të cilët Basermani do t'ia kalonte unazën e Inflandit. Me Basermanin u takuan mjart gazetarë për të mësuar mbi synimin e tij dhe për të zbuluar trashëgimtarin e kësaj unaze. Baserman u deklaroi se së afërmidi do ta shpalte një gjë të tillë publikisht. Kjo shkaktroi një kurreshtje të madhe dhe përpunim opinionesh. Mendohej se tre aktorët më të mëdhenj mund të ishin pretendentë e saj: Aleksandër Moisiu, Verner Kraus dhe Friz Kortner. Po nga të tre këta pretendentë, vetëm ky i fundit ishte gjerman nga kombësia. Autoritetet naziste ushtruan presion të madh mbi Basermanin duke i kërkuar hapur që trashëgimtar i unazës së Inflandit të bëhej Kortner. Qarqet publike progresiste dhe të gjithë ata që e gjykonin çështjen me objektivitet, e kundërshtuan këtë duke deklaruar hapur se Aleksandër Moisiu ishte aktori më i madh dhe që kishte bërë për teatrin gjerman më shumë se të tjerët. Kjo e tërboi shtypin reaksionar, i cili filloi një fushatë të egër diskriminuese ndaj Moisiut. Një gjë e tillë ishte e zakonshme në Gjermaninë e asaj kohe, kur në trupin e saj të shëndoshë kishin

Gjeneratat do ta kujtojnë Aleksandër Moisiun si një ndër artistët më të mëdhenj të shekullit tonë. Kohërat nuk do ta shuajnë shkëlqimin e këtij ylli, që për afro 40 vjet rresht ndriçoi në piedestalin e skenës botërore.

shpërthyer abseset e ndyra të nacionalizmit, fashizmit dhe antisemitizmit.

Megjithatë, Albert Baserman nuk u përkul përparrë presiove të egra naziste, vendosi ashtu siç i tha ndërgjegjja dhe zemra e tij.

MOISIU DHE SHQIPËRIA

Gjatë gjithë jetës së tij krijuese, në shkrime dhe deklarata publike, në takime të ndryshme, Aleksandër Moisiu e pohonte me krenari prejardhjen e vet shqiptare. Dashurinë për atdheun, për Shqipërinë, ndjenjën e tij kombëtare, dëshirën e madhe për ta parë Shqipërinë të përparruar ai e shfaqte plot mall e zjarr. Shumëkush e quante «artist pa atdhe», «bir i prindërve italianë», «çifut pa truall kombëtar», «bir i një greku» apo «artist me origjinë mesdhetare». Kur ai u ngrit në piedestalin e skenës botërore, ndonjë u përpooq ta quante artist italian apo gjerman. Të pakët ishin ata që e njihnin dhe e pranonin origjinën shqiptare të Moisiut.

Aleksandër Moisiu kishte atdhe dhe atdheu i tij ishte Shqipëria. Kujtimi i dashur i atdheut të largët e ndoqi atë gjatë gjithë shtegtimeve të jetës së tij.

Më 1917 në një intervistë shtypi ai tha: «Babai im rrjedh nga një familje shqiptare, një pjesë e së cilës ende edhe sot vazhdon të jetojë në Shqipëri. Unë zotëroj një certifikatë qytetare, të lëshuar nga Qeveria e Përkohshme e princ Vudit».¹⁾

Moisiu mbushej me mall e dashuri kur takohej me bashkatdhatarët e tij. Në Vjenë apo Bukuresht, në Milano apo Berlin ai gjente kohë të bisedonte përzemërsisht me vëllezërit e tij shqiptarë, çmallej, kujtonte vitet e fëmijnisë, diskutonte mbi problemet e artit dhe gjendjen e atdheut. Sa e sa herë u takua me studentët shqiptarë

1) Kopja e deklaratës ndodhet në Bibliotekën Kombëtare të RD. Gjermane.

që ndodheshin në Vjenë. Ftesës për të kaluar me ta një darkë që do të shtrohej për nder të tij në mbrëmjen e 29 qershorit 1920, Moisiu iu përgjigj: «Po, me gjithë zemër, me shumë gjëzim, po për darkë s'ka nevojë; mjafton ca gota verë, vetëm që të jemi bashkë». ¹⁾

Atë mbrëmje studentë dhe qytetarë të tjerë shqiptarë që ndodheshin në Vjenë, shkuan në teatrin «Noje Viner Byhne», ku interpretonte Moisiu. Në mes të luleve, me të cilat populli i Vjenës nderonte Moisiu dalohej tufa e madhe me trëndafila e studentëve shqiptarë me një kordele me ngjyrat e flamurit shqiptar dhe shkronjat: «Birit të dëgjuar të Shqipërisë, artistit të madh Aleksandër Moisiut – si shenjë adhurimi e mirënjojje». Në mes të brohoritjeve dhe duartrokositjeve që nuk pushonin, Moisiu, i rrëthuar nga shqiptarët, del prej teatrit. Një varg karrocash, së bashku me Moisiu dhe shqiptarët nisen për në restorantin «Vajser Han». Të gjithë njerëzit që sapo kishin dalë prej teatrit, pyesnin me kureshtje: «Çfarë ka ndodhur?», «Ç'bëhet kështu?» dhe shumë prej tyre për herë të parë mësuan që Moisiu ishte shqiptar. Gjatë kësaj darke, që i ngjante një festë kombëtare me bukuri të veçantë, u mbajtën shumë fjalime dhe u ngritet dolli, u bisedua për çështje kombëtare, shkencore dhe artistike. Një nga studentët shqiptarë, duke iu drejtuar Moisiut, tha: «Është e pamundur të shpjegoj me fjalë çfarë ndiej në këtë natë të shënuar dhe plot rëndësi. Moisiu, i dëgjuari Moisi, më i madhi artist i Evropës së mesme, bashkatdhetari ynë, Moisiu, gjendet në mes tonë. Këtu ndodhet edhe vëllai i tij, z. Kostandin Moisiu, si dhe një shok i tij i shkollës së kohës së fëmijërisë në Durrës. Oh, do të ma kishte ënda që këtë të vërtetë ta përhap në gjithë botën, do të dëshiroja t'i dëftej gjithkujt se ky yll i shkëlqyer, Moisiu ynë, rrjedh prej atij populli, prej të cilët një shumicë vjershëtorësh ka marrë heronjtë e vet, prej popullit të Pirros dhe Skënderbeut...»¹⁾

1) Gazeta «Djalëria» Organ i shoqatës «Albania» së studentëve shqiptarë në Vjenë, Korrik 1920, Nr. 4.

Në përgjigje, Moisiu tha plot gjëzim dhe emocion:
«Miq të dashur! Ju falem nderit shumë për nderimet që po më rrëfeni. Jam ndodhur në shumë gostira, në shumë mbledhje, kam ndier gjëzime, po gjëzimi që ndiej këtë natë është një tjetër gjëzim. Ju lutem të më besoni, asnjëherë deri më sot s'jam gjuar kaq shumë sa këtë natë...»

Sa çast prekës! Sa frymëzohet zemra e shqiptarit, i cili sheh përparrë tij kaq të rinj të ndritur shqiptarë, të rinj me interes e dashuri për kulturën, me gusto të mirë, të zot për të vlerësuar artin.

Vazhdojeni punën tuaj, miq të dashur, ju jeni shpreza e Shqipërisë. Simboli i juaj le të jetë puna!

Duke ju falënderuar edhe një herë për dashurinë tuaj ndaj meje, ju ftoj ta ngreni këtë gotë për shëndetin e djalërisë shqiptare.

Rroftë djalëria shqiptare!»²⁾

Ligjérata e Moisiut ishte një shprehje e zjarrtë e dashurisë për atdheun, e besimit të patundur që ai kishte në forcat e popullit dhe të rinisë shqiptare, që do ta çonin vendin drejt rrugës së zhvillimit dhe progresit.

Duke kujtuar atë mbrëmje të gjuar që studentët shqiptarë kaluan me Aleksandër Moisiun, profesor Aleks Buda tregon: «Në këtë festë, ai shfaqi një gjëzim të madh, të singertë, shprehu dashurinë e madhe që ndiente për popullin dhe atdheun, shprehu keqardhjen për prapambetjen në të cilën e mbante mend vendin e vet, siç e kishte lënë, shprehu dëshirën që populli ynë të kishte perspektivë dhe të ekte në rrugën e përparimit kulturor.

E mbaj mend, — vazhdoi profesor A. Buda, — se si ai na drejtohej ne studentëve, me porosi që të bënim çmos për të qenë të vlefshëm për popullin e atdheun.

Aleksandër Moisiu ishte dëshmi e atij besimi që kishim ne, se populli ynë ndrydhëtë në gjirin e vet energji, forca e talente, të cilat do të shpërthenin, mund të shpërthenin, siç e provonte pikërisht shembulli i Moisiut,

1) Gazeta «Djalëria» Nr. 4, korrik 1920.

2) Gazeta «Djalëria» Nr. 4, korrik 1920.

krahas figurave të tjera të mëdha në historinë e kulturës sonë të lashtë».

Takimet dhe bisedat e Moisiut me shqiptarët nuk kishin thjesht karakter miqësor e ceremonial. Në raste të tilla ai trajtonte probleme politike, shtronte pikëpamjet e tij për probleme shoqërore dhe të artit. Në një mbrëmje tjetër, më 28 nëntor 1930, me rastin e përvjetorit të shpalljes së pavarësisë kombëtare, ai u deklaroi studentëve shqiptarë në Vjenë se: «Monarkia është pengesa për zhvillimin e historisë» dhe se «regjimi më demokratik është regjimi republikan ku nuk ka të pasur dhe të fuqishëm». Ideja e tij kishte një domethënie të qartë; urrejtje kundër monarkisë zogiste dhe adhurim i pushtetit të punonjësve që sapo kishte triumfuar në vendin e Totorit të Madh.

Mjaft kuptimplotë është edhe ngjarja e mëposhtme: Më 17 dhjetor 1921, në pritjen solemne që dha kolonia e shqiptarëve në «Grand Hotel Bulvard» të Bukureshtit, për ndër të Aleksandër Moisiut dhe gruas së tij, që ndodheshin për turne, të ftuar nga miku i tyre bashkatdhetar, Viktor Eftimi, çifti Moisiu u paraqit i veshur me kostum me ngjyrat kombëtare. «Shqiptarët e Bukureshtit, — shkruante «Shqipëria e Re», organ i shqiptarëve të Rumanisë, — janë fatbardhë se midis tyre gjendet ai, më i shkëlqyeri yll i teatrit të përbotshëm, i madhi tragjedian, shqiptari Aleksandër Moisiu... Kryetari i kolonisë dhe poeti Asdreni, mbajtën nga një fjalim të bukur dhe ngritën dolli për të madhin shqiptar»¹⁾. Gjatë darkës, Moisiu shpeshherë fliste për Shqipërinë, duke theksuar origjinën e tij shqiptare.

«Ka qenë një natë shqiptare e paharruar për koloninë tonë, — shkruante gazeta «Kuvendi Kombëtar» e kolonisë shqiptare të Bukureshtit. — Në banket morën pjesë Viktor Eftimi me bashkëshorten, Asdreni, Stavri Kuneska e shumë të tjerë. Moisiu, — vazhdonte gazeta, — është ai që revolucionarizoi artin e skenës, krijuesi i shkollës së re teatrale, artisti që mallëngjeu dhe habitit

1) Gazeta «Shqipëria e Re», 15 Janar 1922.

botën e qytetëruar. Tek Aleksandër Moisiu përfytyrohet gjenia artistike e kombit tonë.¹⁾

Shumë vite më vonë, duke folur për A. Moisiun në një mbrëmje përkujtimore me rastin e 25-vjetorit të vdekjes së tij, V. Eftimiу kujtoi atdheun e përbashkët buzë Adriatikut, virtytet dhe talentin e madh artistik të Moisiut... sepse secili artist në vetvete mbledh mallin e atdheut të tij.

Një rast tjetër mjaft të bukur tregon edhe artisti i merituar Mihal Çiko mbi takimin me Moisiun dhe ndjejnjat e tij për Shqipërinë.

«Në vitin 1922, — tregon ai, — isha student më Vjenë. E takova Moisiun një mbasdite në Burgteatër megjithëse nëpunësit e teatrit nuk donin të më linin, pasi Moisiu ishte në përgatitje. E njoftuan se e kërkonte një mik shqiptar... Moisiu erdhi pa u vonuar dhe, sa po më pa më njobu nga takimet në Bukuresht me Eftimiun. I tregova se dëshiroja të studioja për kanto dhe iu luta të më ndihmonte.

— Më bëhet qejfi shumë, — theksoi Moisiu, — kur shoh shqiptarë që marrin rrugën e artit.

I fola mbi Shqipërinë, për miqtë, për Durrësin. Më dëgjonte i përmalluar dhe me lotë në sy.

— Ti je i lumtur që vete në Shqipëri. Unë kam në zemër një brengë të madhe që akoma nuk po mundem ta shikoj atdheun tim!

Moisiu më këshilloi që për profesionin e kantos më mirë të studioja në Itali sesa në Vjenë. Me ndërhyrjen e tij u bë e mundur që unë të regjistrohesha në konservatorin italian.

— Më premtoni, — më tha Moisiu, duke u ndarë, — se, sa herë që të shikoni afishe mbi shfaqjet e mia do të vini të më takoni.

I premtova dhe në të vërtetë unë e takova përsëri në Itali në turnetë e viteve të mëvonshme.

Në turneun e vitit 1934, — vazhdon M. Ciko, — në një takim pas një shfaqjeje, ku Moisiu pati një sukses

1) Gazeta «Kuvendi Kombëtar», 8 prill 1934.

të bujshëm, u ndodha në një bisedë midis pedagogut tim Rikardo Pikoëi dhe dramaturgut të shquar italian Xhuzepe Adami. Ky i fundit, duke e uruar Moisiun ndër të tjera i tha: —*E çuditshme me ty, Moisi! Ti ke studiuar në Gjermani dhe shkolla jote është gjermane, po gjaku yt është italian dhe, sigurisht, kjo duket nga shqiptimi i përsosur i italishtes. Po, më falni, në lojën tënde ka disa momente të improvizuara gjallërie, që vijnë parpritur, që s'janë as italiane as gjermane. Këto duken si shpërthime të panjohura dhe unë kam dashur të të pyes shpeshherë, se me ç'qëllim i bëni, ndoshta për impulse, apo janë thjesht nervore.*

— *I dashur Adam, — iu përgjigj Moisiu, — ti vërtet më njeh mirë, po bën një gabim të vogël përsa i përket origjinës sime. Unë jam rritur në Shqipëri dhe jo në Itali. Sigurisht që këtu kam shkuar në shkollë dhe kam jetuar, po babai im është shqiptar dhe nëna ime është shqiptare nga arbëreshët. Shikon pra, që gjaku im i përket origjinës sime dhe origjina është ajo që thotë fjalën e fundit. T'i shikosh shqiptarët në jetë, duken si njerëz shumë të qetë, po gjithë ajo qetësi shndërrohet në fuqi luani e s'ka zot që i mban nëse dikush i prek në sedër ose në të drejtën e tyre... Por, — vazhdoi më tej Moisiu, — ne s'kemi ende teatrot tona, prandaj mua më shikon këndeje...»*

Idetë përparimitare të Moisiut, simpatitë e tij për atdheun e Leninit, dashuria për njerëzit e punës, lidhjet miqësore me personalitetet progresiste, qëndrimi i tij kundër fashizmit bënë që Moisiu të ishte objekt i sulmeve të borgjezisë kapitaliste. Stuhia naziste, që po përhapej në Gjermani dhe Austri e veçanërisht diktatura e egër fashiste e Hitlerit, e vunë Moisiun në shënjestren e saj. Dhe kjo ishte e qartë. Moisiu ishte aktor progresist, armik i militarizmit prusian, artist që përshëndeti Revolucionin e Madh Socialist të Totorit dhe i pari që vizitoi Republikën Sovjetike, atdheun e Leninit dhe Stalinit, ishte mik i ngushtë i Gorkit, Barbysit, Rolandit, Nekses në luftë kundër fashizmit, simpatizant i ideve komu-

niste dhe i Partisë komuniste Gjermane. Ishin këto arsyet që nazizmi e luftoi Moisiun sa që gjallë dhe që mbas vdekjes ndaloi çdo përkujtim të tij.

Nazizmi gjerman me fushatat e tij shpifëse e denigruese kundër Moisiut dhe gjithë njerëzve me ide përparimtare, ia vështirësoi në kulm jetën dhe veprimitari në e tij artistike. Tanimë ai kërcënohej hapur. «Nazistët, — tregon kolegu i tij i ngushtë, artisti i shquar H. Timig, — e quanin Moisiun artist çifut dhe të rrezikshëm, me ide revolucionare. Ata u ngritën në luftë kundër tij».

Në këto kohëra Moisiu po provonte një ndjenjë të çuditshme shqetësimi të cilën nuk e kishte provuar kurrë deri atëherë. Ai po binte gradualisht në një gjendje të rëndë shpirtërore, ndiente lodhje të madhe, rënim nervash, pagjumësi dhe dëshirë për të pushuar.

Në një takim me A. Lunaçarskin, në një gjendje shpirtërore mjaft të tronditur, Moisiu i tregoi për sulmet dhe provokimet që i bën elementët pronazistë.

«Ja shikoni, — iu drejtua Moisiu Lunaçarskit, duke nxjerrë nga xhepi dy letra të shkruara me gërmët mëdha, ku dukej qartë një shkrim i ndryshuar, — janë dy letra nga «gjermanët e vërtetë». Ata duket se u ofenduan që unë, si i huaj nga origjina, kam guxuar të interpretoj klasikët e «tyre»! Sikur klasikët nuk janë vlera të gjithë njerëzimit. — Moisiu filloi të lexojë: «Ju, italian arrogant, shqiptar ose çfarëdo që jeni, shtrëmbëroni, ngatërroni me theksin tuaj të huaj, jo vetëm fjalët por edhe vetë frymën e poezisë së madhe gjermane! S'ju ka mbetur shumë kohë ta konsideroni veten si aktor i parë gjerman; te gjermanët po rilind krenaria nacionale dhe pasardhësit e teutonëve do t'ju hedhin jashtë derës, ju dhe ata që janë si ju».

Letra e dytë ishte më e ashpër, më e ndyrë, në të Moisiun e quanin spiun të bolshevikëve.

— Këto letra janë pa nënshkrim?, — pyeti Lunaçarski.

— Natyrish, po!

— Po pse i lexoni atëherë? Ju mbrëmë i dëgjuat duartrokitjet e sallës, thirrjet plot emocion të publikut që nuk ju lejonte të largoheshit nga skena derisa u shuan llampadarët, ndërsa hidhëroheni për dy letra të ndyra anonime!»¹⁾

Lunaçarski u mundua ta qetësonte Moisiun. Kjo ishte periudha kur anembanë Gjermanisë po frynin erërat e egra të nazizmit. Vrasjet, vjedhjet, persekutimet politike, sulmi kundër çdo gjëje progresive e humanitare, atmosfera e zymtë dhe e errët që përpinte gjithçka — kjo ishte panorama e shëmtuar e Gjermanisë që po shkonte drejt humnerës.

Sa e sa personalitetë përparimtare, njerëz të shqar të artit dhe të shkencës progresive si N. Jokli, etj. u persekutuan dhe mjaft të tjera si M. Rajnhardi, T. Man, S. Cvajg, A. Baserman etj u detyruan të merrnin rrugën e mërgimit duke e braktisur Gjermaninë.

Këtë rrugë e ndoqi edhe Aleksandër Moisiu. Persekutimet dhe denigrimi fashist e detyruan Moisium të largohet nga Gjermania.

Në këto kushte ai filloi me muaj të tëra të organizonte turne në vende të ndryshme të Evropës dhe të Amerikës. Duke refuzuar ofertat e qeverive të ndryshme për t'i dhënë shtetësinë, ai kishte gjithmonë të njëjtën dëshirë: të kthehej në atdheun e tij dhe të merrte shtetësinë shqiptare.

Cdo vend i madh, me tendencë demokratike mund dhe me siguri do t'i jepte Moisiut shtetësinë, por ai e kërkoi vetëm prej atdheut të tij shqiptar.

Në nëntor të vitit 1933 Moisiu i drejtohet legatës shqiptare në Vjenë (Erste Bezirk, Plankengasse 3) me një lutje për t'u pajisur me një pasaportë zyrtare kombëtare. Kërkesën e tij Moisiu ia drejtoi Ministrisë së Jashtme në-përmjet konsullatës në Vjenë. Ai nuk iu drejtua Zogut, pasi nuk kishte as respektin më të vogël për regjimin despotik zogolian, kundër të cilit kishte folur jo një herë me

1) N. Lunaçarskaja — Rozenjel. Cituar sipas revistës «Nëntori», Nr. 7, 1965.

përbuzje si një regjim antideemonratik dhe antipopullor. Legata shqiptare kërkesën e A. Moisiut ia raportoi Ministrisë së Punëve të Jashtme me një shkresë, në të cilën thuhej: «Artisti i mjojur, prej gjaku dhe fisi shqiptar, zoti Aleksandër Moisiu, që ndodhet për një muaj në një turne teatrorë në Vjenë, iu drejtua sot kësaj konsullate me lutje që t'i akordohet sa më parë shtetësia shqiptare, bashkë me zonjën e tij Johana Tervin-Moisiu, artiste, e lindur në Mynhen me 18.III.1884. Ky artist i përmendur, që nuk ka mohuar kurrë kombësinë shqiptare, dëshiron që t'i njihet lutja edhe përjashta si shtetas shqiptar...»¹⁾

Më poshtë në shkresën e konsullatës sonë thuhet:

«Meqenëse vjetet e fundit nacionalistët gjermanë i banë një padrejtësi, duke e konsideruar si çifut, ai ia solli përgjithmonë shpinën Gjermanisë dhe prej vitit 1932 rron në vilën e tij në Lugano (Zvicër). Ky refuzoi gjithë shtetësitë e tjera dhe dëshiron vetëm të pranohet si shtetas shqiptar, siç ka qenë familja e tij e dalur me kohë prej Kavaje»²⁾.

Qeveria mbretërore, pasi shqyrtoi kërkesën e Moisiut, e aprovoi dhe vendosi t'ia referojë mbretit Zog për dekretim me motivacionin e mëposhtëm:

«Zoti Aleksandër Moisiu, tash shtetas gjerman, me banim në Zvicër, lindur në Trieste më 2.4.1880, përvèç se është prej origjine shqiptare e që nuk e ka mohuar kurrë kombësinë e tij shqiptare, po duke marrë parasysh edhe shërbimet e shumta që i ka bërë vendit tonë në shtetet më të mëdha të botës me profesionin e tij si dramatist me famë, me kërkesën e bërë prej tij propozojmë që në bazë të artikullit 9 të kodit civil, t'i akordohet shtetësia shqipëtare, bashkë me zonjën e tij Johana Moisi-Tervin, me origjinë gjermane dhe lindur në Mynhen më 18.III.1884, edhe kjo artiste»³⁾.

Tregojnë se kur ministri i oborrit po e informonte

1) Arkivi i Shtetit, Dokument Nr. 194-III, rezervat i Legatës Shqiptare në Vjenë, 7 nëntor 1933.

2) Po aty.

3) Fletore zyrtare, 16 prill 1934, Nr. 20.

monarkun për kërkesën e A. Moisiut, ai u kujtua dhe tha se mos ishte ai aktori që luante në Vjenë. Në vijim të bisedës Zogollit, i cili nuk mund t'i kuptonte kurrë njerëzit e artit, po ishte mësuar të blinte me para shërbëtorët e tij, pyeti se a mund t'i jepeshin para në dorë. Kur u përgjigjën se për ar nuk kishte nevojë, atëherë u shpreh se ishte gati ta bënte «Metër dë seremoni»¹⁾ të pallatit. Një pamje me të vërtetë sa komike aq edhe e ndyrë: një palaço i vërtetë i lustrosur me petkat e sovranit, i ofron «mbretit» të vërtetë të artit botëror të bëhet bufon i oborrët të tij! Kjo ishte një fyerje e dinjitetit njerëzor të artistit të madh, talentin e të cilët e adhuronte gjithë bota. Kështu satrapi Zog, i cili nuk kishte vlerësuar asnjëherë njerëzit e shkencës dhe të artit, u soll me përcëmimin e një injoranti.

Sovrani obskurantist, që e kishte lënë popullin në analfabetizëm të plotë u detyrua t'i japë shtetësi shqiptare Moisiut për të mos e diskredituar veten përparrë opinionit botëror.»²⁾

Propozimi i Zogut e lëndoi mjafit Moisiun. Ai vazhdoi endjet e tij nëpër botë duke ruajtur thellë në zemër dashturinë për atdheun dhe popullin e tij. Moisiu shtegtoi në qytete të ndryshme të botës, duke marrë me vete kujtimet e bukura të atdheut të tij. Një vit përparrë vdekjes së Moisiut korrespondenti shqiptar i gazetës «Vatra» shkruante: «Në datën 29 prill 1934 me Aleksandër Moisiun kalova disa minuta që nuk kam për t'i harruar kurë. Ma fali këtë kohë apostafat për lexuesit e «Vatrës» e pastaj më dorëzoi fotografinë e tij ku shkroi me dorën e vet përhëndetjet e tij bashkatdhatarëve të vet që i kujton me mallëngjim... Pastaj filloj të kuvendojë për Kavajën e Durrësin.

— Rrugët e ngushta të Kavajës, — tha Moisiu, — akoma i kam parasysh. Në Durrës kam bërë klasën e parë fillore. Kur u shpërndula së andejmi, kam qenë 8

1) «Maitre des ceremonies — mjeshtër të ceremonive.

2) Vendimi për dhënien e shtetësisë shqiptare u botua në gazetën zyrtare. Datë 28 shkurt 1934.

vjeç, por, pas dhjetë vjetëve u ktheva përsëri për pak ditë. Më mori malli...

Kam qejf të madh të kthehem në Shqipëri, — shtoi me mallëngjim. — Këtë vit do të vij medoemos. Po të mos jetë e mundur të vij me shoqërinë time për të dhënë shfaqje, do të sjell sigurisht korin e ciganëve të teatrit».¹⁾

Pas një viti Moisiu vdiq pa mundur të realizojë të vetmen dëshirë, dëshirën e fuqishme që ndien çdo qytetar i mërguar, i zhuritur nga malli për atdhe.

Shtresat përparimtare dhe intelektualët progresistë të Shqipërisë e ndoqën me simpati dhe admirim veprimtarinë artistike të bashkatdhetarit të tyre duke i bërë jehonë, nëpërmjet shtypit, famës dhe triumfeve të tij.

«Moisiun tonë, — shkruante gazeta «Illyria» në përvjetorin e parë të vdekjes të artistit, — nuk e harrojnë kurrë turmat e Evropës, Amerikës e të Azisë, ato turma që u mrekulluan nga fuqia magjike e artit të tij, kur ai personifikonte me aftësi përherë më të madhe Hamletin e Otellen, Mefistofelin e Faustin, Fedian e «Kufomës së gjallë» të Tolstoit etj. Si ndonjë stuhi e tmerrshme, fama e tij përlau shtete e kontinente e maska tragjike, zani i tij tanë shpoti dhe sytë andërrtarë e të tretun u gdhendën të pashlyeshme në mendjen dhe në zemrën e njerëzve të qytetëruem.»²⁾

* * *

Historia e ka njojur popullin shqiptar si një komb me vitalitet të madh. Ai jo vetëm u qëndroi rrëbeshevë të egra të pushtuesve, por edhe ruajti të paprekur ndje-

1) Gazeta «Vatra», maj 1934

2) Gazeta «Illyria», Tiranë, 28 mars 1936.

njën e lirisë, karakterin dhe veçoritë e kulturës dhe të artit të tij kombëtar, ruajti gjuhën dhe zakonet e tij, duke i dhënë njerëzimit personalitetë të shquara në fushën e shkencës dhe të artit. «Megjithëse zhvillimi i kulturës në vendin tonë ishte penguar shumë nga regjimet feudoborgjeze, — ka thënë shoku Enver Hoxha, — nga gjiri i popullit tonë kanë dalë njerëz të shqar të artit e të kulturës, poetë, filozofë, historianë, inxhinierë e aktorë të mëdhenj, që shumë herë kanë qenë autoritete edhe në vende të tjera të botës.»¹⁾ Një ndër këto figura të ndritura të artit botëror ishte, pa dyshim, edhe Aleksandër Moisiu. Nëse rrethanat e jetës e detyruan Moisi Moisiun, babain e Aleksandrit, të mërgonte në dhe të huaj, Aleksandri nuk e mohoi, nuk e harroi kurrë atdheun e tij, por e kujtoi gjithmonë me mall e dashuri.

Gjatë gjithë jetës së tij ai e ndiente thellë tragjedinë e atdheut të tij, Shqipërisë, të cilën pushtuesit e huaj dhe regjimi monarkist i Zogut e kishin lënë në prapambetje dhe skamje të plotë. Ndonëse arti i Moisiut u zhvillua larg trevës shqiptare, ai buroi së këtejmi dhe këtu u rikthyte përsëri.

Populli shqiptar e çmon shumë këtë artist të shqar që nxori nga gjiri i vet.

Rreth jetës dhe veprimtarisë së këtij bashkatdhetari të talentuar janë botuar te ne shumë artikuj, shkrimë dhe monografi, janë organizuar konferanca jubilare përkujtimore, emisione televizive, është xhiruar një film dokumentar nga kinostudiua «Shqipëria e Re». Emrin e tij e mbajnë disa rrugë dhe institucionë të vendit tonë.

Në nëntor të vitit 1962 me rastin e festave të mëdha të popullit shqiptar, Presidiumi i Kuvendit Popullor i dha Aleksandër Moisiut titullin «Artist i Popullit» (pas vdekjes), që është titulli më i lartë në fushën e arteve në Republikën Popullore të Shqipërisë. Dhënia e këtij titulli, emri i të cilit figuron i pari në listën e «Artistëve të Popullit» ishte një vlerësim i merituar i jetës dhe ve-

1) E. Hoxha, Vep. vëll. 18. f. 109.

prës së aktorit të madh, të këtij biri të talentuar, fama e të cilit gjëmoi në skenat e mbarë botës.

Vetëm në atdheun tonë socialist, Aleksandër Moisiu zuri vendin që i takon, ai nderohet dhe kujtohet me respekt.

Trupi i tij, fytyra e tij e gjallë dhe shprehëse është gdhendur në mermer e derdhur në bronz nga dora e skulptorëve tanë. I tillë është monumenti i skulptorit të merituar K. Rama, që ndodhet në hyrje të pallatit të kulturës «A. Moisiu» në Durrës. Loja dhe arti i tij i interpretimit studiohet me vëmendje e dashuri nga aktorët tanë të rindërtuar e të vjetër.

Brenda tridhjetëvjetëve Shqipëria socialiste, nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë, ka bërë shndërrime të mëdha në të gjitha fushat e jetës, duke përfshirë edhe atë të artit e të kulturës.

Dikur Aleksandër Moisiu ëndërronte të shfaqte në Shqipëri «Jedermanin» dhe «Kufomën e gjallë» po kjo mbeti një dëshirë e parealizuar sepse atëherë në vendin tonë mungonin teatrot. «Ne nuk kemi akoma teatrot tonë në Shqipëri, prandaj mua më shikoni të endem këndeja» — i pat thënë Aleksandri një kritiku italian. Regjimi obskuarntist i monarkut Zog ishte treguar i zellshëm vetëm për ndërtimin e kazermave dhe xhamive.

U desh të bëhej lufta legjendare nën udhëheqjen e Partisë që të arrihej çlirimi kombëtar e shoqëror dhe të merrmin një vrull të furishëm forcat materiale dhe shpirtërore të popullit. Partia jonë, nën udhëheqjen e shokut Enver Hoxha, ringjalli me shkëlqim traditat kulturore të popullit, duke i hapur rrugë dhe horizonte të gjera zhvillimit të energjive dhe talenteve të mrekullueshme të popullit tonë.

Në qoftë se para çlirimit nuk kishte asnjë teatër profesionist, sot kemi Teatrin e Operas dhe të Baletit, Teatrin Popullor në Tiranë, teatrin «Migjeni në Shkodër», teatrin «Aleksandër Moisiu» në Durrës, teatrin «Andon Zako Çajupi» në Korçë, teatrin «Skampa» në Elbasan, teatrot dramatike në Vlorë, Fier e Gjirokastër si dhe

dhjetëra estrada profesioniste, qindra e mijëra grupe amatore që fryshtohen nga gurra madhështore e artit tonë popullor.

Zhvillim të pakrashueshëm mori dramaturgjia jo-në kombëtare. Dramaturgët tanë si: Kolë Jakova, Spiro Çomora, Besim Lëvonja, Sulejman Pitarka, Fadil Kraja, Loni Papa, Ruzhdi Pulaha, Teodor Laço etj. krijuan vepra me vlerë, të mbështetura plotësisht në metodën e realizmit socialist dhe me një taban të shëndoshë kombëtar.

Teatri ynë, teatri i epokës socialiste ka krijuar një plejadë aktorësh e aktoresh të shquar si: Naim Frashëri, Zef Jubani, Loro Kovaçi, Violeta Manushi, Marie Logoreci, Tinka Kurti, Sandër Prosi e Pjetër Gjoka, Ndrek Luca e Mihal Popi, Pandi Raidhi, Nikolin Xhoja, Rikard Ljarja e Demir Hyska, etj. me të cilët populli ynë krenohet.

Në tre dekadat e pushtetit tonë popullor arti ynë dramatik u ngrit në një stad të lartë zhvillimi. Ne tani kemi një bërthamë të qëndrueshme regjisori të talentuar si: S. Mio, P. Stillu, P. Mani, E. Oktrova, S. Fanko etj. të cilët kanë vënë me sukses pjesë nga dramaturgjia kombëtare dhe botërore. Vlerat shpirtërore që më parë nuk njiheshin, u bënë pasuri edhe të masave tona punonjëse. Trupat tona teatrale kanë vënë me sukses në skenë veprat e Shekspirit, të Molierit, të Goldonit, të Gorkit, të Ibsenit, të Çehovit, të Brehit, etj.

Arti ynë dramatik po ngrihet në një stad të lartë zhvillimi duke u mbështetur në tabanin e shëndoshë kombëtar, zhvillohet me një fryshtëzim të gjërë e të shëndetshme duke bërë një luftë të ashpër kundër shfaqjeve dhe ndikimeve të huaja moderniste, borgjezo-rezisioniste.

Koha nuk do ta zbehë kurrë figurën e ndritur të Aleksandër Moisiut, të këtij aktori të madh shqiptar, që karakterizohet nga një prirje e pasembullt, nga një energji e jashtëzakonshme, nga një finesë e rrallë arti, nga një inteligjencë e shkëlqyer, nga një vullnet i paepur. Aleksandër Moisiu do të mbetet një figurë e dashur, si

një nga aktorët e mëdhenj dhe të paharrueshëm. Krijimet e tij artistike, incizimet në çdo kohë do të ngjallin emocione dhe admirim.

Aleksandër Moisiu arriti shkallë të pakrahasueshme në artin e interpretimit skenik. Emri dhe vepra e tij do të kujtohen me admirim dhe do të studiohen nga të gjithë njerëzit e artit tonë. Ne kemi të drejtë të krenohemi me të.

KRONIKA E JETËS

- 1879 — Më 2 prill të këtij viti lindi, në Trieste, A. Moisiu. Rrjedh nga familja shqiptare e Moisive. I ati i tij, Moisi Moisiu, dhe gjyshi i tij, Kostandin Moisiu, kanë lindur dhe jetuar në qytetin e Kavajës.
- 1884 — Kthehet në atdhe së bashku me të atin dhe dy motrat e tij. Vendoset në Durrës ku ndoqi shkollën fillore.
- 1889 — Dërgohet nga prindërit në qytetin e Gracit ku ndoqi gjimnazin e qytetit.
- 1898 — Së bashku me familjen vendoset në Vjenë. Ndjek për një kohë të shkurtër studimet në konservatorin e Vjenës por u pezullua nga këshilli i regjisë së shkollës me motivacionin: «Aleksandër Moisiu çdo gjë mund të bëhet, po jo artist». Gjatë kësaj kohe (mbrëmjeve) punoi si klakér (duartrokites) në operën e Oborrit dhe si kompars (figurant) në Burgteatrin e Vjenës.
- 1899 — Erdhi përsëri në Durrës për një kohë të shkurtë me rastin e martesës së motrës së tij, Mellanisë, Gjatë këtyre pak javëve vizitoi edhe Tiranën e Kavajën.
- 1899 — Në shfaqjen e «Tartufit» të Molierit, Aleksandër Moisiu luajti rolin e shërbëtorit Lorenc, duke i bërë një përshtypje të fuqishme aktorit të madh Kainc. Me ndërhyrjen e këtij të fundit Aleksandri paraqitet përpara kolegjiumit të regjis-

- rëve të Burgteatrit për t'u pranuar si aktor. Nuk u pranua me motivacionin: «I paaftë për aktor».
- 1901 – 1904 – Me ndërhyrjen e Kaincit pranohet në Teatrin e Ri Gjerman të Pragës. Gjatë kësaj periudhe debutoi në Pragë në rolin e Elias (Tej fuqive tonë), e Franc Morit (Cubat), e Mortimerit (Maria Stjuart).
- 1904 – Vendoset në Berlin pranë teatrit «Skena popullore gjermane» ku interpreton rolet e Golos (Gjennovefa) dhe të Franc Morit.
- 1905 – Pranohet nga Rajnhardi në teatrin e tij për të interpretuar rolin e Filipit (Konti fon Karole), ku zbuloi talentin e tij si aktor i madh.
- 1906 – 1910 – Gjatë sezoneve të ndryshme shquhet për interpretimin e Kreonit (Edipi dhe sfinksi), të Osvaldit (Hijet), të Morisit (Zgjimi i pranverës), të Romeos (Romeo e Zhulieta) si dhe Hamletit.
- 1910 – Martohet me aktoren Maria Urfus me të cilën pati një vajzë, Beatriçen, që është martuar me një regjisitor në Mynhen. Moisiu u divorcua me Urfusin më 1919.
- 1911 – Nën regjinë e Rajnhardt bëri turneun e parë në Rusi. Interpretroi me sukses rolin e Edipit (Edipi mbret).
- 1912 – Interpretroi me sukses rolin e Fedias (Kufoma e gjallë).
- 1912 – Luajti në filmin e tij të parë «Maskat».
- 1913 – 1914 – Interpretroi me sukses Taso (Torkuato Taso), Jeter (Biri i humbur) etj.
- 1914 – 1917 – Ndodhet në Francë si rob lufte, ndërsa nga korriku i 1917 si i internuar në Zvicër. Po këtë vit me ndërhyrjen e miqve të tij (si Viktor Eftimi) lirohet dhe kthehet në Vjenë.
- 1917 – 1919 – Interpretion rolet e Dantonit, (Vdekja e Dantonit), e Markiz Pozas (Don Karlos), e Klavigos (Klavigo), e Orestit (Orestia).
- 1920 – Luajti për herë të parë në Salsburg përpëra sheshit të Katedrales rolin e Jedermanit (Legjenda

e secilit) të Hofmanstalit. Që nga ajo kohë deri në vitin 1931 çdo vit java festive e Salzburgut fillonte me pjesën «Jederman» të interpretuar nga A. Moisiu.

- 1920 — Martohet me artisten e shquar gjermane Johana Tervin me të cilën gjatë një çerek shekulli interpretroi në pjesë të ndryshme.
- 1920 — Merr pjesë në lëvizjen revolucionare të klasës gjermane. Sulmohet nga shtypi reaksionar gjerman për idetë e tij përparimtare.
- 1920 — Merr pjesë në pritjen që jepet për nder të tij në hotelin Hauberhof të Vjenës, nga shqiptarët që banonin në Vjenë.
- 1921 — Më 31 janar të këtij viti lidh marrëveshjen me Rajnhardin.
- 1921 — Me ftesën e mikut të tij, Viktor Eftimiut, bën një turne në Rumani ku pritet me përzemërsi.
- 1921 — Në dhjetor të këtij viti deklaron botërisht në një intervistë shtypi origjinën e tij shqiptare.
- 1921 — Aleksandër Moisiu harton projektin e krijimit të një teatri në shërbim të masave të gjëra të popullit.
- 1924 — Bëri turneun e bujshëm në BRSS. Ishte i pari artist i huaj që vizitoi atdheun e Leninit.
- 1925 — 1929 — Bën turne në SHBA, Meksikë, Ballkan, Skandinavi, Paris, Londër, Zvicër, Turqi, Egjipt, Varshavë, Danimarkë, Hungari etj.
- 1931 — Më 31 tetor të këtij viti u vu për herë të parë në skenë pjesa e tij teatrale «I burgosuri». Pjesa u luajt në Hamburg dhe roli i Napoleonit u interpretua nga aktori i madh Baserman.
- 1933 — Me ardhjen e nazistëve në fuqi në Gjermani, Moisiu e la Gjermaninë dhe së bashku me artistët e tjera antifashistë si Albert Baserman, Ernest Doiq etj, udhëton në vende të ndryshme të Evropës duke dhënë pjesë të ndryshme teatrale.

- 1933 – Aleksandër Moisiu plotëson dokumentet përkatëse dhe kërkon zyrtarisht pranë konsullatës sot në Vjenë marrjen e shtetësisë shqiptare.
- 1934 – Interpreton në filmin «Lorenco de Medici».
- 1934 – Në Nis të Francës konsultohet me Stanislavskin për krijimin e një teatri të madh.
- 1934 – Aleksandër Moisiut i jepet zyrtarisht nga qeveria shqiptare e asaj kohe shtetësia shqiptare.
- 1934 – Bën turneun në Itali. Në qytete të ndryshme interpretoi me sukses të madh Jedermanin, Osvaldin, Dubedatin, Hamletin etj. Në muajin mars 1935 merret me përgatitjen e pjesës së Pirandello «Nuk dihet se si».
- 1935 – Më 18 mars, kur kthehej nga Sanremoja në Vjenë, sëmuret rëndë dhe më 22 mars vdiq në senatoriumin Kotazh të Vjenës. Në ceremoninë e djegies së eshtrave në krematoriumin e Vjenës, Albert Baserman, mbajtësi i unazës së famshme të Inflandit, e hodhi unazën mbi trupin e Moisiut duke thënë: «Unë ta lë ty, mbi varrin tënd, unazën e Inflandit». Varri mi i Moisiut (sipas dëshirës së tij) u bë në Mor-kôte, pranë liqenit të bukur të Luganos në Zvicër.
- 1962 – Për të përjetësuar kujtimin e Aleksandër Moisiut dhe për të vlerësuar figurën e tij, Presidiumi i Kuvendit Popullor i dha (pas vdekjes) titullin më të lartë në fushën e arteve, «Artist i Popullit» i Republikës Popullore të Shqipërisë.

LISTA E ROLEVE TË INTERPRETUARA NGA

ALEKSANDËR MOISIU

Viti	Titulli i veprës	Autori	Roli	Teatri
1899	Tartufi	Molier	Lorençi	Burgteatër Vjenë
1899	Lëmosha	Turgeniev	Kusafkin	»
1899	Edukatorja	Pol	Pronari i shtëpisë	»
1900	Cubat	Shiler	Shpigelberg	Nusdorf
1901	Manteli i kuq	Brië	Arduil	Teatri i Pragës
1901	Mireti Arlekin	Lotar	Princi Eco	»
1901	Skillavi	Mozer	Zdrukthëstari	»
1901	Vajza e Orleanit	Shiler	Raul	»
1901	Cubat	»	Bjornson	Franc Mor
1901	Përtej fuqive tona	Brahfogël	Elias	»
1901	Narciz	Nestroi	Konti Bari	»
1901	Shpirti i keq i endacakut Lumpac	Fasel	Fasel	»
1901	Don Karlos	Shiler	Inkuzitorë	»
1902	Rikardi III	Shekspir	Robert	Ostendë
1902	Padja e krahinës	Bauernfeld	Kamerieri	»
1902	Zana kapriçioze	Blumental	Gerhard	»
1902	Gëci i Berlindjenit	Geëte	Fshatari	»
1902	Vdekja e Valenshtajnit	Shiller	Dëvërë	»

Viti	Tituli i veprës	Autori	Roli	Teatri
1902	Qyteti i mogëm Hajdelberg	Majer-Forster	Karl Bilc	Teatri Ostende
1902	Kështu vdesin perënditë	Kirhen	Satiren	»
1902	Si t'ju pëlqejë	Shekspir	Shërbyes	»
1902	Dora	Bereni	Ajnpreher	»
1902	Maskat e fundit	Shnicler	Karli	»
1902	Urdhri i katërt	Arcengruber	Katcer	»
1902	Komisari i rehatshëm	Kurteline	Breloe	»
1902	Mjerë ai që génjen	Grilpacer	Pilger	»
